II. Kompetenca të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit

Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
• Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: I lumtur është njeriu që s'ka nakar
Fjalët kyçe: Mulliri, mullixhiu, lakmonjës, nakar
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - përshkruan ngjarjen në tekst; - dallon njeriun me vlera në shoqëri; - zbulon mesazhin që sjellë ky tekst te ne. **Kriteret e suksesit:** Rikujton krijimet e vjetra shqiptare. Krahason njeriun me vlera në shoqëri. Argumenton mesazhin që sjellë teksti.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, fleta të bardha, marker, tabela.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kllaster
Në këtë fazë, mësuesi/ja pyet nxënësit: Si mendoni, cilat janë gjërat që na bëjnë të lumtur në jetë?
A mendoni se ne jemi ata të cilët ndikojmë në lumturinë tonë?
Pastaj shkruan në tabelë kllasterin dhe të gjithë nxënësit shprehin mendimet e tyre.P.sh.:



Ndërtimi i njohurive të reja: Stuhi mendimi
Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të rikujtojnë krijimet e vjetra shqiptare dhe të ndalen te përralla, duke qenë se njësia mësimore është përrallë. Pastaj udhëzohen të lexojnë pjesën e njëjtë dhe të shkruajnë detyrën e udhëzuar nga mësuesi/ja.
Nxënësit punojnë në grupe.
Grupi i parë: Diskutues– Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe pas leximit të tregojnë ngjarjen para të tjerëve. Një nxënës prezanton grupin (p.sh. nxënësit tregojnë pjesën në pika të shkurta sepse të gjithë e kanë lexuar dhe ndalen më shumë te nakari (zilia) që ndikon në lumturinë e njeriut siç ishte edhe rasti i mbretit që nuk ishte i lumtur dhe e kundërta e mullixhiut që kishte më pak dhe ishte më i lumtur sepse nuk kishte zili.).
Grupi i dytë: Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të mendojnë për detyrat jashtë shkollës, p.sh., ku munden të gjejnë material shtesë dhe cili është i nevojshëm. Grupi i dytë ka të drejtë të nxitë nxënësit për detyrat e shtëpisë.
Grupi i tretë: Kritikët–Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të krijojnë mendime pozitive dhe negative duke përdorur komentet e tyre për të bindur nxënësit tjerë për qëndrimin e tyre.
Pas prezantimit dhe debateve udhëzohen në grupet e njëjta të punojnë ushtrimet të ndara nga mësuesi/ja.
Grupi i parë: Kuptojmë tekstin–detyra 1. Përgjigjuni pyetjeve.
(Personazhet janë: mullixhiu, mbreti) dhe Analizojmë tekstin - detyra 2,3,4(Mullixhiu ishte i lumtur sepse nuk kishte asnjë nakar/zili).
Grupi i dytë: Interpretojmë tekstin – detyra5,6(Kur nuk kemi nakar jemi të lumtur) dhe Gjuha e tekstit – detyra 7, 8 (Fjala *nakar* është fjalë kyçe në tekst).
Grupi i tretë: Reflektojmë rreth tekstit– detyra 9,10 (Pasurinë nëse e fitojmë me djersë gjithsesi do të na bëjë të lumtur). Mësuesi/ja ndihmon nxënësit nëse është e nevojshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i Venit Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë një diagram për mullixhiun dhe mbretin. Në rrathë duhet të shënojnë të veçantat e personazheve dhe në mes të përbashkëtat.P.sh.:
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor, quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Mendoni sikur përralla ka një fund ndryshe. Për shembull, imagjinoni sikur mbreti të bëhej mullixhi dhe mullixhiu mbret. A mendoni se mullixhiu do të vazhdonte të ishte i lumtur? Po mbreti, a do të arrinte të ishte i lumtur? Shkruani një fund tjetër për këtë përrallë.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore:
Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilin nxënës për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë dhe letërsi shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Rrëfime nga e kaluara		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon përshkrimin dhe rrëfimin në një tekst të caktuar.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv** 1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. 2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve. 4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit. **II.** Kompetenca të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik** 1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media. 3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik). **III.** Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm** 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. 5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): **I. Shkathtësitë e komunikimit** **Të dëgjuarit dhe të folurit** • Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. **Të lexuarit** • Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.			

Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Prometeu i mbërthyer

Fjalët kyçe: Perëndi, Prometeu, zjarri, Zeusi, kryengritës, tiran, njerëzimi.

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- parashikon si do të jetonin sot njerëzit po të mos e kishin zbuluar zjarrin;
- krahason sjelljen e Zeusit tiran, ndaj Prometeut kryengritës;
- vlerëson sakrificën e Prometeut.

Kriteret e suksesit:
Klasifikon shpikjet e njerëzimit nga zbulimi i zjarrit.
Kritikon sjelljen e Zeusit tiran karshi Prometeut kryengritës.
Zbulon rolin e epitetit si fjalë përcaktuese në krijimtarinë artistike.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
shkencat shoqërore, shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh
Mësuesi/ja pyet nxënësit: *Si mendoni cilat janë përfitimet e njerëzimit nga zbulimi i zjarrit? Po a keni dëgjuar për Prometeun? Nëse po, kush ishte ai dhe çfarë bëri për njerëzit?*
Të gjitha mendimet e nxënësve shkruhen në dërrasë të zezë nga mësuesi/ja.



Ndërtimi i njohurive të reja: Të lexuarit e drejtuar
Mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë titullin e njësisë mësimore: "Prometeu i lidhur" dhe fillon të shpjegojë se kjo pjesë është përshtatje në prozë sipas tragjedisë "Prometeu i mbërthyer" e shkruar nga tragjediani më i madh i Greqisë së lashtë, Eskili. Mësuesi/ja cakton pjesën që do të lexohet pjesë-pjesë në heshtje dhe më pas nxënësit do të parashikojnë dhe do të mbajnë shënim parashikimet e tyre në bazë të pyetjeve të ndërtuara në mënyrë grafike më parë nga mësuesi/ja.

Ç'mendoni se do të ndodhë?	Çfarë provash keni?	Si ndodhi në të vërtetë?

Grupi I – do të lexojë pjesën nga fillimi deri te fjalia "E merr fjalën Pushteti e i thotë Hefestit:"
Grupi II – do të vazhdojë leximin nga pjesa ku e përfundon grupi I deri te "Hefesti iu përgjigj:"
Grupi III – vazhdon nga "Hefesti iu përgjigj" deri te – "Sa dhimbje ndiejmë tok me ty! Pa na thuaj tani, ç'bëre për hatrin e njerëzve?"
Grupi IV – vazhdon leximin nga "Unë u mësova të shërojnë sëmundjet, u dhashë zjarrin me të cilin do të shpikin tani shumë mjeshtëri." deri në fund.

Pasi të lexohet e tërë pjesa dhe të gjitha grupet të kenë hedhur në letër parashikimet e tyre, mësuesi/ja do të shpjegojë rolin e epitetit: Epiteti është një figurë me përdorim të gjerë, shpesh bëhet edhe përcaktues i stilit. *Në pjesën që sapo përfunduat kemi shumë epitete p.sh. Zeusi tiran; Prometeu kryengritës etj.*
Të ndarë në grupe, nxënësit do të punojnë: Grupi I – ushtrimin 1; Grupi II – ushtrimin 4; Grupi III – ushtrimin 6; Grupi IV – ushtrimin 10.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i Venit
Gjatë fazës së fundit të zhvillimit të kësaj ore, nxënësit do të punojnë me rubrikën "Interpretojmë tekstin" dhe nëpërmjet diagramit të Venit do të plotësojnë në mënyrë individuale të përbashkëtat dhe të veçantat që kanë në mes tyre Zeusi dhe Prometeu.



Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësimi i nxënësve do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore: diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësit do të punojnë rubrikën "Reflektojmë rreth tekstit" dhe detyrën: Si e imagjinoni pamjen e jashtme të Prometeut pasi keni lexuar pjesën? Bëni një përshkrim të shkurtër për ta paraqitur atë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore:

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë dhe letërsi shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Rrëfime nga e kaluara		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon përshkrimin dhe rrëfimin në një tekst të caktuar.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
II. Kompetenca të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit

Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
• Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Pëllumbi dhemilingona

Fjalët kyçe:pellk,pllumbnë,ndoth,heth,brek,gjahtarë,kqyrë,ndë.

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- dallon mesazhin që sjellë fabula;
- analizon ngjarjen në fabul;
- komenton idetë e tërthorta duke i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Kriteret e suksesit:
Rikujton mesazhin që sjellë fabula në tekste.
Interpreton ngjarjen në fabul
Vlerëson idetë e tërthorta duke i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri i nxënësit, fleta të bardha, marker, tabela

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
edukatë qytetare, histori, gjeografi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh
Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjen: A duhet t'i ndërtojmë marrëdhëniet vetëm në bazë të interesit që kemi me të tjerët?
Nxënësit/et diskutojnë së bashku për idetë e tyre që do t'i shënojnë në tabelë.P.sh.:



Pastaj mësuesi/ja shkruan titullin e njësisë mësimore në tabelë "Pëllumbi dhe milingona" dhe sqaron për nxënësit. Pastaj tregon për fabulën dhe mesazhin që sjellë ajo te lexuesit.
Fabulat janë tekste që përcjellin në mënyrë të tërthortë një ide apo një mesazh. Autori nuk e shpreh mendimin në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në bazë të fabulave është figura e alegorisë. Alegoria është ajo figurë letrare me anë të së cilës theksohet një mendim, që nuk është shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë, por duhet nënkuptuar.
Nxënësit njihen edhe me fabulistin e njohur *Zhan de la Fonten.*
Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia pyetje-përgjigje
Në këtë fazë, pas leximit të fabulës "Pëllumbi dhe milingona", mësuesi/ja shkruan në tabelë figurën stilistike të *Alegorisë* dhe nxënësit/et shkruajnë në fletore.P.sh.:



Pastaj udhëzohet të punojnë detyrat e ndara nga mësuesi/ja në grupe.
Grupi i parë —detyra 1, 2, 3, 4; **Grupi i dytë**– Interpretojmë tekstin – detyra 5, 6; **Grupi i tretë**– Gjuha e tekstit – detyra 7, 8 , 9. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit nëse është e nevojshme.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Ditari dypjesësh
Pas përfundimit të detyrave udhëzohen të zgjedhin vargjet e pëlqyera dhe të komentojnë zgjedhjen e tyre.

Vargjet e pëlqyera	Reflektime

Vlerësimi i nxënësve:
Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor, quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar(Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur:

Jepni shembuj nga jeta juaj ose e shokëve tuaj, në të cilët të tregoni se mosha nuk ju ka penguar të ndihmoni të tjerët.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilin nxënës për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe dhe letërsi	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Rrëfime nga e kaluara		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon përshkrimin dhe rrëfimin në një tekst të caktuar.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
II. Kompetenca të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit

Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur. • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Kërcimtarja e Dukagjinit

Fjalët kyçe: kërcimtarja, Lulja, zana, hyjnesha, Dukagjini, Skënderbeu, Leka

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- diskuton për vendin, kohën dhe ngjarjen në rrëfim;
- analizon vendimin e mbretit për t'i dhënë çmimin fitues turkeshës së panjohur;
- krijon rrëfimin duke përdorur metaforën si mbretëreshën e figurave stilistike.

Kriteret e suksesit:
Përshkruajnë hijeshinë dhe bukurin e Kërcimtares së Dukagjinit.
Arsyetojnë vendimin e Mbretit dhe bajlozëve.
Vlerësojnë rolin e figurave stilistike në tekstet rrënimtare letrare.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: shkencat shoqërore, shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Parashikimi me terma paraprakë
Mësuesi/ja shkruan disa fjalë në dërrasë të zezë: *Dukagjini, Leka, kërcimtare, Lulja, zana, hyjneshë, flutur, si, malësore.*
Nxënësit për pak çaste do të thurin fjali me termat e shënuar nga mësuesi/ja. Ata do të krijojnë ide se për çfarë do të bëhet fjalë në mësimin e radhës. Mësuesi/ja mësuesi/ja njeh nxënësit me krijimtarinë letrare dhe patriotike të Ernest Koliqit.
Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia pyetje-përgjigje
Së pari do të lexohet fragmenti "Kërcimtarja e Dukagjinit". Pas leximit, nxënësit/et së bashku me mësuesin/en nëpërmjet metodës pyetje-përgjigje zbulojnë elementet karakteristike të prozës përrallore që ka thurur poeti. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit në zbërthimin e fjalëve të panjohura duke u mbështetur në fjalorin e tekstit në libër. Pastaj ai/ajo u shpjegon nxënësve për funksionin e metaforës në tekstet letrare në përgjithësi dhe në ato rrëfimtare në veçanti.
Ora mësimore vazhdon me studimin e tekstit dhe nxënësit do të përgjigjen në pyetjet e ushtrimit 1.
Mësuesi/ja formon 4 grupe me nxënës dhe secili grup punon detyrat e caktuara.
Grupi I – ushtrimin 2; **Grupi II** – ushtrimin 3 dhe 4; **Grupi III** – ushtrimin 7 dhe 9; **Grupi IV** – ushtrimin 10 dhe 11.
Nxënësit punojnë në heshtje. Përfaqësuesit e secilit grup do të argumentojnë përgjigjet e tyre. Në fund mësuesi/ja bën një përmbledhje përfundimtare të përgjigjeve të nxënësve duke u munduar që të gjithë si ***klasë të arrijnë të kuptojnë arsyen e ndërhyrjes së zanave të Dukagjinit, në mënyrë që Lulja të dalë fitimtare dhe të mposhtë kërcimtaren turkeshë e cila ishte gati të shpallej fituese.***
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Ditari dypjesësh
Gjatë fazës së fundit të zhvillimit të kësaj ore, nxënësit do të punojnë ditarin dypjesësh. Nxënësit bëjnë një vijë vertikale në mes të fletës. Në anën e majtë, nxënësit do të shkruajnë fragmentet e tekstit në të cilat sipas tyre përshkruhet bukuria përrallore e Lules. Ndërsa në anën e djathtë shkruajnë komentet për pjesën.

P.sh. Vargjet e pëlqyera	Reflektime
"Porsa hyrija malsore çoi duert e luejti kambët, *një habi e ambël kapi gjith shpirtnat.* *Nëpër tanë salonin u ndie si një amë lulesh* *mali e si nji gurgullim krojesh të ngrita."*	

Vlerësimi i nxënësve:
Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor, (vlerësim diagnostikues dhe formues).

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësit/et do të reflektojnë rreth tekstit sipas ushtrimit 13. Gjithashtu nxënësit/et do të kenë detyrë të përgjigjen në pyetjen:
Po ju si do të vepronit **në një rast të tillë?**

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore:

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë dhe letërsi shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Rrëfime nga e kaluara		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon përshkrimin dhe rrëfimin në një tekst të caktuar.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
II. Kompetenca të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit

Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
• Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Anekdota

Fjalët kyçe: ndejë, rrëpirë, pjerrët, argat, kallamboq, hala, fanar.

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- dallon veçoritë e fabulës duke konkretizuar secilën prej tyre;
- interpreton me role fabulat;
- gjykon për vlerat e fabulave në tekst.

Kriteret e suksesit:
Rikujton veçoritë e fabulave duke konkretizuar secilën prej tyre.
Interpreton rolin e fabulës.
Vlerëson për vlerën e fabulave në tekst.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri i nxënësit, fleta të bardha, *marker*, tabela

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
edukatë qytetare, histori, gjeografi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Përshkrim vizual
Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të shikojnë në librat e tyre nëfq.25 dhe 26 dhe të përshkruajnë me fjalët e tyre çfarë shikojnë në foto, të komentojnë dhe analizojnë. Më pas, mësuesi/ja shpjegon për nxënësit njësinë e re mësimore "Anekdota".
Ndërtimi i njohurive të reja: Diamanti 7
Mësuesi/ja shpjegon njësinë mësimore dhe udhëzon nxënësit të lexojnë dhe të mbushin kolonat me kuptimin e secilës anekdotë që e lexojnë dhe në kolonën e fundit të shkruajnë për anekdotën. Udhëzohen të ndalen edhe te fjalori për fjalët kyçe.



Pas përfundimit të detyrës në secilin grup prezantojnë punimet e tyre me një nxënës përfaqësues.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia pyetje-përgjigje
Pastaj udhëzohen të punojnë në grupet e tyre detyrat e ndara nga mësuesi/ja.
Grupi i parë – Kuptojmë tekstin –detyra 1; **Grupi i dytë**– Analizojmë tekstin – detyra 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8
Grupi i tretë – Interpretojmë tekstin – detyra9, 1, 11; **Grupi i katër** – Reflektojmë rreth tekstit detyra 12
Mësuesi/ja ndihmon nxënësit nëse është e nevojshme.

Vlerësimi i nxënësve:
Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor, quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur:

Gjeni disa anekdota të tjera me personazhe historike ose jo.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilin nxënës për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë dhe letërsi shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti realist		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit

Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur. • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Pikat e shiut

Fjalët kyçe: Shiu, nata, qyngji, sterna, njerëzit.

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- bën dallimin në mes të bisedës imagjinare dhe reale;
- dallon mesazhin e pjesës;
- vlerëson ndihmën e fqinjëve në momentet e vështira.

Kriteret e suksesit:
Krijon dhe zhvillojnë aftësitë për të thurur biseda imagjinare.
Analizon mesazhin e pjesës.
Çmon ndihmën e fqinjëve duke u ndalur në vlerën dhe mesazhin që përcjell.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: shkencat shoqërore, shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Mendo/puno në dyshe/tregoju të tjerëve
Kjo teknikë i ndihmon nxënësit të reflektojnë mbi pjesën që do të mësojnë, t'u japin formë mendimeve dhe të krijojnë ide rreth ngjarjes që do të zhvillohet në vazhdim. Mësuesi/ja fillon orën mësimore duke përdorur telefonin apo ndonjë mjet tjetër për të inskenuar zhurmën që bën shiu kur bie me rrëmbim (Nëse ka mundësi mund të errësojë klasën dhe të krijojë ndjesinë që shkaktohet kur bie shi i rrëmbyeshëm natën).
Pasi të arrihet efekti i dëshiruar pas 1-2 minutave, mësuesi/ja ndriçon klasën. Pastaj mësuesi/ja shtron pyetjet:
Si mendoni, a harrohen lehtë përjetimet dhe ngjarjet të cilat na ndodhin në të vërtetë?
A njihni ndonjë shkrimtar shqiptar i cili ka rrëfyer në roman kujtimet e fëmijërisë së tij në qytetin e lindjes? Nxënësit mund të japin përgjigjen e saktë (nëse jo), atëherë mësuesi/ja do të njohë nxënësit/et për veprimtarinë letrare të Ismail Kadaresë.
Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënit me këmbime
Lexohet fragmenti i shkëputur nga romani "Kronikë në gur" pastaj mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të diskutojnë dhe shkëmbejnë mendimet duke punuar ushtrimin 1. Më pas, mësuesi/ja kërkon të punohet ushtrimi 6, 7, 8 dhe së bashku me nxënësit rikujtojnë së çfarë është romani.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tryeza rrethore
Nxënësit ndahen në 3 grupe: **Grupi I** –ushtrimet 2, 3, 4 dhe 5; **Grupi II** –ushtrimet 9 dhe 10; **Grupi III** – ushtrimet 11 dhe 12. Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet e tyre para klasës.

Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësimi i nxënësve do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore: diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësit do të punojnë detyrën: Shkruani një rrëfim të shkurtër në të cilin të zërë vend një ngjarje e jetuar ose e dëgjuar rreth rrezikimit të jetës së njeriut nga kushtet e përkeqësuara të motit: përmbytje nga shiu, prishja e digës, ortekët e dëborës, tufani, furtuna etj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore:

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë dhe letërsi shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti realist		**Rezultati i tënxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**

1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II. Kompetenca të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**

1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**

1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara**II. Vlerat dhe qëndrimet**
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Të menduarit krijues.
IV.Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Udhëve të fëmijërisë

Fjalët kyçe: Deti,bregu,valët,vizatim, thirrje,era.

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- parashikon ngjarjen me fjalët kyçe;
- dallon mesazhin në pjesë;
- analizon ngjarjen në pjesë;
- vlerëson veprimet e personazheve.

Kriteret e suksesit:
Shkruan një ngjarje me fjalët kyçe.
Krahason ngjarjen në pjesë.
Çmon veprimet e personazheve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri i nxënësit, fleta të bardha, marker, tabela

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
edukatë qytetare, histori, gjeografi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:Ese e shkurtër (Parashikim me terma paraprakë.)
Në këtëfaqe, mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe si: *Deti,bregu,valët,vizatim,thirrje,era.*
Pastaj udhëzohen të shkruajnë një ese të shkurtër me fjalët kyçe duke përdorur shprehje të përshtatshme për krijim të ri.Pas prezantimit, mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë "Udhëve të fëmijërisë" pastaj shpjegon për nxënësit.
Ndërtimi i njohurive të reja:Punë në grupe
Në këtë fazë udhëzohen të punojnë në dy grupe. Nxënësit duhet të kenë hapësirë për të komunikuar me nxënësin tjetër.P.sh. një grup duhet të ketë dy rrathë me karrige të kthyera drejtë në mënyrë që nxënësit të komunikojnë pa u kthyer.Në klasë formohen dy rrathë me karrige dhe nxënësit të cilët ulen në mes janë grupi i parëndërsa nxënësit që ulen në rrethin e dytëdo të jenë grupi i dytë.

Pastaj udhëzohen për lexim.
Grupi i parë lexon pjesën e parënë faqen 33.
Grupi i dytë lexon vazhdimin e pjesës në faqet 34 dhe 35.
Nxënësit udhëzohen të lexojnë në heshtje dhe pas përfundimit të kohës së caktuar, ata duhet të komunikojnë me nxënësit e grupit që i kanë afër.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia pyetje-përgjigje
Nxënësitudhëzohen të punojnë në grup detyrat e ndara nga mësuesi/ja.
Grupi i parë – Kuptojmë tekstin –detyra 1, detyra 2 dhe 3; **Grupi i dytë**– Interpretojmë tekstin –detyra 4, 5, 6 (Të ndihmojmë njëri-tjetrin) dhe Gjuha e tekstit – detyra 7, 8.Mësuesi/ja ndihmon nëse është e nevojshme.
Pastaj dy grupet reflektojnë rreth tekstit duke debatuar bashkë me mësuesin/en.Detyrat 9, 10.
9.Veprat artistike kanë vlera të mëdha, kur frymëzohen nga jeta e gjallë njerëzore. Flisni dhe vlerësoni këtë mesazh të rëndësishëm të tekstit, duke u mbështetur në filmat dhe librat që keni lexuar.
10. A mendoni se librat na ndihmojnë ta kuptojmë jetën më mirë? Ç'lloj librash ju pëlqen të lexoni më shumë?

Vlerësimi i nxënësve:
Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor, quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar,shkruar dhe prezantuar(Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruani një ese me temë: "A është e lehtë të pranosh këshilla apo sugjerime?" Lexojini në klasë dhe diskutoni rreth tyre.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilin nxënës për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë dhe letërsi shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti realist		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
• Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV.Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst.
• Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Sarajet e bardha

Fjalët kyçe: Mirushja, Fatosi, gjuha amnore, arbënisht, Ulqini, Prishtina, Sicili,turist, studenti.

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- analizon temën kryesore të tregimit;
- zgjeron njohurit për gjuhën amtare;
- mëson për historinë e gjuhës amtare dhe fatin e popullit shqiptar.

Kriteret e suksesit:
Diskuton për temën kryesore të tregimit duke zgjeruar njohuritë për gjuhën dhe kombin.
Kupton se gjuha shqipe dhe gjuha arbënishte janë një gjuhë.
Vlerëson se pavarësisht kohës dhe rrethanave gjuha bashkon kombin.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: shkencat shoqërore, shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:Kllaster
Në dërrasë të zezë, mësuesi/ja shkruan një fjali, p.sh.:
-Gjuha shqipe është gjuha amtare e popullit shqiptar, a mund të dini në sa shtete jetojnë shqiptarët dhe flitet gjuha shqipe sot?
Nxënësit/et do të sjellin idetë dhe mendimet e tyre, mësuesi/ja me ndihmën e njërit nxënës do të pasqyrojë në dërrasën e zezë në formën e pemës së mendimeve idetë e nxënësve.



Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia pyetje-përgjigje
Pas leximit të pjesës së shkëputur nga romani "Sarajet e bardha" dhe njohjes me veprimtarin letrare të autorit Vehbi Kikaj, mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të përgjigjen në pyetjet e ushtrimit 1. Nxënësit i lexojnë përgjigjet duke parafrazuar p.sh. përgjigja e pyetjes së parë: Mirushja dhe Fatosi pushimet verore po i kalojnë në bregdetin e Ulqinit...
Pas përfundimit të përgjigjeve të ushtrimit të parë, mësuesi/ja ndan klasën në 4 grupe dhe secili grup punon detyrat e caktuara: **Grupi I** – ushtrimet 2,3,4,5; **Grupi II** – ushtrimet 6,7,8; **Grupi III** – plotëson tabelën e ushtrimit 9; **Grupi IV** – ushtrimet 10,11,12.
Kujdes* *Në pyetjen e ushtrimit 11 nxënësit/et kanë fjalën "sintagma" e cila mund të jetë e pa dëgjuar më parë për ta.Sintagma nënkupton një grup fjalësh të cilat kanë funksion të caktuar. Varësisht nga ndërtimi sintagma apo togfjalëshi emërtohet sipas fjalës kryesore apo fjalës bosht. P.sh. ngjyra e kuqe = sintagmë apo togfjalësh emëror; lexoj gazetën= sintagmë apo togfjalësh foljor.*
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim
Në pjesën e fundit të orës mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që në grupe të punojnë, konsultohen dhe pastaj të përgjigjen në pyetjet e ushtrimeve:
Grupi I – ushtrimin 13; Grupi II – ushtrimin 14; Grupi III – ushtrimin 15.
Ndërsa grupi i IV do të ketë detyrë të reflektojë rreth fjalisë përmbyllëse të njësisë mësimore: ***"- Po, sigurisht, s'ka mundë të mësojë gjuhën tonë aq mirë. E mandej, ata arbneshë ndoshta vetë flasin pak ma ndryshe? – tha Mirushja. – Unë, megjithatë, e kuptoj dhe do tëdëshirojsha tërrij pak me të."*** - dhe të shprehin mendimin e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësimi i nxënësvedo të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore: diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Nxënësit me ndihmën e prindërve do të mbledhin informacion rreth mënyrës sesi arbëreshët e Italisë kanë ruajtur gjuhën dhe kulturën e tyre të origjinës edhe pas shumë shekujsh. Informacionet e mbledhura do t'i hedhin në letër për të diskutuar në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë dhe letërsi shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti realist		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**

1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**

1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**

1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. Shkathtësitë e komunikimit

Të dëgjuarit dhe të folurit

• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.

Të lexuarit

• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Pasuron fjalorin.

Të shkruarit

• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
• Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Fshati me pesë kodra

Fjalët kyçe: përroskë, rrëke, shoke, dimi.

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- parashikon zhvillimin e ngjarjes duke u nisur nga ilustrimi figurativ dhe titulli i fragmentit;
- analizon ngjarjen në tekst;
- krijon një shkrim vlerësues për të njëjtin tekst.

Kriteret e suksesit:
Përshkruan zhvillimin e ngjarjes duke u nisur nga ilustrimi dhe titulli i fragmentit.
Komenton ngjarjen në tekst.
Krahason shkrimin vlerësues për të njëjtin tekst.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri i nxënësit, fleta të bardha, marker, tabela

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
edukatë qytetare, histori, gjeografi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Imagjinata e drejtuar
Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe:
Fshati, lumi, përroskë, rrëke, shoke, dimi, oxhaku.
Pastaj udhëzon të shikojnë ilustrimin figurativ fq.43 dhe më pas të lexojnë titullin e fragmentit. Nxënësit duke u mbështetur në fjalët kyçe të përzgjedhura nga rrëfimi, nxiten të mendojnë se çfarë mund të rrëfejë autori.
Nxënësit/et shfaqin imagjinatën e tyre dhe mësuesi/ja përzgjedh modelin që përputhet me fragmentin.
Pas prezantimit, mësuesi/ja i shpjegon nxënësit/et.
- **Ndërtimi i njohurive të reja: Mendo-Çiftëzo-Ndaj**
- Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë në grupet e tyre punuese detyrat e tekstit.
- **Grupi i parë –** ushtrimi 1; **Grupi i dytë** – ushtrimi 2, 3, 4, 5, 6 ; **Grupi i tretë** – ushtrimi 7, 8, 9.
- Nxënësit shënojnë në fletore tabelën e udhëzuar nga mësuesi/ja..

Pyetja	Mendimi im	Mendimi i shokut	Ne mendojmë

Pas prezantimit reflektojmë rreth tekstit.
A mendoni se vendi ku jetojnë personazhet ndikojnë në karakterin dhe jetën e tyre?
Nxënësit debatojnë së bashku me mësuesin/en.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh
Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen të punojnë një pesëvargësh. P.sh.,

Fshati
i bukuri vjetër
Jetohet punohet lëshohet
I pesë kodrave ruan blerimin
Katund

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Përshkruani natyrën dhe relievin e fshatit tuaj ose të një fshati që ju ka bërë përshtypje të veçantë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilin nxënës për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë dhe letërsi shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti realist		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve •Respekton parimet e të tjerëve
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Droja (ora I)

Fjalët kyçe: skuadra, fëmijë, garë, tradhti, hakmarrje, falje, shtrëngim duarsh.

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- portretizon personazhet duke u ndalur në çdonjërin prej tyre;
- dallon shprehjet e figurshme dhe mesazhin e pjesës;
- vlerëson sjelljen dhe vendimet që merr Artani.

Kriteret e suksesit:
Përshkruan personazhet duke u ndalur në çdonjërin prej tyre.
Përkrah sjelljen dhe vendimet e matura të Artanit.
Analizon shprehjet e figurshme dhe mesazhin që përcjell pjesa.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore, shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh
Mësuesi/ja pyet nxënësit: *Keni marrë pjesë ndonjëri në ndonjë garë? P.sh. futboll, ski, not...Pasi keni përfunduar garën si keni menduar, ishte rezultati i drejtë apo... ju duk se ju bënë padrejtësi? U mundua ndonjëri nga shokët e skuadrës rivale t*ë *bëj hile?*
Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA/Marrëdhënia pyetje-përgjigje
Për të realizuar me sukses këtë njësi mësimore, mësuesi/ja duhet ta ndajë mësimin në dy orë. Në orën e parë përdorë teknikën *DRTA* - të lexuarit e drejtuar, për të vazhduar më pas në orën e dytë me teknikën *marrëdhënia pyetje-përgjigje.*

Mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë titullin e njësisë mësimore "Droja" dhe fillon të shpjegojë se kjo pjesë është shkëputur nga romani me po të njëjtin titull i shkruar nga shkrimtari kosovar Rifat Kukaj. Pasi nxënësit marrin informacionin rreth krijimtarisë letrare të shkrimtarit, mësuesi/ja ndan klasën në 3 grupe. Secilit grup i caktohet pjesa që do të lexojnë. Pas leximit, grupet do t'u përgjigjen pyetjeve të ndërtuara në mënyrë grafike më parë nga mësuesi/ja

Çfarë mendoni se do të ndodhë?	Çfarë provash keni?	Si ndodhi në të vërtetë?

Grupi I – do të lexojë dhe do të reflektojë për pjesën e parë që fillon nga fillimi deri te "Është vonë! - tha Artani. Tani rezultatet i kanë botuar gazetat dhe i kanë dhënë radioja e televizioni."
Grupi II – do të vazhdojë leximin në pjesën e dytë deri në fund të saj.
Grupi III – fillon nga pjesa e tretë nga fjalia: "Gazmendi tashmë kishte hapur derën me kujdes që të mos i binte në sy askujt" deri në fund. Pas përfundimit të leximit të pjesëve nxënësit do të paraqesin para shokëve/shoqeve mendimet dhe idetë e tyre.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Puno dyshe/shkëmbe mendime
Mësuesi/ja drejton vëmendjen e klasës drejt diskutimit pro dhe kundër rreth çështjes.
A veproi mirë Shkëlzeni? A mund të quhet fitore, fitorja e skuadrës së tij? Po qëndrimi dhe sjellja e Artanit karshi Shkëlzenit si ju duket? Sipas jush a veproi mirë Artani që ndaloi shokët e grupit të realizonin planin e hakmarrjes?
Vlerësimi i nxënësve:
Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor: diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Nxënësit do të kenë detyrë të lexojnë të gjithë pjesën dhe pastaj të shkruajnë një ngjarje apo ndodhi që iu ka ndodhur në të vërtetë dhe u ka mbetur në mendje.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë dhe letërsi shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti realist		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5. Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
7. Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.
8. Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur. • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitet. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit. • Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. • Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. • Parafjalë, lidhëz. • Shenjat e pikësimit. • Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Droja (ora II)

Fjalët kyçe: skuadra, fëmijë, garë, tradhti, hakmarrje, falje, shtrëngim duarsh.

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- portretizon personazhet duke u ndalur në çdonjërin prej tyre;
- dallon shprehjet e figurshme dhe mesazhin e pjesës;
- vlerëson sjelljen dhe vendimet që merr Artani.

Kriteret e suksesit:
Përshkruajnë personazhet duke u ndalur në çdonjërin prej tyre.
Analizojnë shprehjet e figurshme dhe mesazhin që përcjell pjesa.
Përkrahin sjelljen dhe vendimet e matura të Artanit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Shkencat shoqërore, shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Mësuesi/ja pyet nxënësit: Pasi lexuat pjesën "Droja", a mund të tregoni nëse jeni ndodhur edhe ju në situata të tilla? Keni kërkuar falje për sjelljen e padrejtë karshi shokut/shoqes? Apo e kundërta, iu kanë kërkuar juve falje? Shpjegoni emocionet që keni ndjerë? Nxënësit do të reflektojnë në dyshe dhe do të fillojnë të shprehin mendimet e tyre. **Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA/Marrëdhënia pyetje-përgjigje** Nxënësit tani kanë marrë mjaftueshëm informacione rreth ngjarjes dhe ecurisë së saj, mësuesi/ja udhëzon nxënësit që nëpërmjet diskutimit të përgjigjen në pyetjet e ushtrimit 1 (kuptojmë tekstin). Pastaj ndan klasën në 4 grupe, të cilat do të punojnë ushtrimet në tekstin letrarë. **Grupi I -** ushtrimet 2, 3. **Grupi II -** ushtrimet 4, 5. **Grupi III** - ushtrimin 7. **Grupi IV -** ushtrimet 8, 9. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim Mësuesi/ja drejton vëmendjen e klasës drejt diskutimit për fragmentet e shkëputura nga pjesa "Droja". **Grupi I -** do të diskutojë për qëndrimin e shokëve të Shkëlzenit: *"Shokët e Shkëlzenit jo vetëm që ishin të gëzuar, por filluan edhe ta tallnin ekipin e Artanit".* **Grupi II -** diskuton për mënyrën se si Artani ndaloi shokët e tij të hakmerreshin: *"- Në më keni shok, ndaluni! - i luti prapë.* *- Mirë por garat duhen anuluar! - u kërcënua Liraku. Sytë i shkrepnin.* *- Është vonë! - tha Artani. Tani rezultatet i kanë botuar gazetat dhe i kanë dhënë në radioja e televizioni."* **Grupi III -** diskuton për mënyrën se si Artani fal Shkëlzenin: *"Të qoftë falur! Dy duar të njoma u shtrënguan miqësisht. Fort, gjatë. Ngrohtë. Gati u dolën lot nga ngazëllimi."* **Grupi IV** - diskuton për qëndrimin e Shkëlzenit pasi fiton garën me anije: *"Shkëlzeni mbante kokën të ulur. Një vajzë zeshkane, me një kordele të mëndafshtë në flokë, tha:* *- I çuditshëm qenka ky djalë! Arriti këtë sukses kaq të madh dhe e kokën e mban ulur."* Nxënësit do të dëgjojnë diskutimet dhe qëndrimet e secilit grup dhe pastaj të gjithë si klasë do të nxjerrin konkluzionet se vendimi dhe qëndrimi i Artanit për të falur Shkëlzenin ishte i drejtë dhe bujar. Artani fitoi më shumë sesa një garë, ai fitoi besimin e të gjithë shokëve dhe shoqeve. Pasi të kenë përfunduar diskutimet, mësuesi/ja pajtohet me qëndrimet pozitive të nxënësve dhe u mund t'u drejtohet me këto fjalë: ***Të falësh shokun/qen, të shtrish dorën e pajtimit dhe të dish të kërkosh falje është njerëzore.***
Vlerësimi i nxënësve: Do të kryhet në bazë të pjesëmarrjes në mënyrë aktive gjatë zhvillimit të orës: diagnostikues dhe formues.
Detyrat dhe puna e pavarur
Nxënësit do të bazohen në ushtrimin 6 dhe do të kenë detyrë të shkruajnë një shkrim të shkurtër me temë: A duhet të lidhim besë për punë jo të mira?
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë dhe letërsi shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti realist		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**

1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5. Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
7. Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.
8. Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**

1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**

1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.
8. Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
• Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman.
• Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitet. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit. • Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. • Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit.
• Parafjalë, lidhëz. • Shenjat e pikësimit. • Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Gjyshja ime
Fjalët kyçe: vujçja, manar, kunadhe, arme, pëqi, kaliqafë, doçka.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - përshkruan njeriun më të dashur; - analizon personazhet në tregim; - vlerëson letërkëmbimin në tregim. **Kriteret e suksesit:** Shkruajnë për njeriun më të dashur. Analizojnë personazhet në tregim. Vlerësojnë letërkëmbimin në tregim.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, fleta të bardha, marker, tabela
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: edukatë qytetare, histori, gjeografi
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Shkrim i shkurtër** Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të shkruajnë një shkrim të shkurtër si letërkëmbim me shokun/shoqen. Shkruani një shkrim të shkurtër për njeriun më të dashur që keni dhe përshkruaj pamjen, sjelljen dhe dashurinë që ju ofron ky person. Pas përfundimit udhëzohen të këmbejnë letrat dhe të lexojnë për zgjedhjen e shokut/shoqes. Pas këmbimit të lerave dhe leximit në heshtje mësuesi/ja pyet nxënësit: Cila letër e shokut/shoqes duhet të lexohet në klasë dhe të dëgjojnë të gjithë atë përshkrim të bukur? Disa nxënës reagojnë dhe mësuesi/ja zgjedhë disa nxënës të lexojnë letrën e shoku/shoqes. Pastaj mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë “Gjyshja ime” dhe shpjegon për nxënësit. “Gjyshja ime” është një nga tregimet e përmbledhjes “Të fala nga fshati”, të shkrimtarit Sterjo Spasse. Libri është ndërtuar në bazë të letrave. Secili prej tregimeve është një letër që Ylli, një djalosh që ndjek shkollën, i dërgon Sokolit shokut të tij bashkëmoshatar. Ylli jeton në fshat, ndërsa Sokoli jeton në kryeqytet. Në letërkëmbimin e tyre, ata i tregojnë njëri-tjetrit për familjet, vendin ku jetojnë, por edhe për shokët dhe shoqet e shkollës dhe të afërmit. “Gjyshja ime”, është një prej letrave të Yllit, në të cilën ai përshkruan një nga njerëzit më të dashur të tij. Në këtë letër përshkruan pamjen, sjelljen dhe në mënyrë të veçantë dashurinë e madhe që i jep ajo. Sterjo Spasse (1914-1989) e filloi veprimtarinë letrare në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar dhe shkroi në prozë. Ai është autor edhe në studime pedagogjike, tekste shkollore etj. Ai ka botuar katër përmbledhje tregimesh:”Kuror rinie”, “Në krahët e një femre”, “Nusja pa duvak” dhe “Të fala nga fshati”, si dhe dhjetë romane, ndër të cilat përmendim: “Pse?”, “Afërdita”, “Ata nuk ishin vetëm”, “Afërdita përsëri në fshat” etj. **Fjalor** vujçja – daja; manar – fëmijë i urtë e i përkëdhelur, që nuk u ndahet prindërve; kunadhe – dhelpër; arme – lakër turshi; pëqi – prehër kalipiç – kaliqafë, këmbët rreth qafës; doçka – dora e fëmijëve të vegjël. **Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia-pyetje-përgjigje** Pas leximit të tekstit nxënësit/et udhëzohen të punojnë detyrat e ndara nga mësuesi/ja. **Grupi i parë** – Kuptojmë tekstin – detyra 1. p.sh., a) (Gjyshja në tregim është nëna e nënës). **Grupi i dytë** – Analizojmë tekstin – detyra 2, 3, 4, 5 dhe Interpretojmë tekstin – detyra 6, 7. **Grupi i tretë** – Gjuha e tekstit – detyra 8, 9, 10. Ushtrimi “shkruajmë” është për të gjitha grupet. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit nëse kanë nevojë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Citat-koment
Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të zgjedhin nga tregimi dhe të shkruajnë pjesën e pëlqyer për komentim. P.sh.:

Citat	Koment

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Përshkruani portretin fizik si dhe marrëdhënien që keni me gjyshin ose gjyshen tuaj. Ndaluni te paraqitja e jashtme.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilin nxënës për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë dhe letërsi shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti realist		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5. Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
7. Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.
8. Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.
- kritikon tekstin dhe mban qëndrim për mendimin;
- krahason punimin me shokun/shoqen.

Kriteret e suksesit:
Përshkruan ide imagjinare që lidhen me temën.
Vlerëson tekstin dhe mban qëndrim për mendimin.
Dallon punimin me shokun/shoqen.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:
Libri i nxënësit, fleta të bardha, marker, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
edukatë qytetare, histori, gjeografi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kllaster
Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan titullin e njësisë mësimore në tabelë "Princi dhe i varfri" dhe udhëzon nxënësit për të ndërtuar kllaster p.sh.:



Pas përfundimit të kllasterit, mësuesi/ja shpjegon për nxënësit.

Kjo pjesë letrare është shkëputur nga romani "Princi dhe i varfri", me nëntitull "Një përrallë për të rinjtë e të gjitha moshave". Në qendër të tij janë dy fëmijë që kanë lindur në të njëjtën ditë. Ata kanë çuditërisht pamje shumë të ngjashme, por kanë fate krejtësisht të ndryshme. Njëri është princ dhe jeton në një pallat, ndërsa tjetri jeton në një shtëpizë të vogël, në një lagje të ndotur. Në një takim të rastësishëm, të dy djemtë do të këmbejnë jo vetëm rrobat, por edhe fatin. Princin Eduard që kishte veshur rrobat e Tomit të varfër e hedhin në rrugë, ndërsa Tomit të varfër që kishte veshur rrobat e princit fillojnë t'i përulen me plot nderime.

Mark Tuejn (1835-1910) ka qenë një shkrimtar shumë i njohur amerikan. Ditën kur lindi Tuejni, u shfaq kometa Hallei. Ai parashikoi se do të vdiste kur kometa të kthehej dhe ashtu ndodhi vërtet. Ai ka shkruar romanet: "Aventurat e Tom Sojerit", "Aventurat e Hakëlberi Finit", "Princi dhe i varfri" etj.

Fjalor: paradë – parakalim; ceremoni – veprimtari të përcaktuara deri në imtësitë më të vogla, që realizohen për ngjarje të veçanta dhe të rëndësishme; kurorëzim – këtu: shpall mbret; lord – titull aristokratik që trashëgohet; fron – këtu: ndenjëse ku ulet mbreti; kurorë – këtu: rreth i stolisur me ar dhe gurë të çmuar; protektor – këtu: person i caktuar për të mbrojtur dhe drejtuar dikë; vulë – mjet i vogël zyre, ku gdhenden simbole të ndryshme, që ngjyhet me bojë dhe vendoset mbi shkresa si shenjë dalluese e vërtetësisë së tyre; e zorshme – e vështirë; kabinet – dhomë pune e dikujt që ka një pozicion të lartë; ngurronte – ishte në mëdyshje, nuk ishte i sigurt.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia – Pyetje-përgjigje – Diagrami i venit
Në këtë fazë pas leximit të njësisë mësimore, nxënësit udhëzohen të punojnë në grupet e tyre detyrat e ndara nga mësuesi/ja.

Grupi i parë: Analizojmë tekstin – detyrat 2, 3.
Nëpërmjet diagramit të Venit, gjeni të përbashkëtat dhe dallimet mes Tom Kentit dhe Eduardit.



Përshkruani me nga një fjali si dukej princi dhe si dukej Tomi në ditën e kurorëzimit.
Grupi i dytë: Interpretojmë tekstin detyrat 4, 5.
Grupi i tretë: Gjuha e tekstit: – detyrat 6, 7.
Mësuesi/ja ndihmon nxënësit nëse ka nevojë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit
8. Në këtë fazë reflektojmë rreth tekstit.
Si e thërret mbreti Eduard Tom Kentin në fund të tekstit? Çfarë kuptoni nga kjo mënyrë komunikimi? 9. A mendoni se Eduardi do të tregohet mirënjohës për miqtë që ka njohur në këtë aventurë të çuditshme?
10. A duhet gjykuar njeriu nga pamja apo nga veprimet që bën?



Vlerësimi i nxënësve:
Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur
Përshkruani me disa fjali si e imagjinoni marrëdhënien e mëvonshme ndërmjet Eduardit dhe Tom Kentit.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësuesit duhet të japin komentet e tyre për secilin nxënës për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë dhe letërsi shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Rrëfime nga e kaluara. Teksti fantastik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Klorela
Fjalët kyçe: Anije kozmike, Flumina, algë, Klorela, Jona, Dori, Nini.
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Dallon personazhet dhe rolin e tyre në rrëfim; Zbulon elementet fantastike në rrëfim; Jep mendimin e tij/saj duke mbajtur qëndrim se një udhëtim i tillë ndoshta mund të ndodhë vërtetë në të ardhmen. **Kriteret e suksesit:** Klasifikon personazhet dhe detyrat e tyre në rrëfim. Ilustron elementet fantastike të rrëfimit. Zbërthen fjalët dhe veprimet e fushës teknologjike në rrëfim.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Imagjinata e drejtuar Nxënësit/et nxiten të mendojnë mbi çështjen: - A do të kishit dëshirë të udhëtoni në Mars? Nëse po, si do ta realizonit udhëtimin? Mësuesi/ja parashtron pyetjen. Nxënësit fillojnë të thurin mendimet e tyre përmes fantazisë, ata/ato krijojnë në mendimet e tyre udhëtimin imagjinar në ***planetin e kuq***, Marsin. Sipas fantazisë sjellin versionin e vet. Mësuesi/ja dëgjon rrëfimet e tyre me vëmendje dhe përpiqet të ndalet në konceptet të cilat fëmijët sjellin për tregimin fantastiko-shkencor. Një nxënës me ndihmën e mësuesit shkruan në dërrasë të zezë:    **Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia pyetje-përgjigje** Mësuesi/ja u tregon nxënësve se pjesa që do të lexojnë bën fjalë për një udhëtim imagjinar të dy fëmijëve në planetin Mars. Ata udhëtojnë me anijen kozmike "Flumina, për të plotësuar nevojën e të ushqyerit të shëndetshëm shkencëtarët kanë vendosur në anije një bimë uji, algën "Klorela", e cila është eksperimentuar më parë. Kjo algë me aftësitë e saj shumuese ndihmon ekuipazhin e anijes të ushqehet dhe të jetoi shëndetshëm edhe në hapësirën e ***planetit të kuq,*** Marsit. Mësuesi/ja njeh nxënësit/et edhe me veprimtarinë letrare të shkrimtarit për fëmijë Bardhyl Xhama. Pasi lexohet pjesa, zbërthehen fjalët e panjohura dhe të gjithë si klasë zgjidhin ushtrimin 1. Përgjigjet për pyetjet: 1a), 1b), 1d) dhe 1dh) mësuesi/ja i shënon në dërrasë të zezë (Këto të dhëna do t'i ndihmojnë nxënësit të përgjigjen në pyetjet e ushtrimit 3 dhe 4). Klasa ndahet në 4 grupe dhe punojnë ushtrimet që i cakton mësuesi/ja. Pastaj, përfaqësuesit e grupeve paraqesin para shokëve/shoqeve përgjigjet e tyre duke i shoqëruar me komente. Grupi I - ushtrimin 2, Grupi II - ushtrimet 3 dhe 4, Grupi III - ushtrimin 7, Grupi IV - ushtrimet 8 dhe 9. (Më parë, mësuesi/ja gjatë shtjellimit të njësisë ka vënë theksin te njëri prej epiteteve që kërkohen në detyrë.) **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Mendo/puno në dyshe/tregoju të tjerëve** Për të realizuar këtë teknikë, mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që duke punuar në dyshe të kryejnë ushtrimet 5 dhe 6.

Cili ishte qëllimi i këtij udhëtimi? Au realizua ai?	Do të donit të ishit pjesë e një udhëtimi të tillë në një planet tjetër?
Qëllimi i këtij udhëtimi ishte të krijojmë një përfytyrim të plotë që të jep udhëtimi në hapësirë... në planetin e thatë... planetin e kuq.....eksperimentimi i algës Klorela a do të mund të mbijetonin udhëtarët në Flumina?.... .....etj.	Po- Më pëlqejnë aventurat..... Jo- kam frikë nga e panjohura.....

Vlerësimi i nxënësve: do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore: Diagnostifikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Nxënësit do të shkruajnë një tregim të shkurtër me temën "Udhëtimi në Hënë", sipas dëshirës së tyre p.sh. mund të emërojnë ndonjë planet sipas imagjinatës së tyre dhe të krijojnë tregimin sipas fantazisë së tyre. Ata duhet të mbështesin shkrimin e tyre duke u bazuar te këshillat që gjenden në tekstin e tyre në fund në faqen 78 te nënrubrika "Shkruajmë".

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Rrëfime nga e kaluara. Teksti fantastik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**

1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**

1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**

5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutimMotivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
• Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme **III. Aftësitë dhe shkathtësitë**
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Momoja dhe lodrat e reja të miqve të saj.

Fjalët kyçe: Momoja, fëmijët, nuk bëzajtën, të pikëlluar, prospekte

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:
- dallon aktivitetet e lira dhe të menaxhuara;
- analizon temën kryesore në fragment duke gjykuar në fantazinë e krijuar;
- gjykon ndikimin e teknologjisë te fëmijët.

Kriteret e suksesit:
Rikujton aktivitetet e lira, pa teknologji, dhe të menaxhuara.
Vlerëson personazhet në fragment.
Gjen dallimet mes fjalëve lodër dhe lojë (send dhe veprimtari).

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI - Fleta të bardha, marker, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Edukatë qytetare, histori, gjeografi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh
Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjen: A është më argëtuese të luani me shokët/shoqet me lodra të ndryshme të krijuara nga ju, apo të qëndroni të mbyllur duke luajtur me lojëra elektronike?
Mësuesi/ja sjellë për nxënësit disa foto të përgatitura më parë për këtë njësi mësimore (Fotot të jenë krahasuese. P.sh. Një foto ku duken fëmijët dikur dhe tani).
Nxënësit/et përgjigjen dhe diskutojnë së bashku për pyetjen duke komentuar qëndrimet e tyre.
Pas diskutimeve, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore "Momo dhe lodrat e reja të miqve të saj" dhe u tregon nxënësve përmbajtjen e pjesës.
Ndërtimi i njohurive të reja: Secili mëson një – Pyetje-përgjigje
Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën në heshtje dhe pas leximit do të prezantojnë njësinë secili grup sipas detyrës së udhëzuar.
Grupi i parë: Diskutues - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe pas leximit të tregojnë ngjarjen para nxënësve tjerë. Një nxënës prezanton grupin (p.sh. Nxënësit tregojnë pjesën në pika të shkurta sepse të gjithë e kanë lexuar).
Grupi i dytë: Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të mendojnë për detyrat jashtë shkollës, p.sh. ku munden të gjejnë material shtesë dhe cili është i nevojshëm. Grupi i dytë ka të drejtë të shtyjë nxënësit për detyra të shtëpisë.
Grupi i tretë: Kritikët - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të krijojnë mendime pozitive dhe negative duke përdorur komentet e tyre për të bindur nxënësit e tjerë për qëndrimin e tyre.
Pas prezantimit dhe debateve grupet udhëzohen të punojnë ushtrimet.
Grupi i parë: ushtrimi 1 ushtrimi 2
Grupi i dytë: ushtrimet 3, 4, 5
Grupi i tretë: 6, 7, 8, 9
Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse kanë nevojë.
Pastaj udhëzohen për detyrën:
Përshkruani një fundjavë me prindërit tuaj. Si e kaloni kohën me ta? Çfarë veprimtarish bëni së bashku? Çfarë ndjesish ju jep koha që kaloni bashkë? Provoni të luani pa sende, për shembull, luani me mimikën tuaj para pasqyrës, këndoni një këngë vetëm me një zanore, bëni muzikë me përplasje buzësh etj. Gjithashtu provoni të krijoni lodra me sende të panevojshme, si shuka letrash a aeroplanë me palosje nga ambalazhet etj. A ju duket argëtuese?
Në këtë fazë reflektojmë rreth tekstit.
Mësuesi/ja pyet nxënësit: Diskutoni se cila sjell më shumë gëzim: loja e luajtur mes shokësh në natyrë, që i bën ata aktivë, apo një lodër e cila i kryen të gjitha vetë dhe fëmija është vetëm soditës pasiv?

Po	Pse	Jo

Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe diskutojnë me shokët dhe shoqet për qëndrimet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Bëni një libërth me tregime fantastiko-shkencore, të krijuara nga nxënësit e klasës suaj. Ftoni edhe nxënësit e klasave të tjera, duke përzgjedhur tregimet më të mira për librin. Kërkoni ndihmën e shtëpive të ndryshme botuese për të botuar librin tuaj. Dhurojuni kopje të tij bashkëmoshatarëve tuaj në komunitet, shkollave të tjera fqinje apo qendrave të ndryshme për fëmijë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Rrëfime nga e kaluara. Teksti fantastik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**

1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5. Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**

1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**

1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
I. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Momo takon zotërinë gri.

Fjalët kyçe: hipnotizuar, kukulla e përkryer.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:
- dallon elementet fantastike në tekst;
- analizon temën kryesore në fragment duke gjykuar në fantazinë e krijuar;
- krijon një shkrim të njëjtë fantastik duke ndryshuar përfundimin.

Kriteret e suksesit:
Rikujton tregimin fantastiko-shkencor.
Vlerëson personazhet në fragment.
Kritikon fantazinë e krijuar në tekst.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI - Fleta të bardha, marker, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Edukatë qytetare, histori, gjeografi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh
Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjen: *A mund të zëvendësohet koha që kalojmë me shokët dhe miqtë me ndonjë gjë tjetër?*
Nxënësit/et përgjigjen dhe diskutojnë së bashku për pyetjen duke komentuar qëndrimet e tyre.
Pas diskutimeve, mësuesi/ja shkruan titullin e njësisë mësimore në tabelë "Momo takon zotërinë gri" dhe shpjegon për nxënësit:
Në këtë pjesë letrare tregohet se si papritmas, nga hiçi, shfaqet një "zotëri gri", që e nxit Momonë të luajë me një kukull të përkryer, madje të kërkojë lodra të tjera shtesë. Ai i thotë se Momoja tani nuk ka nevojë për shokët e saj. Duke nënkuptuar që miqtë mund të zëvendësohen me lojëra materiale të teknologjisë moderne. Ai ishte gri dhe i ngjallte frikën çdokujt që e kishte pranë, pasi i nxiste njerëzit që vetëm të punonin dhe të mos qëndronin me familjen dhe miqtë e tyre.
Ndërtimi i njohurive të reja: Secili mëson një - Pyetje-përgjigje
Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën në heshtje dhe pas leximit do të prezantojnë njësinë secili grup sipas detyrës së udhëzuar.

Grupi i parë: Diskutues - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe pas leximit të tregojnë ngjarjen para nxënësve tjerë. Një nxënës prezanton grupin (p.sh. Nxënësit tregojnë pjesën në pika të shkurta sepse të gjithë e kanë lexuar).
Grupi i dytë: Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të mendojnë për detyrat jashtë shkollës, p.sh. ku munden të gjejnë material shtesë dhe cili është i nevojshëm. Grupi i dytë ka të drejtë të obligoj nxënësit për detyra të shtëpisë.
Grupi i tretë: Kritikët - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të tregojnë mendimet e tyre (pozitive dhe negative) duke përdorur komentet e tyre për të bindur nxënësit tjerë për qëndrimin e vet.
Pas prezantimit grupet udhëzohen nga mësuesi/ja të punojnë ushtrimet.
Grupi i parë: Kuptojmë tekstin - ushtrimi 1. Përgjigjuni pyetjeve. a), b), c)
Grupi i dytë: Analizojmë tekstin - ushtrimet 2, 3, 4
Grupi i tretë: Gjuha e tekstit - ushtrimet 7, 8, 9, 10
Gjeni në tekst cilat nga elementet e tregimit fantastik shfaqen? Shënojini ato në tabelë, p.sh.:
Elemente magjike
Elemente të mrekullisë
Dukuri të mbinatyrshme
Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit
Në këtë fazë reflektojmë rreth tekstit.
Mësuesi/ja pyet nxënësit: Si mendoni ju, a shprehet dashuria nëpërmjet dhuratave të shtrenjta gjithmonë?

Po Jo

Pse

Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe diskutojnë me shokët dhe shoqet për qëndrimet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shkruani një mbyllje tjetër për këtë pjesë letrare.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Rrëfime nga e kaluara. Teksti fantastik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**

1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**

1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**

1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. Shkathtësitë e komunikimit

Të dëgjuarit dhe të folurit

• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.

Të lexuarit

• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.

Të shkruarit

• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Stinët në planetin e kuq

Fjalët kyçe: Presidenti i planetit, kalamajtë, tekanjozët, stinët, asambleja.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:
- përshkruan mjedisin dhe ngjarjet në rrëfim;
- zbulon elementet fantastike dhe emocionet që ato përcjellin te personazhet;
- dallon mesazhin të cilin përçon rrëfimi.

Kriteret e suksesit:
Analizon mjedisin dhe natyrën në rrëfim.
Vlerëson dhe përkrah qëndrimin dhe vendimin e Asamblesë së kalamajve për të dënuar stërtekanjozët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Përshkrim vizual - Diskutim
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të hapin librat në faqen 87 dhe të hedhin sytë në foton që është paraqitur aty. Nxënësit/et do të kenë detyrë që për pak çaste, duke u përqendruar në foton që kanë përpara, të krijojnë ide se për çfarë ka të bëjë rrëfimi i radhës.
Do të fillojë përshkrimi vizual p.sh.: Robotët në planetët e sistemit diellor..... Planeti dirigjohet nga robotët..... Robotët marrin në dorë fatin e planetëve... etj.
Më pas, mësuesi/ja shkruan titullin e rrëfimit "**Stinët në planetin e kuq**" dhe u rikujton nxënësve se për çfarë bëhet fjalë në një rrëfim fantastik ku personazhet dhe ngjarjet janë të trilluara. Ai/ajo shkruan në dërrasën e zezë:
- Në rrëfimet fantastike personazhet dhe ngjarjet janë të trilluara.
- Rrëfimi ndërtohet mbi bazën e imagjinatës së autorit.
- Shpreh sinqeritetin dhe dëshirën e njeriut për të arritur të pamundurën.
- Kapërcen kufijtë e realitetit.

Pastaj lexon pjesën para leximit në faqen 86, njeh nxënësit me veprimtarinë letrare të shkrimtarit shqiptar Bedri Dedja dhe i përgatit për të filluar pjesën e dytë të orës mësimore.

Ndërtimi i njohurive të reja: Secili mëson një - Pyetje-përgjigje
Me ndihmën e mësuesit/es, klasa ndahet në 3 grupe të mëdha, ku secili grup udhëzohet të lexojë në heshtje pjesën e shkëputur nga romani me po të njëjtin titull "Presidenti i planetit të Kuq". Pas leximit, grupet do të prezantojnë pjesën e tyre duke u mbështetur nga kërkesat e parashtruara. Mësuesi/ja sqaron së bashku me nxënësit fjalët e panjohura.
Grupi I – Diskutues: Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe pas leximit të tregojnë ngjarjen para nxënësve tjerë. Një nxënës/e prezanton grupin (p.sh. nxënësit tregojnë pjesën në pika të shkurta sepse të gjithë e kanë lexuar).

Grupi i dytë: Nxënësit e këtij grupi udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të përshkruajnë para shokëve/shoqeve emocionet që ngjallën tek ata/ato aventurat e fëmijëve në "Planetin e Kuq". Grupi i dytë ka të drejtë të vendosë për detyra të shtëpisë.
Grupi i tretë: Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të krijojnë mendimet dhe ide pozitive ose negative dhe mundohen të bindin nxënësit e tjerë për idetë e tyre.
Pas prezantimit, nxënësit/et punojnë ushtrimin 1 dhe pastaj udhëzohen që të punojnë ushtrimet në grup. Grupi I - Analizojmë tekstin - 2, 3 dhe 4, Grupi II - ushtrimet 5 dhe 6, Grupi III - Gjuha e tekstit, ushtrimi 9. Nxënësit do të punojnë në heshtje. Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet e tyre para klasës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tryeza e rrumbullakët
Pasi fitohen njohuri të mjaftueshme rreth situatave që krijohen në rrëfim, mësuesi/ja i drejton nxënësit drejt të reflektuarit mbi tekst. Nxënësit mund të ulen në formë rrethore, në grupe ose në një grup të madh. Me ndihmën e mësuesit/es zgjidhet krahu nga do të lëvizë lapsi dhe letra. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të përkufizojnë idenë e tyre për pyetjet e ushtrimeve 7 dhe 8. Çdo nxënës/e pasi shkruan përgjigjen, palos letrën me qëllim që shoku pranë të mos e lexojë. Dalëngadalë formohet një letër në formë fizarmonike. Mund të përdoren edhe lapsa me ngjyra të ndryshme. Në fund, pasi të ketë shkruar edhe nxënësi i fundit komentin e vet, mësuesi/ja merr letrën fizarmonikë e lexon vetë pastaj një nxënës e lexon para klasës. Më pas, nxënësit/et ilustrojnë me fjalë dhe shprehje nga teksti mendimet e hedhura në letër dhe reflektojnë për udhëtimet në planetë duke inskenuar ngjarjet nga rrëfimi.

Vlerësimi i nxënësve: do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore:
Diagnostifikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe këto detyra:
Grupi I - shkruan për plotësimin e tekave të tekanjozëve.
Grupi i II - shkruan për vendimet që merr Asambleja e fëmijëve të planetit Tokë për tekanjozët.
Grupi i III- përshkruan stërtekanjozët (veset e tyre).
Secili grup do të shkruaj nga një rrëfim të përcjellë me ilustrime figurash dhe fotosh, i cili duhet të përcjell këtë mesazh: "Tekat duhet t'i shmangim sepse krijojnë shumë probleme për të gjithë ne". Punimet do të paraqiten në klasë dhe prezantohen sipas teknikës "Truri i galerisë".

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Rrëfime nga e kaluara. Teksti fantastik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Shelgu goditës

Fjalët kyçe: Harri, makina e padukshme, pema e çuditshme, Hedvigu, Roni.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:
- përshkruan mjedisin dhe ngjarjet në rrëfim;
- zbulon rolin e makinës fluturuese dhe rëndësinë që ajo ka për personazhet e pjesës;
- rendit dhe analizon elementet fantastike.

Kriteret e suksesit:
Analizon mjedisin dhe natyrën në rrëfim.
Gjykon veprimet e personazheve.
Zhvillon fantazinë dhe imagjinatën.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh
Mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë: ***Harri Poter, makina fluturuese e padukshme, Hoguorst***, dhe udhëzon nxënësit të mendojnë se çfarë u sjellin në mendje këta emra. Nxënësit punojnë në çift dhe hedhin në letër idetë e tyre. Idetë dhe mendimet shkëmbehen me shokët/shoqet dhe pastaj mësuesi/ja i shkruan në dërrasë të zezë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia pyetje/përgjigje – të nxënit me këmbime
Para se të fillojë leximi, mësuesi/ja, duke u bazuar në rubrikën para leximit, u shpjegon nxënësve se për çfarë flitet në ngjarjen e radhës e cila është shkëputur nga romani "Harri Poter dhe dhoma e të fshehtave". I njeh fëmijët me veprimtarinë letrare të shkrimtares angleze J. K. Rouling e cila fitoi famë pas librit të saj "Harri Poter dhe guri filozofal".
Pas leximit të pjesës, për ta kuptuar më mirë tekstin, mësuesi/ja nëpërmjet metodës "Pyetje-përgjigje" së bashku me nxënësit u përgjigjen pyetjeve të ushtrimit 1.
Nxënësit ndahen në 4 grupe (5-6 vetë) dhe secili punon detyrat sipas udhëzimit të mësuesit/es.
Grupi I punon ushtrimet 2 dhe 3. Te ushtrimi 3 nxënësit rendisin karakteristikat e makinës me radhë sipas kronologjisë së ngjarjeve.
Grupi II punon ushtrimet 4 dhe 5. Te ushtrimi 4 nxënësit bazohen në tabelën që kanë në tekst për të renditur elementet fantastike po ashtu sipas rendit kronologjik.
Grupi III punon ushtrimet 6, 7 dhe 8. Nxënësit e këtij grupi do të argumentojnë përgjigjen e tyre pro dhe kundër.
Grupi III punon ushtrimet 9 dhe 10.
Nxënësit do të punojnë në heshtje. Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet e tyre para klasës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Mendo/puno në dyshe/tregoju të tjerëve Pasi fitohen njohuri të mjaftueshme rreth situatave të cilat krijohen në rrëfim, mësuesi/ja i drejton nxënësit drejt të reflektuarit mbi tekst dhe t'u japin formë mendimeve të tyre. Për realizimin e kësaj teknike, mësuesit/et mund të përdorin ushtrimin 11 dhe 12 (Ushtrimi 12 u lejon nxënësve më shumë se një përgjigje, ata/ato janë të lirë të shpjegojnë shprehjet që kërkon ushtrimi). Nxënësit do të punojnë në dyshe dhe përgjigjet e tyre do t'i japin me shkrim. Në përfundim çdo grup dysh përfaqësohet me një diskutim, ku prezantohen idetë e tyre rreth përgjigjeve për pyetjet e dhëna.
Vlerësimi i nxënësve: do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore: Diagnostifikues dhe formues.
Detyrat dhe puna e pavarur
Nxënësit mund të udhëzohen të shkruajnë nga një rrëfim imagjinar duke u bazuar në të dhënat që kanë mbledhur nga shokët dhe formuluar vet nga ushtrimet 11 dhe 12. P.sh. ...Makina fluturonte me shpejtësi dhe derisa ne kaluam rrezikun e përplasjes aty ku dukej se toka dhe ndërtesat e nxira po largoheshin një pemë e acaruar, qëlloi makinën. Xhami u shkund nga goditjet e pemës së..... Nxënësit duke përdorur foljet dhe shprehjet e ushtrimeve, mund të krijojnë rrëfime imagjinare. Rrëfimet lexohen orën tjetër dhe mësuesi/ja mund të organizojë nxënësit që në formë konkursi në të cilin zgjidhet rrëfimi më i mirë fantastik.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti poetik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv** 1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. 2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve. 3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim. **II.** Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik** 1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media. 6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim. **III.** Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm** 1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.			

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive •
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Vargje kushtuar gjuhës shqipe

Fjalët kyçe: gasthin, shungullon, vrungullon, hordhi, dëlir, jerm, martire, lehonë.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:
- përshkruan elementet dalluese të kombit;
- analizon vargjet e krijuara për gjuhën shqipe;
- dallon poezitë me temë të njëjtë;
- krijon një poezi për gjuhën shqipe.

Kriteret e suksesit:
Rikujton elementet dalluese të kombit.
Rendit poezitë me temë të njëjtë.
Gjykon vargjet e krijuara për gjuhën shqipe.
Reciton bukur poezinë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI - Fleta të bardha, marker, tabela

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Karrigia e autorit
Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë disa fjalë që lidhen me njësinë e re.
P.sh.- Gjuha, atdheu, pushtuesit, shqip, dashuri, komb, këngë, poezi, gegërisht, toskërisht.
Pastaj udhëzon nxënësit të shkruajnë në fletoret e tyre.
Gjuha është një nga elementet kryesore dalluese të një kombi. Përmendni elemente të tjera dalluese.

Disa nxënës përgjigjen dhe pas disa diskutimeve, shkruajnë në fletoret e tyre temën "Gjuha është një nga elementet kryesore dalluese të një kombi. Përmendni elemente të tjera dalluese". Gjatë shkrimit ata rikujtojnë shprehjet e prindërve dhe të mësuesit/es për kombin. Pastaj udhëzohen të shkruajnë çfarë dinë për temën, në grupe, dhe pas përfundimit të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin. Ndërkohë shtojnë diçka ne fletoren e shokut.

Rikthehen fletoret, shikohet ajo që është shtuar nga shoku/shoqja, rregullohet apo shtohet nëse është e nevojshme. Më pas me radhë, nga një nxënës për secilin grup, ulet në karrige para nxënësve të tjerë dhe lexon atë çfarë ka shkruar. Nxënësit bëjnë pyetje dhe paraqesin elemente të tjera, të cilat janë me rëndësi, por që nuk janë paraqitur gjatë leximit. Nxënësit që kanë lexuar, i shtojnë idetë e të tjerëve në fletoret e tyre. Nxënësit tregojnë njohuritë e tyre për rrëfimet e mësuara më parë të lidhura gjithnjë me temën e shënuar më lartë.

Më pas, mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë "Vargje kushtuar gjuhës shqipe" dhe shpjegon për nxënësit.

Në letërsinë shqipe ka shumë poezi kushtuar gjuhës shqipe, bukurisë dhe vlerave të saj. Vargjet e mëposhtme janë shkëputur nga poezi të zgjedhura, të poetëve më të njohur shqiptarë, të cilat kanë të njëjtin motiv: dashurinë për gjuhën amtare. Gjuha është frymë dhe ndërgjegje kombëtare, është informacioni më i rëndësishëm shpirtëror i mbërritur prej të parëve, është shenja e parë e identitetit të të qenit shqiptar.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje/Ditari dypjesësh
Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë poezitë me rend në faqe 94 dhe 95 dhe të punojnë në grupet e tyre punuese.
Grupi i parë: ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5
Grupi i dytë: ushtrimet 6, 7, 8
Grupi i tretë: Gjuha e vargjeve në një sërë figurash letrare. Gjeni ato dhe shënoni në tabelë. P.sh.:
Apostrofi është ndërhyrja emocionuese me anën e së cilës thërresim pranë gjërat e largëta ose të afërta, të gjalla a të vdekura, që t'i bëjmë të pranishme, konkrete dhe që të ndikojnë kështu në ndjenjat e emocionet e të tjerëve. Shembuj: Lamtumirë, o mori Shkodër!/Lamtumirë, o ti Cukal O malet e Shqipërisë dhe ju, o lisat e gjatë.
Mësuesi/ja ndihmon nxënësit nëse kanë nevojë.
Pastaj reflektojmë rreth vargjeve kushtuar gjuhës.
Pas diskutimeve udhëzohen të zgjedhin vargjet e pëlqyera për t'i komentuar. P.sh.:

Vargjet	Komenti
Gjuha jonë sa e mirë! Sa e ëmbël, sa e gjerë!	Vargje që ndikojnë te të gjithë shqiptarët që ta duam dhe ta respektojmë gjuhën tonë të bukur dhe mos ta ngarkojnë me fjalë të huazuara.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë
Në këtë fazë, nxënësit/et udhëzohen të shkruajnë disa vargje për gjuhën shqipe.
Pastaj lexojnë krijimet e tyre dhe bashkëbisedojnë për shprehjet e përdorura në vargje.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Lexojini disa herë vargjet e mësipërme dhe më pas recitojini me zë të lartë. Kujdesuni të përdorni intonacion shprehës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti poetik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Lulëkuqja

Fjalët kyçe: lulëkuqja, shtëpi, arrati, atdhe, ngjyra e kuqe, flamur.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:
- përshkruan poezinë dhe zbulon simbolikën brenda saj;
- analizon mesazhin brenda poezisë;
- zbërthen rolin dhe funksionin e figurave letrare.

Kriteret e suksesit:
Zbulon përshkrimin simbolik të atdheut.
Reciton bukur poezinë.
Vlerëson portretizimin e vendit në poezi dhe kupton mesazhin që përcjell poezia.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Pesëvargëshi
Mësuesi/ja shënon në dërrasë të zezë emrin "Lulëkuqja" dhe pyet nxënësit: E njihni këtë lule, me cilën ngjyrë ngjason ngjyra e saj? Pastaj kërkon nga nxënësit që të thurin nga një pesëvargësh për Lulëkuqen.

Lulëkuqja
E kuqe e bukur
Mbillet punohet rritet
Lulëkuqja ka ngjyrën e flamurit tonë
Lule

Punimet e nxënësve lexohen dhe zgjidhet pesëvargëshi më i bukur për "Lulëkuqen". Mësuesi/ja para se të kalojë në pjesën e dytë të orës, duke u mbështetur në të dhënat e rubrikës para leximit, u shpjegon nxënësve për poezinë që do të mësojnë në vazhdim dhe i njeh me autorin dhe veprimtarinë patriotike e letrare të tij.

Aleksandër Stavre Drenova Asdreni(1872-1947)

Personalitet i njohur i Rilindjes Kombëtare, atdhetar i zjarrtë për çlirimin dhe bashkimin e Shqipërisë.

Autor i **HIMNIT të FLAMURIT**. I vetmi himn në botë që i kushtohet simbolit të flamurit.

Veprat e Asdrenit:
"Rreze dielli", "Ëndrra e lotë", "Burri i dheut" etj.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia pyetje/përgjigje – të nxënit me këmbime
Pas leximit të poezisë, nëpërmjet metodës "pyetje-përgjigje", nxënësit punojnë pyetjet e ushtrimit 1. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit: -*Poezia i kushtohet atdheut të autorit, Shqipërisë*.
Pasi nxënësit kuptojnë tekstin e poezisë, mësuesi/ja shpjegon dhe u rikujton disa nga figurat letrare të cilat ndihmojnë në thurjen e poezive.

- **Paralelizmi figurativ** *përdoret kur poeti dukuritë natyrore që përshkruan i vendos pranë ngjarjeve të jetës, mendimeve dhe gjendjes shpirtërore të njerëzve, me të cilat mund të ngjasojnë.*
- **Metafora** *apo mbretëresha e figurave, emërton një send a një dukuri me emrin e një sendi, a dukurie tjetër, që i ngjan. Është krahasim pa lidhëzën krahasore.*
- **Krahasimi** *një send apo një dukuri na jep duke e krahasuar me një send apo dukuri tjetër.*
- **Epiteti** *është fjalë përcaktuese e cila formohet me një mbiemër që i shtohet një emri për t'i pasuruar kuptimin duke i dhënë bukuri artistike dhe ngarkesë emocionale.*
- **Antiteza** *është kundërshtim i mendimeve apo kalim i shpejtë dhe i menjëhershëm nga një e kundërt te tjetra. Antiteza përfitohet duke vënë ballë për ballë dy anë, dy gjendje, dy pamje dhe dy dukuri të kundërta.*

Pastaj, mësuesi/ja ndan klasën në 4 grupe dhe secili punon ushtrimet:
Grupi I punon ushtrimin 2 **Grupi II** punon ushtrimin 4 **Grupi III** punon ushtrimin 5 **Grupi IV** punon ushtrimin 6
Nxënësit punojnë në heshtje. Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet para grupeve në klasë. Nëse është e nevojshme mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura. U rikujton figurat stilistike dhe u ndihmon nxënësve në formulimin e përgjigjeve të sakta.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Mendo/puno në dyshe/tregoju të tjerëve
Nxënësit në dyshe do të punojnë ushtrimin 3 dhe 7. Duke gjetur elementet e ngjashmërisë në paralelizmin që krijon Asdreni mes lulëkuqes dhe atdheut, ata do të zbulojnë idetë dhe mesazhin që autori përcjell te lexuesi nëpërmjet kësaj poezie. Nxënësit paraqesin mendimet e tyre. Modeli më i qëlluar shënohet në dërrasë të zezë.

Vlerësimi i nxënësve: do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore: Diagnostifikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Do të koordinohen në dyshe me shokun/shoqen dhe do të mësojnë përmendësh poezinë (secili nga 3 strofa). Gjithashtu do të shkruajnë një përshkrim të shkurtër me temë: "Imazhi i një lulëkuqeje që kur fryn erë ngjan me një flamur".

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda: Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla e kurrikulës: III</td><td>Klasa: VI</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Teksti poetik</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës: Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik;</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – Komunikues efektiv
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ dhe kritik
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – Nxënës i suksesshëm
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri.</td></tr>
</table>

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Prandvera

Fjalët kyçe: molisur, streh, zymyl, dhenash, gemb për gemb, buloj mbarë, vrue, bërlyket, lavër.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:

- përshkruan disa ndryshime me ardhjen e Pranverës;
- analizon poezinë "Prandvera";
- dallon ndërtimin e poezisë "Prandvera";
- krijon një poezi me temën e njëjtë.

Kriteret e suksesit:
Rikujton disa ndryshime me ardhjen e Pranverës;
Gjykon poezinë e krijuara për Pranverën;
Reciton bukur poezinë;
Vlerëson poezinë "Prandvera" duke kujtuar jetën e autorit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI - Fleta të bardha, marker, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Edukatë qytetare, histori, gjeografi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Pesëvargësh
Mësuesi/ja shënon në dërrasë të zezë fjalën "Pranvera" dhe i nxit nxënësit të ndërtojnë një pesëvargësh me fjalën "Pranvera". P.sh.:

Pranvera
E bukur e gëzueshme
Jetohet ndryshohet gjallërohet
Pranvera stina më e bukur e vitit
Lulja

Lexohen disa prej punimeve të nxënësve dhe njëri prej tyre shënohet edhe në dërrasë të zezë.
Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje/Ditari dypjesësh
Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë poezinë në faqen 99 dhe të punojnë në grupet e tyre punuese.
Grupi i parë: Kuptojmë poezinë - ushtrimet 1, 2, 3, 4
Grupi i dytë: Analizojmë poezinë - ushtrimet 5, 6, 7
Grupi i tretë: Gjuha e poezisë - ushtrimet 8, 9, 10 (strofa e përdorur është katrena dhe rima e kryqëzuar).
Mësuesi/ja ndihmon nxënësit nëse kanë nevojë.
Pastaj reflektojmë rreth poezisë.
A ju nxit kjo poezi një përfytyrim të saktë për natyrën në pranverë? Çfarë ndjesish ju krijon të lexuarit e poezisë? Pas diskutimeve udhëzohen të zgjedhin strofën e pëlqyera për komentim P.sh.:

Strofa e pëlqyer	Komenti
Jeni lodhe, dallë ndysha t'shkreta, Je molis' i ziu bylbyl; Ah! pushoni n'streh' ku u gjeta, Pusho n'kopshte te njaj' zymyl.	Një përshkrim i bukur i ardhjes së shpendëve në vendin ku erdhi Pranvera bashkë me lule.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë
Pas prezantimit të detyrës, nxënësit udhëzohen të krijojnë një poezi.
Përshkruani ardhjen e pranverës në qytetin/fshatin në të cilin jetoni.
Pastaj lexojnë krijimet e tyre dhe bashkëbisedojnë për shprehjet e përdorura në vargje.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Mësojeni përmendësh poezinë "Prandvera".

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti poetik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
Të shkruarit
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Nana

Fjalët kyçe: Nana, hyjt, lulet, vallzue, gurgullue.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:
- përshkruan lidhjen në mes poezisë dhe ilustrimit figurativ (fotos) në tekst;
- analizon ndërtimin artistik të poezisë;
- reciton bukur poezinë.

Kriteret e suksesit:
Shpjegon rolin e pazëvendësueshëm të nënës në familje.
Krijon vargje për nënën.
Kupton dialektin dhe çmon mesazhin e poezisë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Pema e mendimeve
Mësuesi/ja shkruan në mesin e dërrasës së zezë fjalën "Nëna" dhe pastaj nxit nxënësit që të shprehin mendimet e tyre: Çfarë është nëna për ju? Nxënësit tregojnë mendimet për nënën. Të gjitha fjalët do të thonë, mësuesi/ja, me ndihmën e një nxënësi, do të mundohet t'i rendisë në formën e pemës së mendimeve në dërrasën e zezë.



Para se të fillojë leximi i poezisë, mësuesi/ja njeh nxënësit me veprimtarinë letrare të poetit.



Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia pyetje/përgjigje – Ditari dypjesësh
Pas leximit dhe recitimit të poezisë, nëpërmjet metodës Pyetje-përgjigje, nxënësit/et punojnë pyetjet e ushtrimit 1 dhe 2. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit/ p.sh. ushtrimi 2: Çfarë i pëlqen më shumë poetit nga natyra?

a) Në vargjet e para të strofës së I- *hyjt, qi ndrisin n'qiell*
b) Në vargjet e dyta të strofës së I- *lulet e kandshme n'Priell*

Pasi përfundojnë ushtrimin, mësuesi/ja ndan klasën në 4 grupe dhe secili punon ushtrimet:
Grupi I ushtrimin 3; Grupi II, ushtrimin 4; Grupi III, ushtrimin 5; Grupi IV, ushtrimin 6.
Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet para klasës. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura. U rikujton rimën, verifikon si e kanë kryer ushtrimin dhe si klasë lexojnë edhe njëherë fjalët e dialektit gegë që ka përdorur autori. Mësuesi/ja shpjegon: Autori sjell vargjet në dialektin e tij, sepse madhështia dhe bukuria e nënës shpjegohet bukur vetëm me gjuhën (dialektin) që ka mësuar nga nëna. Duke bërë krahasimin e fjalëve nga dialekti gegë me gjuhën standarde p.sh.: Mi kande- i dua; e kandshme- e këndshme; Hyjt- yjet; ndie- ndëgjue; nana-nëna; prroni-përroi; nxënësit kuptojnë bukurinë dhe pasurin e gjuhës shqipe. ***Dialektet janë pasuri e gjuhës sonë të bukur***.
Nxënësit udhëzohen të punojnë sipas teknikës "Ditari dypjesësh".

Citati: Shkruani strofën e pëlqyer	Komenti: Komentoni strofën që zgjodhët
Sa m'knaqë përherë mue nana: Virtytesh nji pasqyrë, Nuk ka nevojë me m'folun, Kam mjaft kur ajo më kqyrë.	Nëna është krijesa më e dashur për mua, Mua më mjafton vetëm shikimi i saj i ëmbël për t'u ndier i lumtur.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Përshkrim vizual
Nxënësit, në dyshe, do të shkruajnë një përshkrim të shkurtër të nënës duke u bazuar në përshkrimin vizual që do t'i bëjnë fotos në tekstin e tyre dhe ushtrimit 7. Punimet e nxënësve lexohen para klasës.

Vlerësimi i nxënësve: do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore: Diagnostifikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Nxënësit do të kenë detyrë që: duke u mbështetur në udhëzimet te rubrika ***shkruajmë*** të përshkruajnë marrëdhënien që kanë me nënën e tyre. Do të mësojnë poezinë përmendësh.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti poetik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**

1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**

1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**

1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. Shkathtësitë e komunikimit

Të dëgjuarit dhe të folurit

• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.

Të lexuarit

• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.

Të shkruarit

• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.

• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Më tha një plak dikur

Fjalët kyçe: axhami – fëmijë i vogël e pa përvojë nga jeta qëllova – u ndodha.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:
- përshkruan këshillat e më të moshuarve;
- analizon këshillat e mësuara në poezi;
- dallon ndërtimin e poezisë;
- krijon një poezi kushtuar gjyshit ose gjyshes.

Kriteret e suksesit:
Rikujton tri këshilla nga të moshuarit.
Gjykon poezinë duke respektuar vlerat e saj.
Reciton bukur poezinë.
Vlerëson poezinë duke e krahasuar me jetën e autorit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI - Fleta të bardha, marker, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Edukatë qytetare, histori, gjeografi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh
Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë pyetjen: Si i vlerësoni këshillat e më të moshuarve? Nxënësit shprehin mendimet e veta dhe bashkëbisedojnë për qëndrimin e tyre.
Pastaj, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e poezisë "Më tha një plak dikur" (nga vëllimi "Poezi-drama") dhe shpjegon për nxënësit.
Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje/Ditari dypjesësh
Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë poezinë në faqen103 dhe të punojnë në grupet e tyre punuese.
Grupi i parë: - ushtrimet 1, 2, 3, **Grupi i dytë:** - ushtrimet 4, 5, **Grupi i tretë:** ushtrimet 6, 7, 8 dhe 9 (Në këtë poezi kemi përsëritje të fjalëve të cilat ndikojnë në zbukurimin e tekstit të cilat forcojnë shprehësinë dhe veçojnë kuptimin e pjesës që përsëritet).

Figura kryesore në këtë poezi është Anafora.



Mësuesi/ja ndihmon nxënësit nëse kanë nevojë dhe pastaj reflektojnë rreth poezisë.
Duke u nisur nga poezia e mësipërme, si i vlerësoni këshillat e më të moshuarve?
Pas diskutimeve udhëzohen të zgjedhin strofën që i pëlqen më shumë për ta komentuar.
P.sh.:

Strofa e pëlqyer	Komenti
Nëse e humb shëndetin, djalo, Shumëgjë ke humbur, Shumëgjë, ta dish, – Më tha një plak dikur, Një plak i urtë, Kokë e përhirtë	Në këtë strofë paraqitet përvoja e autorit i cili sa ishte i ri nuk e kuptonte vlerën e shëndetit dhe tani është shumë vonë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë
Në këtë fazë, pas prezantimeve, nxënësit udhëzohen të krijojnë një poezi. P.sh.:
Provoni të shkruani një poezi kushtuar gjyshit ose gjyshes suaj, duke ndjekur këshillat e mëposhtme.
Poezia ka më shumë se një kuptim.
Poezia lexohet dhe komentohet në mënyrë të tillë që të ndikosh te të tjerët.
Për poezinë flitet në rreth.
Krijoni atmosferën e duhur për poezi.
Shoqërojeni atë me muzikë në sfond.
Mbani përpara një libër të autorit.
Pastaj lexojnë krijimet e tyre dhe bashkëbisedojnë për shprehjet e përdorura në vargje.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shkruani një poezi sipas dëshirës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti poetik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**

1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**

1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**

1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. Shkathtësitë e komunikimit

Të dëgjuarit dhe të folurit

• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.

Të lexuarit

• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.

Të shkruarit

• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Mbarim vjeshte

Fjalët kyçe: Vjeshta, shtërg, i përmallshëm, dher-i, dëborë, veriu.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:
- njihet me jetën dhe veprën e autorit;
- dallon në poezi përshkrimin e keqardhjes për kohën që ikën e s'kthehet më;
- zbërthen rolin dhe funksionin e figurave letrare·

Kriteret e suksesit:
Zbulon përshkrimin simbolik të peizazhit në poezi.
Vlerëson portretizimin vjeshtës në poezi dhe kupton mesazhin që përcjell poezia.
Reciton bukur poezinë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Prezantim digjital/diskutim
Mësuesi/ja me videoprojektor paraqet para nxënësve pasazhe të stinës së vjeshtës duke prezantuar natyrën e zverdhur. Pemë të zhveshura nga gjethet, të cilat era i bart me vete derisa ngadalë mbushin tokën që merr ngjyrën zverdhur të gjetheve.
Gjatë prezantimit digjital, mësuesi/ja lexon vargjet e strofës së dytë të poezisë "Mbarim vjeshte" të Lasgush Poradecit. Pastaj pyet nxënësit: Për çfarë flitet në këtë poezi?
Nxënësit shprehin mendimet e tyre. P.sh.:
Poezia paraqet peizazhe vjeshte; Poeti shkruan për natyrën e cila zverdhet; Mbarimi i vjeshtës boshatis pyjet nga gjallesat, ato largohen nga i ftohti.
Nxënësit njihen me veprimtarinë letrare të Lasgush Poradecit.

Lasgush Poradeci është pseudonimi i Llazar Sotir Gusho (1899-1987)

Poeti më i spikatur shqiptar. Në vitin 1933 u botua vëllimi i tij i parë "Vallja e yjeve" ndërsa më 1937 u botua vëllimi "Ylli i zemrës"

Ka përkthyer disa nga veprat e shkrimtarëve më të mëdhenj të letërsisë botërore, si Pushkinin, Gëten, Hygoin, Bajronin, Shellin etj.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia pyetje/përgjigje – të nxënit me këmbime
Pas leximit të poezisë bëhet shpjegimi i fjalëve të panjohura dhe nëpërmjet metodës "pyetje-përgjigje", nxënësit punojnë pyetjet e ushtrimit 1. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit p.sh.: *Pse është i përmallshëm udhëtimi i shtërgut në largim.*

- ✓ *Ka lënë pas folezën.*

Nxënësit ndahen në grupe ku secili grup punon me detyrat e caktuara nga mësuesi/ja:
Grupi I punon ushtrimet 2 dhe 9. Grupi II punon ushtrimin 4. Grupi III punon ushtrimet 5 dhe 6. Grupi IV punon ushtrimet 7 dhe 8.
Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet para grupeve në klasë. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura. Ndalet në sqarimin e figurës së aliteracionit dhe onomatopesë.

Aliteracioni është përsëritje e bashkëtingëlloreve të njëjta ose togjeve të tingujve të njëjtë. Kjo figurë letrare vërehet veçanërisht në vargje dhe rrit fuqinë shprehëse të tyre. P.sh., te vargjet e L. Poradecit: "Mbarim vjeshte"
*Flutu**r**oj dhe shtë**r**g i fundit, madhështo**r**, me shpi**r**t të gjo**r**ë.....*
Apo te poezia "Shpell e Dragobisë" e shkruar nga F. Noli"
*Dif d**r**agoj i D**r**agobisë,*
*T**r**im bun i Vegjëlisë*
*O Baj**r**am, baj**r**ak i gjallë*
*Mo**r**e nam me gjak në ballë.*

Onomatopeja është figurë e përsëritjes që ka bazë imitimin e zhurmave të zërave të natyrës dhe qenieve të gjalla. Në letërsi sjell atmosferën me të cilën lidhet kuptimi i pjesës. P.sh., te vargjet e L. Poradecit "Mbarim vjeshte"

Fryn veriu** në pyll të thatë **me zemërim e me fërtymë

***E si shtohet cingërima**... ja! Se ku dinak dh'i vocërr...*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i Venit
Nxënësit/et në dyshe duke i'u referuar pyetjes së ushtrimit 3 do të gjejnë ndryshimet dhe të përbashkëtat e poezisë "Prandvera" të Ndre Mjedjës dhe poezisë "Mbarim vjeshte" të Lasgush Poradecit.



Vlerësimi i nxënësve: do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore: Diagnostifikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Do të mësojnë poezinë përmendësh. Recitimi më i bukur do të vlerësohet nga shokët/shoqet e klasës. Po ashtu nxënësit do të kryejnë detyrën: "Përshkruani përjetimet tuaja në fund të stinës së verës dhe në prag të stinës së vjeshtës".

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti poetik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
• Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Horizonti
Fjalët kyçe: horizonti, ëndërr, erë.
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - dallon temën e poezisë; - analizon ndërtimin e poezisë; - krijon një poezi me temën e njëjtë. **Kriteret e suksesit:** Rikujton temën e poezisë. Vlerëson poezinë "Horizonti" duke kujtuar jetën e autorit. Reciton bukur poezinë.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI - Fleta të bardha, marker, tabela.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Pesëvargësh
Mësuesi/ja shënon në dërrasë të zezë fjalën "Horizonti" dhe i nxit nxënësit të ndërtojnë një pesëvargësh me fjalën "Horizonti". P.sh.:

Horizonti
I gjerë i bukur
hulumtohet ndryshohet përjetohet
ëndërr e të gjithëve për udhëtim
hapësira

Lexohen disa prej punimeve të nxënësve dhe njëri prej tyre shënohet edhe në dërrasë të zezë.
Pastaj shpjegon për nxënësit.
"Horizonti" është një poezi e Dritëro Agollit, e shkruar në vitin në 1984 në përmbledhjen me poezi "Udhëtoj i menduar". Që të vegjël na pëlqen të shohim larg, deri aty ku na lejon fushëpamja Pyesim vazhdimisht se çfarë ka përtej asaj vijës ndarëse, mes tokës dhe qiellit. Rritemi me dëshirën për të njohur atë që nuk na rrok syri: fshatra, qytete të panjohura, peizazhe të pashkelura, njerëz të rinj.

Ndërtimi i njohurive të reja: Mendo-puno në dyshe-thuaja grupit/Ditari dypjesësh
Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë poezinë në faqen 107.
Pas leximit, mësuesi/ja shpjegon për nxënësit figurën kryesore në poezi "Metafora" (e cila dominon te vargu i fundit O ëndrra ime prej motesh".



Pastaj udhëzohen të punojnë në grup ushtrimin e njëjtë. Në klasë formohen katër grupe dhe lexojnë poezinë. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të tekstit dhe bashkëpunojnë me shokun/shoqen që kanë afër. Në fund diskutojnë në grup për përgjigjet e tyre dhe zgjidhet një anëtar i grupit për të prezantuar punën.
Më pas bashkëbisedojnë për poezinë.
Si mendoni, horizonti nënkupton vetëm vijën imagjinare që krijojmë me sy në largësi apo edhe dëshirën e njeriut për zbuluar diçka të re? Pse autori e quan ëndërr zbulimin e së panjohurës? A ia ka dalë njeriu të zbulojë të panjohurën gjatë gjithë zhvillimit të tij?
Pas diskutimeve në klasë udhëzohen të zgjedhin strofën e pëlqyer për komentim p.sh.:

Strofa e pëlqyer	Komenti
Dhe ky vrapim më mbeti dhe sot: Të zbuloj se ç'ka përtej horizontesh. Horizont, horizont, horizont, O ëndrra ime prej motesh.	Një strof që paraqet dëshirën e zjarrtë të poetit e cila gjatë leximit më mbushi më emocione dhe me dëshirën që të hulumtoj përtej horizontit.... horizont, horizont përsëritje që të mbushë me shpresë dhe arritje të synimeve në jetë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë

Pas prezantimit të detyrës udhëzohen të krijojnë një poezi me titullin e njëjtë "Horizonti".
Disa nxënës lexojnë krijimet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Mësojeni përmendësh poezinë "Horizonti" dhe recitojeni.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti poetik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik;	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur. • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Në natyrë

Fjalët kyçe: Natyra, gjelbërimi, gurgullima, vesa, bari, uji.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:
- njeh jetën dhe krijimtarinë e autorit:
- dallon temën e poezisë;
- analizon gjuhën dhe thurjen e poezisë.

Kriteret e suksesit:
Ilustron me shembuj peizazhin e natyrës në poezi sipas përshkrimit të autorit.
Vlerëson qetësinë e shpirtit që të krijon natyra.
Reciton bukur poezinë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.
Përshkrimi i metodologjisë dh e veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh (brainstorming)
Mësuesi/ja shënon në dërrasë të zezë "Në natyrë" dhe i nxit nxënësit të diskutojnë në dyshe për këtë temë. Nxënësit do të hedhin idetë e tyre në letër dhe pastaj do t'i prezantojnë para klasës. Mësuesi/ja shënon në dërrasën e zezë mendimet që kanë thurur nxënësit për natyrën, për ndjesinë që na krijon shëtitja dhe qëndrimi në natyrë. Duke dëgjuar mendimet e të tjerëve, nxënësve u shtohet informacioni në kujtesën e tyre. "Stuhi mendimesh" është veprimtari e mirë për fillimin e mësimit. Mbi informacionin që zotërojnë nxënësit organizohen hapat e tjera për mësimdhënien.
Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia pyetje/përgjigje - Diskutim
Para se të fillojë leximi i poezisë, mësuesi/ja duke u mbështetur në rubrikën *para leximit* u tregon nxënësve se cili është objekti i poezisë "Në natyrë". Pastaj u shpjegon për jetën dhe veprimtarinë e autorit. **Esad Mekuli (1916-1993)** *ishte poet dhe përkthyes i njohur. Ishte nismëtar dhe themelues i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Republikës së Kosovës. Në vitin 1949 themeloi revistën letrare "Jeta e re" kryeredaktor i së cilës ishte për shumë kohë. Disa nga veprat kryesore që ka botuar janë: Për ty", "Dita e re", "Vjeshta", "Brigje", "Drita që nuk shuhet" etj.*

Bëhet leximi artistik i poezisë dhe nëpërmjet metodës "pyetje-përgjigje", nxënësit/et punojnë pyetjet e ushtrimit 1.
Pasi përfundojnë ushtrimin, mësuesi/ja ndan klasën në 4 grupe dhe secili punon ushtrimet:
Grupi I punon ushtrimin 2.
Grupi II punon ushtrimin 3.
Grupi III punon ushtrimin 4.
Grupi IV punon ushtrimin 5.
Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet para grupeve në klasë. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura.
Të gjithë nxënësit, si klasë, së bashku me mësuesin/en kryejnë ushtrimin 6. Përgjigjet e nxënësve mund të jenë të ndryshme sepse poezia shfaq: qetësi, ëndërrim, frymëzim, gëzim. Ndërsa në pyetjen e cila shtrohet në ushtrimin 7: ***Si mendoni, a do të kishte të njëjtën vlerë artistike poezia nëse fjalët në dialekt do të zëvendësoheshin me gjegjëset e tyre në gjuhën standarde?*** Mësuesi/ja u rikujton nxënësve poezinë "Nana" të V. Prenushit se si: Autori sjell vargjet në dialektin e tij, sepse madhështia dhe bukuria e vargut arrihet vetëm me gjuhën (dialektin) që ka mësuar nga nëna dhe të cilin autori e flet.
Mësuesi/ja së bashku me nxënësit shkruan në dërrasë të zezë vargun e parë të poezisë, por tani me ndihmën e nxënësve përdor fjalët gjegjëse të gjuhës standarde p.sh.:
"Diku larg gjelat janë ndi" (dialekt) **Diku larg janë dëgjuar gjelat** (standard)
Nxënësit vërejnë ngrohtësinë që jep vargu në gjuhën e poetit. Mësuesi/ja rikujton për nxënësit se:
Dialektet janë pasuri e gjuhës sonë të bukur.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Ditari dypjesësh

Citati: Shkruani strofën e pëlqyer	Komenti: Komentoni strofën që zgjodhët
Me u shtri vesës mbi tokë ndër fije bari që kundërmojnë dhe me andrrue se si, ndër flokë, naltësitë e kaltra të bulojnë...	Ne ndjehemi të lumtur, të frymëzuar kur jemi në natyrë, çdo gjë duket e bukur dhe fitojmë ndjesinë thua se jemi bërë njësh me bukurinë që na rrethon...

Vlerësimi i nxënësve: do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore: Diagnostifikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Mësojeni përmendësh poezinë "Në natyrë" dhe recitojeni para shokëve/shoqeve.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti poetik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**

1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
7. Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.
8. Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**

1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**

1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Secili udhëtar përshëndet në mënyrë të vet.

Fjalët kyçe: udhëtar, përshëndetje, kulturë, shoqëri, botë.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:
- përshkruan lidhjen që ekziston mes ilustrimeve figurative, vargjeve të poezisë dhe fjalëve kyçe;
- dallon mënyra të ndryshme të përshëndetjeve;
- vlerëson mënyrën e përshëndetjes që ka përdorur autori.

Kriteret e suksesit:
Rikujton disa përshëndetje me fjalë dhe me mimikë.
Analizon poezinë dhe ndërtimin e saj.
Identifikon gjuhën e përshëndetjeve në ilustrim.
Reciton bukur poezinë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI - Fleta të bardha, marker, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Edukatë qytetare, histori, gjeografi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Diskutim/Kllaster
Diskutim - Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe: "udhëtar, përshëndetje, kulturë, shoqëri, botë" dhe udhëzon nxënësit të shikojnë ilustrimin dhe poezinë në faqen 109. Pastaj pyet: Cila është lidhja që ekziston mes ilustrimeve figurative, vargjeve të poezisë dhe fjalëve kyçe?
Nxënësit/et japin mendimet e tyre dhe diskutojnë me njëri-tjetrin për qëndrimet e veta.
Mësuesi/ja diskuton pjesën para leximit me nxënësit dhe udhëzon një nxënës që të lexojë poezinë me zë të lartë.
Pas leximit, nxënësit njihen me autorin e poezisë.



Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje/Ditari dypjesësh
Pas leximit të poezisë "Secili udhëtar përshëndet në mënyrën e vet" për ta kuptuar sa më mirë brendinë e saj, mësuesi/ja së bashku më nxënësit diskutojnë pyetjet e ushtrimit 1 dhe 2. P.sh.:
Pse udhëtarë të ndryshëm përshëndetin në mënyra të ndryshme?
Kanë karaktere të ndryshme.Kanë gjuhë të ndryshme etj.
Cila është mënyra me të cilën poeti ka vendosur të përshëndetë?
Poeti, si mënyrën më të bukur të përshëndetjes ka vendosur buzëqeshjen.
Më pas, nxënësit udhëzohen të punojnë ushtrimet në fletore.
Analizojmë poezinë - Ushtrimet 3, 4
Gjuha e poezisë - Ushtrimet - 5, 6 (Poezia është e ndërtuar me katër strofa dhe vargu i përdorur është treshe (tercina).
Pastaj reflektojmë rreth tekstit 7.
Keni vënë re se shpesh turistët ndonëse janë të panjohur, përshëndetin ose iu pëlqen t'i përshëndetni. Si mendoni, çfarë i shtyn ata dhe juve për të përshëndetur të panjohur?
Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bashkëbisedojnë me shokët/shoqet për qëndrimin e tyre.
Pas diskutimeve udhëzohen të zgjedhin strofën e pëlqyera për ta analizuar, p.sh.:

Strofa e pëlqyer	Komenti
Kurse unë gjithmonë kam menduar njerinë ta përshëndes me buzëqeshje më të nxehtë	Më pëlqen shumë ky mendim i autorit sepse kjo mënyrë e përshëndetjes "buzëqeshja" i njeh të gjitha gjuhët e botës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Përshkrim vizual
Pas leximit të detyrës nxënësit/et udhëzohen për përshkrimin e ilustrimit në fq.110
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për detyrë.
Vështroni ilustrimin e mëposhtëm. Identifikoni se çfarë paraqet ai dhe shkruani se çfarë përjetimesh ju shkakton.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Mësojeni përmendësh poezinë "Secili udhëtar përshëndet në mënyrën e vet" dhe recitojeni.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti poetik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.
8. Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Ne ishim, ne jemi, ne do **t**ë jemi k**ë**tu...

Fjalët kyçe: Kosova, e dashur, biri, ardhacak, ardhacak, kreshnik, besnik, jemi k**ë**tu.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:
- përshkruan lidhjen mes poezisë dhe ilustrimit figurativ (fotos) në tekst;
- analizon rolin e metaforës dhe mesazhin e poezisë;
- reciton bukur poezinë.

Kriteret e suksesit:
Diskuton me shokët/shoqet për sakrificën e popullit për rrugën deri te liria.
Çmon e respekton lirinë dhe atdheun.
Krijon vargje për Kosovën.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Shkencat shoq**ë**rore; shoq**ë**ria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Prezantim digjital
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin tekstet e tyre në faqen 111 dhe të tregojnë se çfarë iu sjell në mendje fotoja. Pastaj me ndihmën e videoprojektorit u mundëson nxënësve të shohin bukuritë e atdheut të tyre, Kosovës. Pasi përfundon prezantimi, mësuesi/ja shpjegon se: për të gëzuar këto ditë në liri u deshën shumë sakrifica. U flet nxënësve për vuajtjen dhe sakrificën e popullit.
Ndalet te prezantimi i poezisë që do të punojnë në vazhdim dhe duke u bazuar në rubrikën *para leximit* u shpjegon nxënësve se për çfarë bëhet fjalë në poezinë e radhës, duke i njohur me veprimtarinë letrare të autorit.

Qerim Ujkani (1937-2015) ka qenë njëri nga redaktorët më të spikatur të emisioneve letrare në Radio Prishtina. Ai ka botuar mbi 20 libra me poezi dhe prozë, si dhe është marrë me përkthime letrare nga serbokroatishtja në gjuhën shqipe. Poezitë e tij janë prezantuar në shumë antologji.

Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim/pyetje-përgjigje
Me ndihmën e nxënësve mësuesi/ja cakton dy nxënës që të bëjnë leximin artistik të poezisë. Pas leximit të poezisë, mësuesi/ja shpjegon fjalët e reja dhe për të kuptuar më mirë poezinë së bashku me nxënësit/et diskutojnë pyetjen e ushtrimit 1 dhe 2. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit/et p.sh. ushtrimi 1: *Bashkëbisedimi n*ë *poezi i ngjan bised*ë*s n*ë *mes birit dhe n*ë*nës.* Ushtrimi 2: *Poeti shfaq ndjenja krenarie dhe dashurie p*ë*r lasht*ë*sin*ë *e trojeve tona* p.sh. te vargjet*:*

S'je tokë e gjithkujt dhe e askujt,
As tokë pa popull e një populli pa tokë.
Ti je dhe kreshnik i bijve besnikë,
Që të duam dhe të mbrojmë,
Me dashuri t'i mbjellim ugaret,
Me flamuj lirie ndër festa
T'i mbulojmë varret."

Pasi që përfundojnë ushtrimet, mësuesi/ja ndan klasën në 4 grupe dhe secili punon ushtrimet:
Grupi I - punon ushtrimin 3, Grupi II - 4, Grupi III - 5, Grupi IV - 6.
Nxënësit/et punojnë në heshtje. Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet para grupeve në klasë.
Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura. U rikujton *metaforën, figurën letrare e cila emërton një send a një dukuri me emrin e një sendi a një dukurie që i ngjan. Përdoret në tregime, romane, vepra letrare, poezi (si te poezia që kemi punuar sot), në jetën e përditshme etj. Metafora shpesh quhet edhe krahasim që bëhet në mendjen tonë, mirëpo ajo nuk shprehet në formën e plotë të krahasimit. Metafora nuk shfaq kuptimin e plotë, po vetëm të mundshmin*.
Pas përfundimit të ushtrimeve, përfaqësuesit e grupeve prezantojnë përgjigjet dhe nxënësit diskutojnë, reflektojnë për to. Mësuesi/ja udhëheq nxënësit drejt diskutimit për pyetjet e ushtrimeve 5 dhe 6.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Mendo/puno në dyshe/tregoju të tjerëve - Pesëvargëshi
Nxënësit do të punojnë në dyshe ushtrimin 7 dhe pastaj do të thurin nga një pesëvargësh për Kosovën.
Te ushtrimi 7 do të gjejnë metaforat që përdor poeti për vendin e tij. P.sh.: *dhe kreshnik i bijve besnikë; lule dhe gjyle në dorën e trimit...*
Pesëvargëshi më i bukur shkruhet në dërrasë të zezë.

Kosova
E bukur e dashur
Rritet lulëzon madhërohet
Është vendi që unë dua
Atdheu

Vlerësimi i nxënësve: do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore: Diagnostifikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Nxënësit do të kenë detyrë të tregojnë me një shkrim të shkurtër se kujt i drejtohen vargjet e poetit:
"Shkuar për të shkuar ka kush të shkojë,
Ne ishim, ne jemi, ne do të jemi këtu!"
Po ashtu nxënësit do të gjejnë dy poezi tjera kushtuar Kosovës dhe t'i lexojnë në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti poetik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Trashëgimi

Fjalët kyçe: stërgjyshi, trualli, shtëpi, gjaku ynë, dashuri, mërgimi.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:
- përshkruan lidhjen që ekziston mes ilustrimeve figurative, vargjeve të poezisë dhe fjalëve kyçe;
- lidh fjalët me njëra tjetrën që të krijojnë grupe fjalësh me kuptim;
- rishkruan poezinë duke shtuar vargun e dytë te vizat.

Kriteret e suksesit:
Rikujton anëtarët e familjes dhe trashëgiminë që munden ta fitojnë.
Analizon trashëgiminë objektive dhe ndjesore.
Reciton bukur poezinë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI - Fleta të bardha, marker, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Edukatë qytetare, histori, gjeografi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Diskutim/Kllaster
Diskutim - Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe: "stërgjyshi, trualli, shtëpi, gjaku ynë, dashuri, mërgimi" dhe udhëzon nxënësit të shikojnë ilustrimin dhe poezinë në faqen 113. Pastaj pyet nxënësit: "Cila është lidhja që ekziston mes ilustrimeve figurative, vargjeve të poezisë dhe fjalëve kyçe? Nxënësit/et japin mendimet e tyre dhe diskutojnë me njëri-tjetrin për qëndrimet e veta.
Pastaj, mësuesi/ja diskuton pjesën para leximit me nxënësit.
Mësuesi/ja udhëzon një nxënës që të lexon poezinë me zë të lartë.
Pas leximit, nxënësit njihen me autorin e poezisë.



Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje/Ditari dypjesësh
Pas leximit të poezisë "Trashëgimi", për ta kuptuar sa më mirë brendinë e saj, mësuesi/ja së bashku më nxënësit/et diskutojnë për dashurinë në familje dhe trashëgiminë objektive dhe ndjesore që mundemi të trashëgojmë ne, P.sh.:

Elemente objektive	Elemente ndjesore
shtëpi	dashuri

Në këtë poezi, figura stilistike më e përdorur është **Enumeracioni.**



Nxënësit punojnë në ushtrimet në fletoret e tyre.
Kuptojmë poezinë - ushtrimi 1.
Analizojmë poezinë - ushtrimet 2, 3, 4 (Armiqtë pushtojnë vendin dhe qëllimi i tyre është largimi i shqiptarëve nga vendi i tyre)
Gjuha e poezisë - ushtrimi 5
Pas përfundimit të detyrës, disa nxënës lexojnë detyrat dhe diskutojnë me njëri-tjetrin.
Pas diskutimeve udhëzohen të ndajnë fletën në mes dhe të shkruajnë poezinë "Trashëgimi" në njërën anë ashtu si është në libër dhe në anën tjetër të rishkruhet, por vizat të zëvendësohen me vargun e dytë "më ka lënë trashëgim" P.sh.:

Poezia	Rishkrimi
Stërgjyshi i stërgjyshërve më ka lënë trashëgim truallin, babai – shtëpinë, nëna – mirësinë, vëllai – trimërinë, motra – durimin, shokët – besnikërinë, të huajt – stuhinë, armiqtë – mërgimin, gjaku ynë – dashurinë.	Stërgjyshi i stërgjyshërve më ka lënë trashëgim truallin, më ka lënë trashëgim shtëpinë, më ka lënë trashëgim mirësinë, më ka lënë trashëgim trimërinë, më ka lënë trashëgim durimin, më ka lënë trashëgim besnikërinë, më ka lënë trashëgim stuhinë më ka lënë trashëgim mërgimin, më ka lënë trashëgim dashurinë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh
Pas leximit të poezive, nxënësit/et udhëzohen për pesëvargësh.

Trashëgimi
i vjetër i ri
Huazohet tejkalohet ruhet
është përcjellja në gjeneratën tjetër
Amaneti

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Vëreni figurën që shoqëron këtë poezi dhe shkruani një ese letrare, pasi të keni lexuar edhe këshillat e mëposhtme.
Këshilla për të shkruar një ese letrare.
Shikoni figurën dhe shkruani variante të ndryshme titujsh, të cilët do t'ju ndihmojnë për të zgjedhur titullin përfundimtar.
Mendoni se çfarë doni të shprehni. Përpiquni ta shprehni me gjuhë të figurshme.
Përdorni folje që shoqërohen me ndajfolje, si p.sh.: ndriçonte tej mase, dhe mos harroni t'i përdorni mbiemrat në shkallë të ndryshme.
Ndajeni esenë në paragrafë. Mirë janë tre, shumë mirë pesë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti poetik		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Përshkrim vizual/Kllaster
Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të shikojnë në faqen 126 ilustrimin dhe të përshkruajnë me fjalët e tyre atë çfarë shikojnë duke imagjinuar një ngjarje.
Pas përshkrimit të figurës, mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë "Vdekja e një mbretëreshe" dhe shpjegon pjesën para leximit.
Pastaj udhëzohen të lexojnë pjesën.

Fjalor:
e çmeritur – e mahnitur, e mbetur pa mend; parzmoren e çunit – veshje prej metali, e gjatë deri në brez, që mbronte luftëtarët në kohët e vjetra gjatë ndeshjeve me armë të ftohta; medos – këtu: pije e ëmbël; bazileshë – këtu: mbretëreshë; Medaurus – zoti i luftës; Ilirët e përfytyronin këtë zot si një kryetrim gjigant, majë një kali zjarrmor, e me një shigjetë në dorën e djathtë; Fari (Dimitër Fari) – një nga komandantët kryesorë të Tetës, i cili e tradhtoi atë duke ia dorëzuar flotën ilire armikut.
Pas leximit të pjesës, mësuesi/ja shpjegon për shkrimtarin.



Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim (Interpretim artistik) - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje
Pas leximit të fragmentit "Vdekja e një mbretëreshe", për ta kuptuar sa më mirë brendinë e saj, mësuesi/ja së bashku me nxënësit/et diskutojnë për monodramën dhe monologun e brendshëm.

Monologu i brendshëm është pjesë e një vepre letrare, që përmban bisedën e personazhit me vetveten, duke shprehur në këtë mënyrë mendimet e ndjenjat e tij, jetën e brendshme dhe gjendjen shpirtërore. Monologu i brendshëm rrit shkallën e

Monodrama është një vepër dramatike që shfaqet si drama e një personazhi. Në këto vepra dramatike zakonisht nuk ka shumë veprime, por teksti shfaqet si monolog ose si një shfaqje e asaj që ndodh në botën e brendshme shpirtërore të protagonistit.

Pastaj mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë detyrat.

Pastaj mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë detyrat.

Kuptojmë tekstin - ushtrimi 1 a, b, c, ç (Mbretëresha Teuta ndjehet e zhgënjyer edhe nga vendasit e saj, të cilët si duket u dorëzuan.)
Analizojmë tekstin - ushtrimet 2, 3, 4, 5 (Gjarpërinjtë simbolizojnë tradhtarët dhe armikun të cilët edhe ndikuan në përfundimin e udhëheqjes së mbretëreshës Teuta).
Gjuha e tekstit - ushtrimet 6, 7 (shpreh si gjithnjë paraqet karakterin e fortë të mbretëreshës Teuta).
Pastaj reflektojmë rreth tekstit.
Si e vlerëson faktin që Teuta nuk mendon për veten, por për fatin e popullit të saj? A mendoni se udhëheqësit e vërtetë e vendosin veten e tyre pas popullit që udhëheqin? A ndodh kjo në realitet?
Nxënësit diskutojnë dhe komentojnë qëndrimet e tyre.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh
Pas diskutimeve, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të krijojnë një pesëvargësh.

Teuta
E re e nderuar
Urdhëron dashuron lufton
U flijua që mos të bjerë në dorë të armikut
Mbretëreshë

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Mblidhni informacione të tjera rreth mbretëreshës Teutë. Paraqitini dhe diskutojini ato në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti rrëfimtar joletrar Biografi		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
• Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Stivi dhe problemat e matematikës (biografi)
Fjalët kyçe: Stiv Xhobs, rrengjet, mësuesja "Tedi", shenjtore, mësova etj.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - dallon biografinë si lloj i tekstit rrëfimtar joletrar; - analizon nëpërmjet ushtrimeve elementet e biografisë; - jep mendimin e tij/saj mbi efektin që përcjell te lexuesi biografia, dhe mesazhin e biografisë së Stiv Xhobsit. **Kriteret e suksesit:** Kupton biografinë si lloj i tekstit rrëfimtar joletrar. Ndërton sipas modelit të ushtrimeve elementet e autobiografisë. Mbledh informacione dhe shkruan një biografi për ndonjë personalitet të njohur nga shkenca, arti, letërsia.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh/pema e mendimeve

Mësuesi/ja fillon mësimin me diskutimin:

- Çfarë dini për tekstin joletrar?
- Po për biografinë keni dëgjuar?

Nxënësit do të shprehin idetë e tyre për tekstin joletrar dhe për biografinë. Idetë e tyre lidhen me njëra-tjetrën. Mësuesi/ja ndihmon që të formohet "Pema e mendimeve".



Nxënësit/et tani kanë fituar njohuri për tekstin joletrar dhe biografinë. Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se: **Teksti rrëfyes** *është një lloj shkrimi, në të cilin autori rrëfen duke u bazuar në një ndodhi të vërtetë. Personazhet janë reale, ashtu sikurse vendet, koha dhe ngjarjet....*

Pastaj i njofton nxënësit/et se pjesa që do të lexojnë është shkëputur nga biografia e shkencëtarit Stiv Xhobs. **Biografia** *është përshkrim i jetës së një njeriu, me të dhënat për jetën dhe veprimtarinë e tij. Biografia përfshin jo vetëm faktet themelore (lindja, arsimi, puna, familja, karriera, vepra, vlerësimet dhe vdekja), por edhe përvojën e personit rreth këtyre ngjarjeve.*

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia pyetje-përgjigje
Mësuesi/ja shkruan titullin e pjesës në dërrasë të zezë. "**Stivi dhe problemat e matematikës".**
Para se të lexohet pjesa, mësuesi/ja duke u mbështetur në rubrikën *para leximit*, u shpjegon nxënësve se për çfarë flet pjesa. Lexohet pjesa dhe mësuesi/ja së bashku me nxënësit/et, përmes pyetjeve dhe përgjigjeve, punojnë ushtrimin 1.

a) Në pjesë flitet për periudhën e fëmijërisë së Stiv Xhobsit.
b) Stivi e kalonte kohën duke u punuar rrengje të tjerëve. (rreng =dredhi ose diçka tjetër e keqe që i bëhet fshehtas dikujt.)
c) Sollën kafshët në shkollë, ndërruan kodet e çelësave të biçikletave të shokëve,...
ç) "Tedi"
d) Stivi mori aq pikë sa nxënësit e dy viteve më lart.

Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe dhe secili grup punon detyrat e caktuara.
Grupi I punon ushtrimin 2, Grupi II punon ushtrimin 3, Grupi III punon ushtrimin 4 (*Dallohen nga vetat, Xhobsi flet në vetën e parë ndërsa autori shpjegon në vetën e tretë*), Grupi IV punon ushtrimin 5 *(Kanë efekt bindës, bindin lexuesin për vërtetësinë e tyre*).
Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet e tyre para shokëve/shoqeve në klasë. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tryeza rrethore
Nxënësit do të analizojnë dhe do të punojnë ushtrimin 6.
Së pari mësuesi/ja drejton diskutimin rreth shprehjes së Stiv Xhobsit për mësuesen e tij: "*Prej saj mësova më shumë se nga çdo mësues tjetër dhe, po të mos qe për të, do të kisha përfunduar në burg"*. Pastaj shtron pyetjen për nxënësit: *Po ju si mendoni, cili është roli i mësuesve në jetën tuaj? A ka ndonjë mësues që ka luajtur një rol të rëndësishëm në jetën tuaj?*
Nxënësit mund të ulen në formë rrethore në grupe, por mund të organizohen edhe si një grup rrethor me tërë klasën. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të shkruajnë për këtë çështje dhe zgjedh krahun nga do të lëviz letra dhe lapsi. Çdo nxënës/e hedh në letër mendimin e tij/saj (p.sh., *Po, mësuesit kanë rolin kryesor në zbulimin e talentit,....dhuntisë sonë,...për mua....*). Secili nxënës pasi shkruan mendimin e tij e palos letrën, me qëllim që shoku i parë të mos e lexojë. Dalëngadalë formohet një letër në formë fizarmonike. Në fund, mësuesi/ja merr letrën dhe e lexon para klasës. Nxënësit vazhdojnë me leximin dhe diskutojnë për miratimet rreth saktësisë së të shprehurit të njëri-tjetrit. Kjo teknikë mund të zhvillohet edhe duke shkruar në letër me lapsa shumë ngjyrësh.

Vlerësimi i nxënësve: do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore: Diagnostifikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni informacione në lidhje me shpikjet që ka bërë Stiv Xhobs. Shkruani si e kanë ndryshuar botën këto zbulime të tij.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë dhe letërsi shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti rrëfimtar joletrar Mbresa udhëtimesh		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**

1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5. Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
7. Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.
8. Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**

1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**

1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.
8. Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. Shkathtësitë e komunikimit

Të dëgjuarit dhe të folurit

• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.

Të lexuarit

• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.

Të shkruarit

• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet

• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
• Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë

• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës

• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman.
• Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitet. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit. • Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. • Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit.
• Parafjalë, lidhëz. • Shenjat e pikësimit. • Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Rrëfimet në vetë të parë: Tirana, Durrësi, Kruja.
Fjalët kyçe: Tirana, Durrësi, Kruja, Regjisor, Dajti, Busti, pishtarë etj.
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - përshkruan ilustrimet në tekst; - dallon rrëfimin në vetën e parë; - analizon rrëfimet në tekst. **Kriteret e suksesit:** Kupton shkrimin në vetën e parë. Vlerëson rrëfimet në vetën e parë të autorit në tekst. Shkruan një rrëfim në vetën e parë.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe kl-6, fleta, marker, tabela
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Përshkrim vizual - Kllaster Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore "**Rrëfimet në vetë të parë: Tirana, Durrësi, Kruja**" pastaj udhëzon nxënësit të shikojnë ilustrimet në libër. Nxënësit do të shikojnë ilustrimet dhe do të përshkruajnë me fjalët e tyre pamjet dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin. Disa nxënës munden të shtojnë informacione shtesë nëse i kanë vizituar këto vende. Pastaj, mësuesi/ja shpjegon pjesën para leximit dhe shkruan një Kllaster për shkrimtarin.    **Ndërtimi i njohurive të reja: Secili mëson një – Pyetje-përgjigje** Në këtë fazë, pas leximit të tekstit, mësuesi/ja udhëzon nxënësit për plotësuar ushtrimet. **Grupi I - Diskutues:** Pasi kanë lexuar tekstin, përfaqësuesi i grupit prezanton para shokëve/shoqeve rrëfimin në vetën e parë të shkrimtarit Bekim Femiu. Përshkruan tri vendet e vizituara nga autori si: Tirana, Durrësi dhe Kruja. Po ashtu, përshtypjen e tyre për përshkrimin fantastik të monumenteve kulturore nga autori. **Grupi i II - Afinitet:** Ky grup udhëzohet që pasi ta ketë lexuar tekstin, të krijojnë pyetje për nxënësit tjerë për detyrë shtëpie duke u bazuar në mangësitë që ka teksti dhe çfarë të dhënash do të sjellin orën tjetër që teksti të plotësohet.

Grupi i III - Kritikët: Pasi kanë lexuar tekstin, përfaqësuesi i grupit duhet të prezantojë para shokëve/shoqeve mendimet pozitive për rrëfimin në vetën e parë të autorit (munden të paraqesin edhe ndonjë mendim negativ nëse kanë) duke arsyetuar.
Pastaj ndahen detyrat:
Grupi I: Kuptojmë tekstin - Ushtrimi 1 a, b, c, ç, d, dh, e, ë.
Grupi II: Analizojmë tekstin - Ushtrimet 2, 3, 4, 5 dhe Interpretojmë tekstin - Ushtrimet 6, 7
Grupi III: Gjuha e tekstit - Ushtrimet 8, 9, 10.
Mësuesi/ja ndihmon nxënësit nëse kanë nevojë.
Nxënësit do të punojnë në heshtje. Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet e tyre para klasës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i shkurtër
Në këtë fazë reflektojmë rreth tekstit. Mësuesi/ja pyet nxënësit:
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shkruani një rrëfim në vetën e parë. Përshkruani një vend që e keni vizituar, nga i cili mbani kujtime të bukura.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti rrëfimtar joletrar Kronika		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5. Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
7. Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.
8. Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.
8. Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e
drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
• Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitet. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit. • Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. • Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. • Parafjalë, lidhëz. • Shenjat e pikësimit. • Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Dekada e Majlinda Kelmendit (kronika)

Fjalët kyçe:

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- dallon kronikën si lloj i tekstit joletrar;
- rrit frymën e bashkëpunimit në grup duke vlerësuar/respektuar mendimin e shokëve/shoqeve;
- jep mendimin e tij/saj mbi efektin që përcjell te lexuesi/dëgjuesi kronika dhe shpjegon qëllimin e kronikës kushtuar Majlinda Kelmendit.

Kriteret e suksesit:
Kupton kronikën si lloj i tekstit joletrar;
Analizon elementet ndërtimore të kronikës si tekst joletrar rrëfimtar;
Shkruan një kronikë duke u mbështetur në udhëzimet dhe informacionet e fituara gjatë orës mësimore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore, shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Prezantim digjital-Stuhi mendimesh
Mësuesi/ja parashtron pyetjen nxënësve: A mund të tregoni se cilat lloje të shkrimeve joletrare përdoren për të shkruar gazetat? Nxënësit duke rikujtuar njohuritë nga mësimet e mëparshme do të shpërthejnë me përgjigjet e tyre: Biografia, autobiografia, intervistat, artikujt, kronikat etj.
Pikërisht sot do të zgjerojmë njohuritë për kronikën si tekst rrëfimtar joletrar - u drejtohet mësuesi/ja nxënësve. Për këtë njësi mësimore, mësuesit mund të përdorin projektorin (në mungesë të projektorit mund të përdorin celularët e tyre). Para nxënësve shpalosen me projektorë momentet kur Majlinda Kelmendi, xhudistja shqiptare nga Peja, fiton medaljen e artë në Lojërat Olimpike në Rio de Zhaneiro në vitin 2016. Dëgjohet prezantimi i xhudistes kosovare, muzika e himnit shtetëror dhe shikohet ngritja e flamurit të Republikës së Kosovës.

Mësuesi/ja shpjegon, plotëson dhe saktëson njohuritë e nxënësve për kronikën.
Kronika *është një lloj shkrimi që u kushtohet lajmeve të përditshme nga një fushë e veçantë e jetës ose e veprimtarisë së njerëzve. Në të rrëfehen fakte që kanë ndodhur vërtet. Informacioni që ajo jep u përgjigjet pyetjeve: Kush? Çfarë? Ku? Kur? Kush? Si?*
Në përgjithësi, kronikat janë shkrime të shkurtra, por të strukturuara mirë, ku dallohen mirë data, fakti, situata, pasojat.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia/pyetje-përgjigje/diskutim
Para leximit të kronikës "Dekada e Majlinda Kelmendit", mësuesi/ja duke u mbështetur te rubrika para leximit njofton nxënësit se si sportistët me sukseset e arritura bëjnë kombet e tyre të ndihen krenarë. Një nxënës/e lexon pjesën e kronikës dhe pastaj nxënësit së bashku me mësuesin/en nëpërmjet metodës pyetje-përgjigje, u japin përgjigje pyetjeve të ushtrimeve 1, 2 dhe 3.
Klasa ndahet në grupe dhe punon detyrat e caktuar nga mësuesi/ja.
Grupi I punon ushtrimin 5.
Grupi II punon ushtrimin 6.
Grupi III punon ushtrimin7.
Grupi IV punon ushtrimin 8.
Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet e tyre para shokëve/shoqeve në klasë. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura.
Me ndihmën e mësuesit/es, nxënësit plotësojnë modelin gjysmë të gatshëm të një kronike të strukturuar sipas pyetjeve që e karakterizojnë atë.

Takohemi për një libër

Jemi në *bibliotekën e qytetit të...*	Ku?
Është ora *10 e mëngjesit*.....	Sa?
Në sallën e leximit *të bibliotekës*	Ku?
Të pranishmit kanë ardhur për arsye se *bëhet prezantimit i librit të*	Pse?
Me ne ndodhen *edhe përfaqësuesit e ....*	Kush?
Pritet të vijë *autori i ....*	Çfarë?
Para nesh po kalon *S. H.....autori i mirënjohur i letërsisë...*	Kush?
Dhjetëra *qytetarë..*....	Sa?
Pjesëmarrësit u shpërndanë *në orën*.....	Kur?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Mendo/puno në dyshe/tregoju të tjerëve
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në dyshe. Ata/ato duke lexuar udhëzimet e mëposhtme në tekstet e tyre te rubrika "Shkruajmë" do të shkruajnë një kronikë rreth ngjarjeve të fundit kulturore në vendbanimin e tyre. Nxënësit do të:

- zgjedhin temën (Një ngjarje kulturore);
- përshkruajnë vendin ku zhvillohet ngjarja (Teatër, kinema, sallë koncertesh etj.);
- japin sa më shumë elemente që përcaktojnë kohën dhe vendin;
- japin fakte dhe shifra rreth numrit të spektatorëve dhe të organizatorëve.

Në përfundim, çdo grup dysh do të prezantojë idetë e veta për zgjedhjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve: do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore: Diagnostifikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni disa kronika të llojeve të ndryshme në gazeta, revista dhe internet. Këto materiale, lexojini në klasë dhe diskutoni rreth ngjarjeve të tyre.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti shpjegues-informues		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik. Dallon përshkrimin dhe rrëfimin në një tekst të caktuar.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**

1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5. Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
7. Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.
8. Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**

1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**

1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.
8. Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. Shkathtësitë e komunikimit

Të dëgjuarit dhe të folurit

• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.

Të lexuarit

• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.

Të shkruarit

• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet

• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
• Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë

• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës

• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman.
• Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitet. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit. • Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. • Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit.
• Parafjalë, lidhëz. • Shenjat e pikësimit. • Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Shtatë mrekullitë e botës antike. Ora e parë.

Fjalët kyçe: Tempull, koincidencë, piramidë, Zeusi.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- përshkruan ilustrimin në libër;
- diskuton për tekstin informues-shpjegues;
- analizon mrekullitë e botës antike.

Kriteret e suksesit:
Dallojnë mrekullitë e botës antike dhe të botës moderne.
Flasin për mrekullitë e botës antike.
Vlerësojnë rëndësinë e mrekullive të botës antike.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe kl-6, fleta, marker, tabela

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore, shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Përshkrim Vizual-Kllaster
Në këtë fazë, mësuesi/ja pyet nxënësit: Çfarë shikoni në ilustrimet e paraqitura në libër? Nxënësit përshkruajnë ilustrimet dhe bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin. Pastaj, mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë "Shtatë mrekullitë e botës antike" dhe shpjegon për nxënësit.
Mësuesi/ja shkruan një kllaster për tekstin informues.
P.sh.:

Teksti shpjegues-informues është një tekst që paraqet informacione, data dhe lajme, duke i shpjeguar në mënyrë të qartë dhe korrekte. Çdo paragraf i tij përmban informacione të reja dhe shpesh shoqërohet me ilustrime grafike, si: fotografi, skica, harta, grafikë.

Te teksti informues-shpjegues, informacioni përcillet te lexuesi në forma të ndryshme komunikimi, si nëpërmjet mediave të shkruara dhe atyre televizive, enciklopedive, artikujve, gazetave etj.

Tekste shpjeguese-informuese janë artikujt, njoftimet, broshurat, fletëpalosjet, vërtetimet, kërkesat, raportet vjetore, procesverbalet, letrat zyrtare, ftesat, shpalljet, telegramet, etiketat.

Në këtë lloj teksti përdoret gjuha standarde, si dhe fjalë teknike, sipas fushës për të cilën bën fjalë teksti. Nuk përdoret gjuha figurative.

Ndërtimi i njohurive të reja: ***Puzzle***
Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë në grupe dhe do të do të punojnë të njëjtën detyrë. Nxënësit shkruajnë për katër pjesët e mësuara në rubrika dhe në mes duhet të krijojnë një përfundim për katër mrekullitë e mësuara.



Pas përfundimit një nxënës/e nga çdo grup prezanton detyrën dhe në fund diskutojmë të gjithë bashkë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tryeza e rrumbullakët
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
• Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë
• Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
• Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman.
• Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitet. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit. • Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. • Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. • Parafjalë, lidhëz. • Shenjat e pikësimit. • Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Rregullorja e bibliotekës së shkollës. Ora e parë

Fjalët kyçe: Rregullore, audio-vizive, mision, katalogë, kartelë, kategorike.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- tregon për rregullat e bibliotekës së shkollës;
- diskuton për nenet e rregullores së shkollës;
- shkruan për nenet e rregullores së shkollës.

Kriteret e suksesit:
Dallon tekstin udhëzues ku përfshihet edhe rregullorja e bibliotekës.
Debaton për nenet e rregullores së shkollës.
Krijon një rregullore për rregullat e klasën.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe kl-6,fleta, marker, tabela

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh
Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin "Rregullorja e bibliotekës së shkollës" dhe pyet nxënësit: Si mendoni, cili është qëllimi i hartimit të një rregulloreje? Diskutoni rreth karakteristikave të përgjithshme të rregulloreve Nxënësit/et përgjigjen dhe të gjitha mendimet shënohen në tabelë.
Pastaj shpjegoj pjesën para leximit dhe tekstin udhëzues.

Tekstet udhëzuese kanë si qëllim të udhëzojnë lexuesin hap pas hapi në lidhje me një veprimtari të caktuar. Në funksion të qartësisë së shpjegimit, ato shoqërohen me ilustrime ndihmëse. Në këto lloj tekstesh përfshihen: nenet e ligjeve, manualet mësimore, recetat e gatimit, rregulloret e ndryshme etj.

Gjuha e përdorur në to është formale, me fjalë dhe terma teknikë. Për të dhënë udhëzimet dhe shpjegimet rreth tyre, përdoren fraza të tilla, si: së pari, pastaj, ndërkohë, derisa, si rezultat, për rrjedhojë, nga ana tjetër, duke e krahasuar me etj.

Ndërtimi i njohurive të reja: Diamanti 10

Në këtë fazë, pas leximit të njësisë së re mësimore, nxënësit/et punojnë në grupe dhe udhëzohen të shkruajnë kolonat për diamantin 10 dhe të shkruajnë nenet e mësuara.

Rregullorja e bibliotekës së shkollës...

Neni 1- Qëllimi...

Neni 2- Përkufizime...

Neni 3- Objekti i udhëzimit...

Neni 4- Funksionet dhe detyrat ...

Neni 5- Lejueshmëria, frekuentimi...

Neni 6- Rregulli e siguria...

Neni 7- Afatet e huazimit...

Neni 8- Dorëzimi me vonesë dhe pagesa.

Neni 9- Hyrja në fuqi...

Neni 10- Zbatimi...

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia pyetje-përgjigje Në këtë fazë, pas prezantimit të rregullores së bibliotekës, nxënësit/et udhëzohen për të punuar ushtrimet. Të gjithë do të punojnë të njëjtat ushtrime. Kuptojmë tekstin - ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5. Analizojmë tekstin - ushtrimet 6, 7, 8. Nxënësit punojnë detyrat dhe mësuesi/ja ndihmon nëse është e nevojshme. Pas prezantimit të rregullores së bibliotekës reflektojmë rreth tekstit. Mësuesi/ja pyet nxënësit: *E keni lexuar rregulloren e bibliotekës së shkollës suaj? Ku ngjason dhe ku ndryshon ajo me këtë rregullore.* Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin dhe mësuesi/ja ndërhynë nëse është e nevojshme. **Vlerësimi i nxënësve:** Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).
Detyrat dhe puna e pavarur
Ndahuni në grupe dhe hartoni rregulloren e klasës suaj. Secili grup të krijojë rregullat që përcakton nga vetë grupi dhe orën e dytë do të zgjidhet rregullorja më e mirë.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda: Gjuhë** shqipe dhe letërsi	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa B**
Tema: Tekstet udhëzuese		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik. Dallon përshkrimin dhe rrëfimin në një tekst të caktuar;	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- **Komunikues efektiv** 1.Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. 2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve. 3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim. 4.Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit. 5. Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor. 6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë. 7. Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore 8. Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.			

II.Kompetenca të menduarit -- **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1 Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim. 7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike. 8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.
III Kompetenca të mësuarit për të nxënë- **Nxënës i suksesshëm**.
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes. 7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.
8. Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).
VI Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre..
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit • Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara a të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare. • Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si:heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin
Të shkruarit • Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; Shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

II. Vlerat dhe qëndrimet
• Komunikon mirë • Merr pjesë në diskutim • Bashkëpunon • Kërkon dhe jep ndihmë • Respekton mendimin e të tjerëve • Kushton vëmendje • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive• Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe • Respekton parimet e të tjerëve• Tregon vetëbesimin për punë të pavarur • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente .
III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja: • Të komunikuarit • Të dëgjuarit • Të folurit • Të shkruarit • Të lexuarit • Të kuptuarit • Përdorimi i teknologjisë informative • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës • Komunikim verbal dhe joverbal • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitet. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit. • Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. • Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. • Parafjalë, lidhëz. • Shenjat e pikësimit. • Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Rregullorja e bibliotekës së shkollës.Ora e dytë.

Fjalët kyçe: Rregullore, audio-vizive, mision, katalogë, kartelë, kategorike.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:
Tregon për rregullat e bibliotekës së shkollës ;
Diskuton për Nenet e rregullorës së shkollës ;
Shkruan për nenet e rregullores së shkollës.

Kriteret e suksesit:
Dallon tekstin udhëzues ku përfshihet edhe rregullorja e bibliotekës;
Debaton për Nenet e rregullores së shkollës;
Krijon një rregullore për rregullat e klasën;

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe kl-6,fleta, marker,tabela

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatëorës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kollazh
Në këtë fazë mesuesi/ja kontrollon detyrat e shtëpisë dhe vendos shenjat në fletoren e vlerësimit. Nxënësit prezantojnë rregullat e klasës që i kanë përgatitur në shtëpi.

Ndërtimi i njohurive të reja: Letërkëmbimi
Në këtë fazë mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të prezantojnë punimet e tyre rregulloren e klasës.Nxënësit/et kanë punuar në shtëpi sipas udhëzimit në libër dhe neneve në njësinë mësimore "Rregullorja e Bibliotekës së shkollës.
Nxënësit do të lexojnë me radhë rregulloret e shkruara në shtëpi dhe pas leximit do të diskutojnë për rregullat më të përshtatshme për klasën e tyre.Nxënësit do të krijojnë një rregullore tjetër ku do të shenohen rregullat më të përshtatshme nga secili nxënës/nxënëse dhe do të marin Nene të përshtatshme dhe do të krijohet rregullorja e re e klasës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh
Në këtë fazë nxënësit/et udhëzohen për pesëvargësh.

Rregullorja
E re e vjetër
Shkruhet ruhet zbatohet
Vendoset në çdo institucion
Ligji

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar,shkruar dhe prezantuar.(Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Detyrë shtëpie: Shkruani në fletore rregulloren e re të klasës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Teksti argumentues		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik. Dallon përshkrimin dhe rrëfimin në një tekst të caktuar.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3. Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5. Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
7. Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.
8. Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

II. Kompetenca e të menduarit – **Mendimtar kreativ dhe kritik**
1. Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2. Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
6. Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.
III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
7. I parashtron pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.
8. Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit
• Merr, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve (nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve) për temat nga materialet e dëgjuara, të shikuara apo të prezantuara dhe reflekton për to. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit
• Analizon dhe kupton elemente të veçanta letrare, joletrare.
• Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.
Të shkruarit
• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
• Zhvillon shkrimin kreativ për tema të caktuara. Shkruan për tema të caktuara; shkruan për përvojat e veta dhe të të tjerëve në vepra të krijuara nga ai/ajo ose të tjerët dhe i përdor si bazë për tregime etj.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore:. Celulari: “Mik apo armik?”. Ora e parë
Fjalët kyçe: telefoni, interneti, mesazhi, shpenzim, koha.
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - tregon për marrëdhëniet e tyre me teknologjinë; - lexon për pasojat dhe të mirat që sjellë celulari; - vlerëson përdorimin e celularit. **Kriteret e suksesit:** Dallon mjetet e teknologjisë dhe përdorimin e tyre. Diskuton për celularin si mjetë i nevojshëm dhe që sjellë pasoja. Krijon një temë diskutimi për rreziqet që sjellë përdorimi i celularit.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe kl-6, fleta, marker, tabela
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore, shoqëria dhe mjedisi.
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë “Celulari: Mik apo armik?” dhe pyet nxënësit: Si i keni marrëdhëniet me teknologjinë? Në cilat raste e përdorni atë? Nxënësit përgjigjen dhe të gjitha mendimet shënohen në tabelë. **Ndërtimi i njohurive të reja: Lapsat në mes-Marrëdhënia pyetje-përgjigje.** Në këtë fazë, pas leximit të njësisë mësimore, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë në grupet e tyre punuese. Nxënësit do të lexojnë njësinë e re, do të shkruajnë në fletoret e tyre dhe pas përfundimit të kohës udhëzohen t’i vendosin lapsat në mes të tavolinës. Mësuesi/ja zgjedh lapsin në grup dhe nxënësit/es që i përket lapsi duhet të lexojë pjesën e shkruar. Veprohet njësoj me të gjitha grupet. Pas përfundimit të prezantimit të gjithë punojnë ushtrimet. **Kuptojmë tekstin –** ushtrimi 1 **Analizojmë tekstin –** ushtrimet 2, 3, 4, 5 **Reflektojnë rreth tekstit –** ushtrimet 6, 7 Mësuesi/ja ndihmon nëse është e nevojshme. Pastaj udhëzohen të shtojnë dy këshilla për përdorimin e celularit në listën e mëposhtme në ushtrimin e udhëzuar në libër. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh** Në këtë fazë udhëzohen për pesëvargësh Celulari i ri i vjetër dërgohet krijohet manipulohet Mik dhe armik i njeriut Telefoni
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).
Detyrat dhe puna e pavarur
Ndahuni në dy grupe dhe diskutoni lidhur me temën: “Përdorimi i teknologjisë në familjet tona dhe rreziqet e mundshme prej saj”. Gjatë diskutimit ndaluni edhe në çështjet e mëposhtme. A po bien fëmijët në grackën e teknologjisë? Ç’dini për dëmet që sjellin lojërat elektronike? Sipas jush, cila është grupmosha që është më tepër e dhënë ndaj lojërave elektronike? Cilat janë disa nga arsyet që i shtyjnë fëmijët të jenë të dhënë ndaj lojërave elektronike? Disa studiues pretendojnë se lojërat elektronike ndikojnë në rritjen e inteligjencës te fëmijët. Sa e vërtetë është kjo sipas jush?
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Fonetikë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/ja dallon theksin e fjalës, e dallon kur është fundor, para fundor, tejfundor, thekson qartë fjalët, dallon kur fjala ndryshon kuptimin me ndryshim të theksit.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur - Komunikues efektiv
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

V. Kompetenca personale
Merr pjesë, drejton, punon në grup, raporton për punën e pjesëtarëve, mban qëndrim kritik.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të shkruarit
Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon. - Kërkon dhe jep ndihmë.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit. - Të kuptuarit.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. - Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Theksi i fjalës

Fjalët kyçe: tingull, rrokje e theksuar, rrokje e patheksuar, theks fundor, zë

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- njihet me theksin e fjalës;
- gjen rrokjen në fjalë;
- dallon rrokjet e theksuara dhe të patheksuara.

Kriteret e suksesit:
Veçoni tingujt në fjalë.
Kuptoni rrokjet e theksuara dhe të patheksuara.
Shqiptoni drejt theksin e fjalës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore për verifikimin e kompetencave

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: zhvillon komunikimin

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Shqyrtim i përbashkët Mësuesi/ja iu shpjegon nxënësve rëndësinë që ka theksi i fjalës në shqiptim, sepse ndryshimi i theksit, sjellë një kuptim të ri. P.sh.: mal, shkëmb, faqe (e librit) pemë, gjethe, faqe (pjesë e fytyrës) shalli, kapela faqe (e tokës) para – ndajfolje para – emër **Ndërtimi i njohurive të reja: Punë e pavarur** Udhëzohen nxënësit që të lexojnë pjesë e dhënë në libër në heshtje, duke vënë theks të veçantë theksimit të rrokjeve, si: - rrokja e theksuar në çdo fjalë; - rrokja e theksuar në fund të fjalës; - rrokja e theksuar në rrokjen e parafundit; - rrokja e theksuar në rrokjen e parë të fjalës. Nxënësit/et lexojnë fjalët që janë dhënë me theks fundor, parafundor, tejfundor. Shembujt janë të theksuar në libër. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe** Nxënësit/et punojnë në dyshe ushtrimet 1, 2, 4, 5, (në libër). Pastaj i kontrollojnë ushtrimet një e nga një, ku nxënësi/ja shqipton fjalën dhe korrigjojnë rastet kur theksin e kanë vendosur gabim në fjalë. Ushtrimin 3 e punon një nxënës/e në dërrasë; shkruan fjalët që u përgjigjen figurave; vendos theksin duke i shqiptuar të plota.
Vlerësimi i nxënësve: - Vlerësohet puna e grupeve në dyshe. - Vlerësimi në zgjidhjen e ushtrimeve. - Vlerësimi me listë kontrolli.
Detyrat dhe puna e pavarur
Ushtrimi 7, sipas kërkesës së dhënë në libër.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësuesi/ja vlerëson punën e nxënësve sipas situatës.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Fonetikë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Shqipton qartë tingujt e zanoreve e bashkëtingëlloreve, dallon tingullin nga shkronja, dallon bashkëtingëlloret e zëshme, të pazëshme, tingëlluese, shkruajnë drejt fjalët që fillojnë me to.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv** 1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. 2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve. 4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.			

V. Kompetenca personale – **Individ i shëndoshë**
10. Merr pjesë ose udhëheq një grup punues që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj., raporton më pas me gojë ose me shkrim për përvojat personale të fituara.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit

Të shkruarit
Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon. - Kërkon dhe jep ndihmë. - Respekton mendimin e të tjerëve. - Kushton vëmendje. - Motivohet për zhvillimin e shkathtësive.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen të nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit. - Të kuptuarit.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. - Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. - Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme

Fjalët kyçe: fonema, tingulli, shkronja, zanore, bashkëtingëllore.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- njihet me zanoret dhe bashkëtingëlloret (e zëshme-e pazëshme) e shqipes;
- klasifikon zanoret dhe bashkëtingëlloret e shqipes;
- dallon shkronjat e thjeshta dhe të përbëra;
- përdor drejt tingujt dhe shkronjat në fjalë.

Kriteret e suksesit:
Mësoni zanoret dhe bashkëtingëlloret e shqipes.
Dalloni bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme.
Veçoni tingujt dhe shkronjat në fjalë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, videoprojektori, fletore për verifikim...

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: zhvillon komunikimin, art, biologji

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh
Fillimisht nxënësit njihen me alfabetin e gjuhës shqipe të paraqitur në tabelë me anë të videoprojektorit.
Pyesim nxënësit: Si i kuptoni tingujt dhe shkronjat?
Si klasifikohen tingujt?
Cilat janë zanoret e gjuhës shqipe?
Cilat janë bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe?
Nxënësit japin mendimet e tyre, nëse ka nevojë mësuesi/ja i jep sqarime. Tingujt i klasifikojmë përmes fotografisë. Nxënësit/et i dinë zanoret, prandaj ndalemi te bashkëtingëlloret, duke i radhitur ato poshtë njëra-tjetrës:
- b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh (të zëshme)
- p, t, th, k, q, f, c, ç, s, sh (të pazëshme)
- m, nj, n, l, ll, r. rr, j (tingëlluese)

Nxënësit në grupe dyshe përsëritin grupet bashkëtingëllore, pastaj e gjithë klasa shqipton me zë grupet zanore dhe bashkëtingëllore.

Ndërtimi i njohurive të reja: Mësimdhënia e ndërsjellë + lojë gjuhësore
Mësuesi/ja paraqet tabelën me dy kolona dhe udhëzon nxënësit që të lexojnë pjesën e tregimit të dhënë në libër në mënyrë individuale dhe t'i vendosin në tabelë zanoret dhe bashkëtingëlloret (shembulli i paraqitur në libër).
Nxënësit shkëmbejnë punimet e tyre duke plotësuar përdorimin e drejt të tingujve. Monitorohet puna nga mësuesi/ja. Disa nxënës shqipërojnë tingujt e paraqitur në tabelë.

Nxënësit lexojnë në heshtje informacionin për shkronjat e gjuhës shqipe. Iu rikujtojmë që të dallojnë tingullin nga shkronja, të dallojnë shkronjat e thjeshta nga ato të përbëra (nga dy shenja), theks të veçantë t'i vihet bashkëtingëlloreve të zëshme dhe të pazëshme, sipas tabelës së dhënë në libër.
Bashkëtingëlloret klasifikohen në:
- të zëshme b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh.
- të pazëshme m, n, nj, h, j, l, ll, r, rr, p, t, th, k, q, j, c, ç, s, sh.

Secili grup thekson zanorët dhe bashkëtingëlloret duke i ndarë në të zëshme edhe në të pazëshme. Nëse ka paqartësi, i sqarohen mësuesi/ja.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit
Kalohet të pjesa e ushtrimeve (1-4). Nxënësit janë të ndarë në katër grupe.
Grupi i parë punon ushtrimin 1. Sa herë është përdorur çdo fonemë (tingull) në tekstin e mëposhtëm? Plotësoni grafikun, duke ngjyrosur kutitë aq herë sa është shkruar çdo fonemë.
Grupi i dytë punon ushtrimin 2. Nënvizoni shkronjat e përbashkëta të fjalëve...
Grupi i tretë punon ushtrimin 3. Tregoni se cilët tinguj bëjnë dallimin kuptimor në fjalët e mëposhtme...
Grupi i katërt punon ushtrimin 4. Vendosni në tabelë bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme të tekstit të mëposhtëm...
Nxënësit punojnë në libër, në grupe, këmbejnë librat dhe korrigjojnë gabimet e njëri-tjetrit.
Mësimdhënësi/a ndjek punën e tyre duke korrigjuar gabimet. Ushtrimet prezantohen para klasës.
Vlerësimi i nxënësve:
- Vlerësohen nxënësit aktiv
- Vlerësimi i ndërsjellë
- Vlerësimi në zgjidhjen e ushtrimeve

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi numër 5: Plotësoni tabelën e mëposhtme...
Mëso përmendësh alfabetin, bashkëtingëlloret e zëshme, të pazëshme, tingëlluese.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesi/ja bën vlerësim të punës në grup dhe gjatë lojës gjuhësore.

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:
Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda:
Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla e kurrikulës: III</td><td>Klasa: VI</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Drejtshkrim</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
Njihen me shenjën e apostrofit, me rënien e tingullit –ë- te fjalët “më” dhe “të” dhe si të përdoret gjatë të shkruarit në fjali.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – Komunikues efektiv
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë – Nxënës i suksesshëm
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të shkruarit
Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon. - Kërkon dhe jep ndihmë. - Respekton mendimin e të tjerëve. - Kushton vëmendje. - Motivohet për zhvillimin e shkathtësive.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen t nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit. - Të kuptuarit.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. - Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. - Shenjat e pikësimit.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Apostrofi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: shenjë, presje, rënie, tingull, pjesëzës, përemër...</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- njihet me apostrofin;
- kupton shenjën e formimit të apostrofit;
- mëson përdorimin drejt të apostrofit;
- njihet me shkrimin drejt të përemrave “çdo” e “çfarë”.
Kriteret e suksesit:
Përdorni drejt apostrofin në të shkruar.
Veçoni ndërtimin e apostrofit.
Dalloni apostrofin në fjali.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: gjuha shqipe VI, tabela, fletore për verifikim...</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
zhvillon komunikimin, art</td></tr>
</table>

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Vështrim (punë e pavarur) Mësuesi/ja pyet nxënësit: Çfarë po shihni në fotografinë e paraqitur në libër? (faqe 11) Nxënësit shprehin mendimet e tyre. Ata japin shembuj, si: - T'i hedh uthull sallatës? (disa shembuj shënohen në tabelë) - *t'i lexoi, për t'u lexuar, t'ju ftojmë, t'ua sjell, , t'u realizoftë etj.* - çfarë thua, çfarëdo, çdonjëri, çdokush etj. **Ndërtimi i njohurive të reja: Mësimdhënia e ndërsjellë** Mësimdhënësi/a shpjegon: **Apostrofi është një shenjë si presje**, *e cila vendoset sipër rreshtit:* - për të shënuar rënien e tingullit -ë- te fjalët "më" dhe "të": *m'i tregoi, do t'i mësoj, për t'i pasur, me t'i thënë, do t'u përgjigjet etj.* - pas pjesëzës mohuese "s": *s'arritëm dhe jo sarritëm; s'erdhi dhe jo serdhi; s'e njoh dhe jo se njoh.* - pas përemrit "ç": *ç'e do? dhe jo* çe *do?;* ç'është*? dhe jo* çështë*?;* ç'donte*? dhe jo* çdonte*?* - Shkruhen pa apostrof përemrat "çdo" dhe "çfarë", *si edhe fjalët e formuara prej tyre: çdo djalë,* çdo vajzë, çfarë dëshiron *etj.* Kërkohet nga nxënësit që në mënyrë individuale të shkruajnë një paragraf sipas dëshirës, ku t'i kushtojnë rëndësi të veçantë përdorimit të apostrofit. Pastaj i këmbejnë fletoret në çifte për të vlerësuar punën dhe për të dhënë formën e drejtë të apostrofit. Disa nxënës/e lexojnë punimet para klasës. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit** Vazhdohet me pjesën e ushtrimeve. - **Ushtrimi numër 1** punohet në mënyrë individuale, prezantohet me gojë. - **Ushtrimi numër 2** punohet në grupe, pastaj këmbejnë librat në çifte, vlerësojnë punën e grupeve. Ushtrimet prezantohen para klasës.
Vlerësimi i nxënësve: - Vlerësim me gojë në situatën e të nxënit. - Vlerësimi në punën me grupe. - Vlerësim me shkrim në zgjidhjen e ushtrimeve.
Detyrat dhe puna e pavarur
Ushtrimi numër 3: Shkruani një tregim të shkurtër me temë "*Fluturim në kozmos*", në të cilin të përdorni deri në dhjetë fjalë që shkruhen me apostrof.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësuesi/ja vlerëson të shkruarit, të folurit dhe të shprehurit e nxënësve...

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Drejtshkrim		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/ja përdor drejtshkrimin e lidhëzave duke respektuar të gjitha rastet e drejtshkrimit, i shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv** 5. Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.			

III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
1. Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit

Të shkruarit
Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon. - Kërkon dhe jep ndihmë. - Respekton mendimin e të tjerëve. - Kushton vëmendje. - Motivohet për zhvillimin e shkathtësive.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen të nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit. - Të kuptuarit.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. - Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. - Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Drejtshkrimi i lidhëzave

Fjalët kyçe: drejtshkrim, lidhëz, të parme, të përngjitura, shprehje lidhëzore...

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Në fund të orës së mësimit nxënësi/ja:
- njihet me drejtshkrimin e lidhëzave;
- klasifikon lidhëzat sipas formimit;
- shkruan drejt në fjali.

Kriteret e suksesit:
Kuptoni drejtshkrimin e lidhëzave.
Veçoni klasifikimin e lidhëzave
Dalloni të shkruarit e lidhëzave bashkë dhe ndaras.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore për verifikim...

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
zhvillon komunikimin, art

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Vështrim (punë e pavarur)
Mësuesi/ja pyet nxënësit: Çfarë po shihni në fotografinë e paraqitur në libër? (faqe 12)
Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe formojnë fjali të ndryshme.
Ndërtimi i njohurive të reja: Mësimdhënia e ndërsjellë - Punë e pavarur
Udhëzohen të gjejnë pjesën e tekstit të dhënë afër fotografisë që të shkruajnë lidhëzën që mungon. P.sh.: *Dreni _____ gjyshja e tij po hanin akullore në park. Gjyshja po i thoshte: - Mbrëmë pashë diçka të çuditshme _____ po kthehesha në shtëpi...*

Mësuesi/ja shpjegon:
- Lidhëzat që shkruat në tekstin e mësipërm, janë: *dhe, kur, megjithatë, as, që, me qëllim që. Lidhëzat dhe, kur, as,* që janë lidhëza të parme; lidhëza *megjithatë* është lidhëz e përngjitur; lidhëza *me qëllim* që është shprehje lidhëzore.
- Siç vihet re në shembujt e mësipërm, lidhëzat e parme dhe të përngjitura shkruhen bashkë; shprehjet lidhëzore shkruhen ndaras.

Dy apo tre nxënës/e komentojnë drejtshkrimin e lidhëzave.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit
Vazhdohet me pjesën e ushtrimeve.
Ushtrimet 1 dhe 2 punohen në grupe, pastaj këmbejnë librat në çifte dhe nxënësit vlerësojnë punën e grupeve. Ushtrimet prezantohen me gojë.
Ushtrimin numër 3 punohet individualisht sipas kërkesës në libër.
Puna vëzhgohet nga mësuesi/ja dhe sqarohet ku ka paqartësi. Ushtrimet prezantohen para klasës.

Vlerësimi i nxënësve:
- Vlerësim me gojë në situatën e të nxënit.
- Vlerësimi në punën me grupe.
- Vlerësim me shkrim në zgjidhjen e ushtrimeve.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi numër 4:
Shkruani dy fjali që të kenë lidhëza të thjeshta, dy që të kenë lidhëza të përngjitura dhe dy që të kenë shprehje lidhëzore.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesi/ja vlerëson të shkruarit, të folurit dhe të shprehurit e nxënësve.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Fjalëformim		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/ja dallon fjalët e parme dhe jo të parme, fjalët e prejardhura me pjesët përbërëse, parashtesa + rrënja + prapashtesa, formon fjalë të reja të prejardhura, pasuron fjalorin me fjalë të reja, i përdor në fjali.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
8. Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit - Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit - Pasuron fjalorin.
Të shkruarit - Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon. - Kërkon dhe jep ndihmë. - Respekton mendimin e të tjerëve. - Kushton vëmendje. - Motivohet për zhvillimin e shkathtësive - Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen të nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit. - Të kuptuarit. Të menduarit krijues
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Komunikim verbal dhe joverbal. - Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. - Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Fjalë të parme dhe jo të parme

Fjalët kyçe: fjalë e parme, jo e parme, e prejardhur, e përbërë, e përngjitur...

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- njihet me fjalët e parme dhe jo të parme;
- njihet me formimin e fjalëve të prejardhura;
- pasuron fjalorin me formimin e fjalëve të reja.

Kriteret e suksesit:
Përdorni drejt fjalët e parme dhe jo të parme.
Veçoni formimin e fjalëve të prejardhura.
Dalloni përbërësit e fjalëve të parme dhe jo të parme.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletorja për verifikim...

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Mësimdhënia e ndërsjellë
Mësuesi/ja iu shpjegon nxënësve për përbërjen e fjalëve të parme dhe jo të parme.
Fjalët që përbëhen vetëm nga rrënja, quhen **fjalë të parme**. Pra, këto fjalë nuk formohen prej fjalësh të tjera: *tokë, kokë, atë, shtëpinë* etj.
Fjalët quhen **jo të parme** kur formohen prej fjalësh të tjera (parashtesa apo prapashtesa), si dhe me mënyra të tjera. Fjalë jo të parme janë: ëmbëlsi, udhëtim, udhëkryq, anembanë, rilexoj etj.
- **Fjalët jo të parme** mund të jenë:
- **të prejardhura**: *përurim, ndërhyj, mosbesim, mbiçmoj, jonormal, gjuhësi, këngëtar, barkas, përfundoj, pafundësi, zbukuroj*;
- **të përbëra**: *verilindje, kuqezi, duarartë, gjellëbërës, trefish;*
- **të përngjitura**: *farefis, gjëegjëzë, i drejtpërdrejtë, gjithmonë*.
- **Fjalët e prejardhura** formohen me parashtesim (parashtesë + temë), me prapashtesim (temë + prapashtesë), me parashtesim dhe prapashtesim njëherësh (parashtesë + temë + prapashtesë).

P.sh.
për + vesh = përvesh
nën + tok + a = nëntoka
ri + vlerësoj = rivlerëso
këngë + tar = këngëtar

Ndërtimi i njohurive të reja: Pema e mendimit
Nxënësit pasi marrin informacionet për fjalët e parme dhe jo të parme; për fjalët e prejardhura; fjalët e përbëra dhe fjalët e përngjitura, udhëzohen të paraqesin në fletoret e tyre pemën e mendimit, familjen e një fjale, si p.sh.:
Shkruajmë në tabelë familjen e fjalës *lexoj*.



Në familjen e fjalës *lexoj*, nxënësit japin kuptimin e çdo fjale, duke i përdorur në fjali, pra janë përftuar 12 fjalë të reja me ndihmën e parashtesave dhe prapashtesave.
Me anë të lojës "zinxhir", nxënësit përsëritin parashtesat e prapashtesat që janë dhënë në tabelë, japin edhe fjalë të reja të formuara me to.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Lojë gjuhësore

Ushtrimi 1 punohen individualisht, sipas kërkesës së dhënë në libër, dhe prezantohet para klasës.
Ushtrimet 2 dhe 3 punohen në grupe, prezantohen në tabelë dhe shkruhen shembujt sipas kërkesës. Nxënësit përgjigjen për ushtrimet 2, 3 dhe me ndihmën e mësuesit/es korrigjojnë gabimet.

Vlerësimi i nxënësve:
- Vlerësim në veprimtari në situatën me gojë.
- Vlerësim në zgjidhjen e ushtrimit.
- Vlerësim me listën e kontrollit.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimin numër 4, sipas kërkesës së dhënë në libër.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesi/ja vlerëson ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Leksikologji		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/ja dallon formën dhe përmbajtjen e fjalës, përdor fjalë me kuptime të drejtpërdrejta dhe me kuptime të figurshme, dallon fjalët që formojnë fushën leksikore.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
8. Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit

Të dëgjuarit dhe të folurit - Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit - Pasuron fjalorin.
Të shkruarit - Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon. - Kërkon dhe jep ndihmë. - Respekton mendimin e të tjerëve. - Kushton vëmendje. - Motivohet për zhvillimin e shkathtësive - Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit. - Të kuptuarit. Të menduarit krijues

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Komunikim verbal dhe joverbal. - Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. - Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Fjala dhe kuptimi i saj

Fjalët kyçe: fjala, kuptimi, forma, figura, mënyra e krijimit...

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- njihet me fjalën dhe përbërjen leksikore;
- njihet me kuptimin e fjalës;
- pasuron fjalorin me formimin e fjalëve të reja.

Kriteret e suksesit:
Përdorni drejt fjalët me kuptim leksikor.
Veçoni mënyrën e krijimit të kuptimeve të figurshme.
Dalloni kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletorja për verifikim...

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Tryezë rrethore
Një nxënës/e lexon informacionin e dhënë në libër:
- Fjala dhe kuptimi i saj.
- Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve.
- Mënyrat e krijimit të kuptimeve të figurshme të fjalëve.

Nxënësit udhëzohen që të punojnë, në fletore, në mënyrë rrethore për secilën pjesë të tekstit, pra:
- Forma e fjalës përbëhet nga tërësia e tingujve (kur e shqiptojmë) dhe e shkronjave (kur e shkruajmë).

P.sh.: forma e fjalës çelës përbëhet nga tingujt dhe shkronjat ç / e / l / ë / s - çelës (forma).
Analizojmë bashkërisht fjalën çelës në tabelën e paraqitur në libër për kuptimin e parë, të dytë dhe të tretë të fjalës. Secili nxënës/e analizon shembujt në tabelë, si p.sh.:
- Shishe = sh + i + sh + e Forma
Shishe = objekt qelqi ose qeramike plastike (kuptimi)
- Dorë = d + o + r + ë Forma
Dorë = një gjymtyrë e njeriut (kuptimi 1)
Më dha dorë = më ndihmoi (kuptimi 2)

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e konceptit
Udhëzohen nxënësit që me njohuritë e fituara të formojnë tabelën e konceptit, duke theksuar kuptimin e parë, të dytë dhe të tretë të fjalisë, p.sh.:

Flet – kuptimi i parë – flet njeriu
kuptimi i dytë – fletë gjethi
kuptimi i tretë – fletë fletoreje

Faqe – kuptimi i parë – pjesë e fytyrës
kuptimi i dytë – pjesë e librit
kuptimi i tretë – pjesë e tokës

besë → besoj, besim, besimtarë, besnikëri

dorë → dorezë, dorëzoj, përdor, shpërdor

Mësuesi/ja vëzhgon punën e nxënësve, sqaron dhe përmirëson gabimet e tyre (jepet forma e drejt). Nxënësit diskutojnë punën e bërë në grup, pastaj në dërrasë të zezë shënohen shembuj dhe analizohen nga klasa. Duke u bazuar në fotografinë e dhënë në libër, ata japin kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme që shohin. Pastaj emërtojnë të gjitha sendet që kanë rreth vetës.
Nxënësit/et lexojnë tabelën në libër dhe përkufizojnë se ç'është fusha leksikore.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtim i përbashkët
Ushtrimet 1 dhe 2 punohen në çifte pastaj komentohen në grupe. Ato prezantohen në tabelë dhe sipas kërkesës shkruhen shembujt. Nxënësit përgjigjen për ushtrimet 1, 2 dhe me ndihmën e mësuesit/es korrigjojnë gabimet.

Vlerësimi i nxënësve:
- Vlerësim në situatën e të nxënit.
- Vlerësim në zgjidhjen e ushtrimit.
- Vlerësim me listën e kontrollit

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimin numër 3, sipas kërkesës së dhënë në libër.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesi/ja vlerëson ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Morfologji		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/a emërton figura duke dalluar emrat kur janë të përgjithshëm, të përveçëm, kur janë konkretë, abstraktë në ushtrimet që punuan në libër.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
8. Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit

Të dëgjuarit dhe të folurit - Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit - Pasuron fjalorin.
Të shkruarit - Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon. - Kërkon dhe jep ndihmë. - Respekton mendimin e të tjerëve. - Kushton vëmendje. - Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. - Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit. - Të kuptuarit. Të menduarit krijues

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Komunikim verbal dhe joverbal. - Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. - Parafjalë, lidhëz. -Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Emri

Fjalët kyçe: emërtim, kuptim leksikor, i përgjithshëm, i përveçëm, konkretë, abstraktë

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- njihet me emrin dhe kategoritë gramatikore;
- njihet me kuptimin leksikor të emrit;
- njihet me ndarjen e emrit sipas kategorive gramatikore;
- shkruan drejt llojet e emrave.

Kriteret e suksesit:
Përdorni drejt emërtimin e gjësendeve.
Veçonin kuptimin leksikor.
Dalloni kategoritë gramatikore të emrit.
Dalloni emrat e përveçëm nga emrat e përgjithshëm.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore pune...

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Zhvillon komunikimin, zhvillon fjalorin, art

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Pema e mendimit
Nxënësit/et tregojnë njohuritë paraprake që kanë për emrin, ndërtimin dhe llojet e tij. Vështrojnë fotografitë e dhëna në libër për dy minuta dhe emërtojnë secilën foto duke treguar çfarë shohin aty. Bashkëbisedohet me mësuesin/en për të ndërlidhur njohuritë paraprake me njohuritë e reja dhe për të dhënë përgjigje të sakta, të cilat paraqiten në pemën e mendimeve me shembuj, si:



Ndërtimi i njohurive të reja: Diagrami i Venit

Një nxënës/e lexon me zë informacionin në libër, duke u ndalur te ndërtimi leksikor dhe kategoritë gramatikore të emrit (diskutohen shembujt e dhënë për secilin lloj të emrit).
P.sh.
Emri tregon frymorë, sende, veprime, objekte, dukuri të natyrës, koncepte abstrakte etj.

- Sipas kuptimit leksikor, dy nga ndarjet e emrave janë:

1. Emra të **përgjithshëm** (mal, kodër, rrugë, fëmijë,) dhe të **përveçëm** (Adriatiku, Buna, Hëna, Evropa, Teuta, Atlantiku, Republika e Kosovës).
2. Emra **konkretë** (ujë, djathë, lumë, mal) dhe **abstraktë** (emocion, mendim, gjykim, besë).

- Kurse sipas kategorive gramatikore, emrat ndahen në:

1. emra të gjinisë mashkullore, femërore, asnjanëse;
2. emra të numrit njëjës dhe të numrit shumës;
3. emra të rasës emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore;
4. emra të trajtës së shquar dhe të trajtës së pashquar;
5. emra të lakimit të parë, të dytë, të tretë, të katërt.

Pra, nxënësit udhëzohen që njohuritë e fituara për emrin t'i paraqesin në diagramin e Venit.



Nxënësit/et dalin në tabelë plotësojnë diagramin, duke dhënë elementet e veçanta dhe elementet e përbashkëta të llojeve të emrit, sipas kuptimit leksikor.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtim i përbashkët
Nxënësit janë të ndarë në gjashtë grupe, secilit grup i caktohet ushtrimi sipas kërkesës në libër...
Ushtrimi 1: Plotësoni vendet boshe me emra të përveçëm.
Ushtrimi 2: Shkruani emra të përgjithshëm dhe emra të përveçëm sipas fushës përkatëse.
Ushtrimi 3: Përgjigjuni pyetjeve. Shënoni EA për emrat abstraktë dhe EK për emrat konkretë.
Ushtrimi 4: Plotësoni vendet boshe, duke kthyer emrat konkretë në abstraktë dhe emrat abstraktë në konkretë.
Ushtrimi 5: Përcaktoni nëse fjalët e nënvizuara janë emra konkretë apo emra abstraktë.
Ushtrimi 6: Kthejini mbiemrat dhe foljet e mëposhtme në emra abstraktë.

Mësuesi/ja monitoron punën e tyre duke korrigjuar gabimet. Shkëmbehen librat mes grupeve dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit. Ushtrimet prezantohen para klasës.

Vlerësimi i nxënësve:
- Vlerësohen nxënësit aktiv
- Vlerësimi me listë kontrolli
- Vlerësimi i ndërsjellë
- Vlerësimi me gojë dhe me shkrim në klasë e shtëpi.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi numër 7:
Shkruani një tekst me dhjetë fjali në të cilin të përdorni emra të përveçëm dhe të përgjithshëm, konkretë dhe abstraktë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë, me shkrim...

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Morfologji		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/ja analizon emrin për kategoritë gramatikore të gjinisë, numrit. Dallon mjetet gramatikore që formojnë gjininë dhe numrin e emrave në gjuhën shqipe dhe i përdor ata drejt në fjali.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5. Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
8. Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.
III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë **- Nxënës i suksesshëm**
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të dëgjuarit dhe të folurit - Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme.
Të lexuarit - Pasuron fjalorin.
Të shkruarit - Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon. - Kërkon dhe jep ndihmë. - Respekton mendimin e të tjerëve. - Kushton vëmendje. - Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. - Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja:
-Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit. - Të kuptuarit. - Të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Komunikim verbal dhe joverbal. - Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. - Parafjalë, lidhëz. - Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Gjinia dhe numri i emrit
Fjalët kyçe: gjinia dhe numri i emrit, formimi i numrit dhe gjinisë së emrit...
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - njihet me gjininë e emrit; - njihet me numrin e emrit; - shkruan drejt gjininë dhe numrin e emrit; - pasuron fjalorin. **Kriteret e suksesit:** Përdorni drejt gjininë dhe numrin e emrit. Veçoni gjininë dhe formimin e numrit të emrit. Dalloni gjininë dhe numrin në fjalë.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore pune...
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin, Zhvillon fjalorin, Art
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Pema e mendimit Plotësojmë së bashku pemën e mendimit:    Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë pemën e mendimit në fletore, duke përsëritur kategoritë gramatikore të emrave, jepni shembuj dhe analizojnë veç e veç. Disa nxënës/e dalin në tabelë e plotësojnë pemën e mendimit, sipas kërkesës. **Ndërtimi i njohurive të reja: Mësimdhënie e ndërsjellë** Nxënësi/et rikujtojnë njohurit që kanë për gjininë dhe numrin e emrit. Vështrojnë fotografitë e dhëna në libër, emërtojnë secilën prej tyre, mandej fjalët e emërtuara, gjejnë gjininë dhe numrin e emrave. Diskutohet, dhe gabimet rregullohen bashkërisht nga nxënësit dhe mësuesi/ja. Nxënësit/et lexojnë pjesën e tekstit të dhënë në libër, ndalen të gjinia asnjanëse që mësojnë për herë të parë (të ecurit, të folurit, të ftohtët etj.). Nxënësit/et lexojnë në libër kur emri është në numrin njëjës dhe në numrin shumës, siç e formojnë shumësin e tyre: - Emra që kanë vetëm formën e njëjësit: *dëborë, rërë, naftë*. - Emra që e ruajnë formën e tyre kur kalojnë në shumës: *nxënës, mësues, shoqe*. - Emra që e formojnë shumësin me mbaresë: *gëzim, vajzë, bari*. - Emra që e formojnë shumësin me ndërrim tingulli + mbaresë: *breg – brigje shteg – shtigje.* Diskutohen shembujt e dhënë për secilin formë të emrit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit
Nxënësit janë të ndarë në gjashtë grupe dhe secilit grup i caktohet ushtrimi sipas kërkesës në libër...
Ushtrimi 1: Vendosini emrat në kllapa në gjininë dhe në numrin e duhur.
Ushtrimi 2: Plotësoni tabelën me emrat që përmban teksti i mësipërm sipas gjinisë.
Ushtrimi 3: Vendosni emrat në formën e duhur.
Ushtrimi 4: Gjeni emrat dhe përcaktoni gjininë, numrin dhe rasën e tyre.
Ushtrimi 5: Vendosni në tabelë pesë emra nga teksti i mësipërm. Shënoni gjininë, numrin dhe rasën e secilit.
Ushtrimi 6: Shkruani fjali me emra të gjinisë asnjanëse: të qeshurit, të qarët, të ftohtët.
Mësuesi/ja monitoron punën e tyre duke korrigjuar gabimet.
Shkëmbehen librat mes grupeve dhe nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
Ushtrimet prezantohen para klasës.

Vlerësimi i nxënësve:
- Vlerësohen nxënësit akti, puna në grupe.
- Vlerësimi me listë kontrolli.
- Vlerësimi i ndërsjellë.
- Vlerësimi me gojë dhe me shkrim në klasë e shtëpi.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 7: Shkruani një tekst të shkurtër për miqësinë. Përdorni sa më shumë emra. Përcaktoni gjininë dhe numrin e tyre.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë, me shkrim...

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Morfologji		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/a dallon foljet, i ndan ato në tri zgjedhime, dallon foljet në gjashtë mënyra, gjenë temën, mbaresën e foljeve, dallon format e pashtjelluara në ushtrimet e librit.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm
8. Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
- Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Komunikim verbal dhe joverbal. - Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. - Parafjalë, lidhëz. - Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Mënyrat dhe kohët e foljes

Fjalët kyçe: folje, zgjedhim, kohë të thjeshta, të përbëra, format e shtjelluara, e pashtjelluara

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- rikujton njohuritë e marra për foljen;
- dallon format e shtjelluara e të pashtjelluara;
- klasifikon kohët e foljes;
- përdor drejt foljen në fjali.

Kriteret e suksesit:
Mësoni kohët e foljes.
Veçoni mënyrat e shtjelluara.
Veçoni mënyrat e pashtjelluara.
Dalloni kohët e foljes të thjeshta e të përbëra.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore pune, fleta të bardha-hamer

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Zhvillon komunikimin, Pasuron fjalorin me shprehje të reja, Shpreh bukur mendimet, Me sportin, me lëndën e biologjisë, Me edukimin qytetar të nxënësit

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Mësimdhënie e ndërsjellë
Mësuesi/ja fillon orën mësimore duke diskutuar me nxënësit për njohuritë paraprake që ata kanë për foljen.
- Çfarë tregon folja?
- Sa zgjedhime ka ajo?
- Cilat janë kohët bazë të foljes?
- Cilat janë mënyrat e foljes?

Nxënësit shprehin mendimet e tyre, mësuesi/ja në mënyrë të ndërsjellë iu shpjegon:
Folja mund ta shprehë veprimin në mënyra të ndryshme.
Mënyra të foljes quajmë format e ndryshme që merr folja për të shprehur një veprim të sigurt, të mundshëm, të dëshirueshëm ose të papritur.
Folja ka gjashtë mënyra: dëftore, lidhore, kushtore, habitore, dëshirore dhe urdhërore (shembuj).
Folja ka tri kohë: kohën e shkuar, kohën e tashme dhe kohën e ardhme (shembuj). Ato tregojnë kohën kur ka ndodhur veprimi në lidhje me çastin e ligjërimit.
Koha e shkuar ka pesë nënndarje: koha e ardhme ka dy nëndarje: kohën e ardhme dhe kohën e ardhme të përparme (shembuj).
Format e pashtjelluara të foljes nuk zgjedhohen (shembuj).

Ndërtimi i njohurive të reja: Pema e mendimit

Një nxënës/e lexon me zë informacionin në libër duke u ndalur të shembujt, të cilët i sqarojnë bashkërisht, si për format e shtjelluara e të pashtjelluara të foljes, kohët bazë, të thjeshta e të përbëra...

Udhëzohen nxënësit që përmes "Pemës së mendimeve" të paraqesin njohuritë që kanë për mënyrat dhe kohët e foljes. Punohet në grupe, diskutohet dhe përfaqësuesit e grupeve dalin e plotësojnë njërën nga rubrikat në tabelë, p.sh.:

Mësuesi/ja vëzhgon punën e nxënësve, sqaron ku ka paqartësi, ndihmon nxënësit për të plotësuar "Pemën e mendimeve" në mënyrë të drejtë. Më poshtë është dhënë një model.

Secili grup prezanton punën e bërë për mënyrat dhe kohët e foljes. Argumentojnë punë me shembuj konkretë. Dëgjohen nga klasa.



Ora e dytë

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtim i përbashkët

Gjeni foljet në fragmentin e mëposhtëm:
Hapni një llogari kursimi dhe vlerësoni përparësinë që ju sjell sigurimi i një depozite personale. Depozitimin e rregullt në llogarinë e kursimit vlerësojeni si një shpenzim të pashmangshëm, njëlloj si pagesën e faturës së energjisë elektrike.
Nxënësit/et në grupe dyshe gjejnë foljet dhe i analizojnë ato: kohë, vetë, numër.
- Si e shprehin mendimin foljet: hapni, vlerësoni, vlerësojeni? (urdhër, këshillë)
- Po folja sjell? (veprim i sigurt, dëftore)

Pastaj nxënësit me mësuesin/en diskutojnë dhe plotësojnë njohuritë e nxënësve me konceptet për foljen: zgjedhim, mënyrë, folje ndihmëse kam, jam, tema e mbaresa e foljeve, format e shtjelluara e të pashtjelluara etj.

Vazhdohet me pjesën e ushtrimeve, nxënësit ndahen në pesë grupe.
Grupi I: Nënvizoni foljet dhe vendosini në të gjitha mënyrat, në tabelë.
Grupi II: Shkruani fjalinë e mëposhtme duke e përdorur foljen në të gjitha mënyrat e saj.
Grupi III: Plotësoni vendet boshe me foljet që mungojnë dhe tregoni mënyrën e kohën e tyre.
Grupi IV: Gjeni foljet dhe tregoni se në çfarë mënyre, kohe, vete dhe numri janë.
Grupi V: Formoni fjali me foljet lexoj, flas, zhvilloj, pres, laj, eci, hyj, duke i përdorur në mënyra të ndryshme.
Punohen në grupe, komentohen. Mësuesi/ja monitoron punën e tyre.
Ushtrimet prezantohen para klasës.

Vlerësimi i nxënësve:
- Vlerësohen nxënësit aktiv, puna në grupe.
- Vlerësimi i ndërsjellë.
- Vlerësimi me listë kontrolli.
- Vlerësimi me gojë dhe me shkrim në klasë e shtëpi.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtroni kohët e thjeshta dhe të përbëra të foljeve...

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë, me shkrim...

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Morfologji		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/a njihet me formën veprore dhe joveprore të foljes, dallon formën veprore dhe joveprore dhe mëson për ndërtimin e tyre.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
6. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit

Të shkruarit
Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon. - Kërkon dhe jep ndihmë. - Respekton mendimin e të tjerëve. - Kushton vëmendje. - Motivohet për zhvillimin e shkathtësive - Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit. - Të kuptuarit. - Të menduarit krijues

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Komunikim verbal dhe joverbal. - Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. - Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Forma veprore dhe joveprore e foljeve

Fjalët kyçe: folje, formë, veprim, joveprim, ndërtim

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- përvetëson formën veprore dhe joveprore të foljeve;
- dallon formën veprore dhe joveprore të foljeve;
- njihet me ndërtimin e formës joveprore.

Kriteret e suksesit:
Përdorni drejt formën veprore dhe joveprore të foljeve.
Veçoni ndërtimin e formave veprore.
Veçoni ndërtimin e formave joveprore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore...

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: zhvillon komunikimin, edukatë qytetare, art
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Vështrim (punë e pavarur) Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të vështrojnë fotografinë e dhënë në libër, pastaj të lexojnë pjesën e tregimit anash fotografisë, duke iu përgjigjur kërkesës: *Nënvizoni foljet e tekstit të mëposhtëm. Çfarë vini re?* Nxënësit shprehin mendimet e tyre duke dhënë shpjegim para klasës. Më pas një nxënës/e lexon me zë pjesën e tregimit ndërsa disa nxënës përgjigjen sipas kërkesës me shembuj. Ata plotësohen dhe korrigjohen nga nxënësit dhe mësuesi/ja, **Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim dhe shqyrtim i përbashkët** Mësimdhënësi/a shpejgon, si: - Folja *dëgjoj* është në formën veprore, sepse tregon një veprim që e kryen kryefjala *maçoku* dhe bie mbi kundrinorin e drejt *fishkëllimën*. - Ndërsa foljet *ngrohje, ndihej, ishte kthyer, u afrua* janë në formën joveprore, sepse tregojnë veprime që kryhen prej dikujt tjetër dhe që o pësojnë kryefjalët. - Format joveprore të foljeve ndërtohen: me mbaresa që janë ndryshe nga ato të formës veprore: *dëgjohem…* me pjesëzën *u* në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore: *u ktheva…* me ndihmën e foljes *jam* për të formuar kohë të përbëra: *jam këshilluar…* Nxënësit marrin njohuri të reja për formën veprore dhe joveprore, nga shembujt e dhënë në dërrasë të zezë dhe informacionin në libër. Disa nxënës/e komentojnë pjesën e mësuar. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe - diskutim** Pasi nxënësit të përmbledhin formën veprore dhe joveprore, kalohet të pjesa e ushtrimeve (1-3). Nxënësit/et punojnë në çifte, shkëmbejnë librat mes tyre dhe korrigjojnë punën e njëri-tjetrit. Mësuesi/ja monitoron punën e tyre duke korrigjuar gabimet. Disa nga çiftet prezantojnë ushtrimet para klasës. Diskutohet për format veprore dhe joveprore të foljeve duke konkretizuar me shembuj me gjithë klasën. Korrigjohen gabimet dhe tregohet forma e duhur e përdorimit.
Vlerësimi i nxënësve: - Vlerësohen nxënësit aktiv. - Vlerësimi me listë kontrolli. - Vlerësimi i ndërsjellë.
Detyrat dhe puna e pavarur
Formoni fjali me folje në formën veprore dhe joveprore.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësuesi/ja komenton ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Morfologji		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/a dallon foljet në mënyrën dëftore, jep përkufizimin për kuptimin që shpreh folja në mënyrën dëftore. Dallon kohët e thjeshta nga ato të përbëra (folja ndihmëse kam). Zgjedhon foljet në mënyrën dëftore.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur **- Komunikues efektiv**
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
- Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Komunikim verbal dhe joverbal. - Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. - Parafjalë, lidhëz. - Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Zgjedhimi i foljeve në formën veprore të mënyrës **dëftore**

Fjalët kyçe: zgjedhim, folje, formë veprore, mënyra dëftore

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- rikujton njohuritë e marra për formën veprore dhe zgjedhimin në mënyrë dëftore;
- mëson ndërtimin e formës veprore të zgjedhimit në mënyrën dëftore;
- përdor drejt formën veprore të zgjedhimit në mënyrën dëftore.

Kriteret e suksesit:
Veçon formën veprore të mënyrës dëftore.
Kupton zgjedhimin e mënyrës dëftore.
Dallon formën veprore të zgjedhimit në mënyrën dëftore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore pune

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Zhvillon komunikimin, Me sportin, me lëndën e biologjisë, Me edukimin qytetar të nxënësit.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Vështrim – Punë e pavarur
Nxënësit/et vështrojnë fotografinë e dhënë në libër. Lexojnë pjesën e tregimit anash fotografisë duke iu përgjigjur kërkesës: *Nënvizoni foljet dhe përcaktoni kohët e tyre.*
Nxënësit shprehin mendimet e tyre për pamjen e fotografisë dhe më pas një nxënës/e lexon me zë pjesën e tregimit. Nxënësit japin përgjigje dhe plotësohen ose korrigjohen nga klasa dhe mësuesi/ja.

Shkruaj në tabelë fjalitë:
- *Mendojmë* për këtë (e tashme)
- *Kam menduar unë për këtë* (e shkuar)
- *Do të mendoj unë për këtë* (e ardhme)

} Veprime të sigurta

Nxënësi/ja dhe mësuesi/ja nga analiza e fjalive për nga kuptimi, nxjerrin se folja në mënyrën dëftore shpreh një veprim ose një gjendje si të sigurt, të vërtetë, që ka ndodhur në të shkuarën, po ndodh në të tashmen apo do të ndodhë në të ardhmen.

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve – Loja zinxhir
Nxënësit njihen me informacionin që jepet në libër dhe ndalen në ndarjen e kohëve të mënyrës dëftore: 4 të thjeshta, 4 të përbëra, si ndërtohen ato (mjetet gjuhësore që shërbejnë).
Nxënësit punojnë në grupe dyshe me tabelën e zgjedhimit të foljeve në mënyrën dëftore me folje në të tria zgjedhimet.
Ndalen në dallimin e temës dhe mbaresës së foljeve, e gjithashtu në foljen ndihmëse *kam*, e cila formon kohët e përbëra.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit
Vazhdohet me pjesën e ushtrimeve. **Ushtrimet 2 dhe 3** punohen në grupe sipas kërkesës së dhënë në libër, prezantohen para klasës, plotësohen nga nxënësit dhe mësuesi/ja.
Ushtrimet 1, 4, 5 punohen në mënyrë individuale. Nxënësit këmbejnë punimet në çifte dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit. Për ushtrimin numër 5 përgjigjen në dërrasë dy nxënës/e. Klasa plotëson përgjigjen e tyre.
Mësuesi/ja monitoron punën e tyre, pastaj ushtrimet i diskutojnë me klasën dhe jepen zgjidhjet e drejta të ushtrimeve.

Vlerësimi i nxënësve:
- Vlerësimi me gojë në situatën e të nxënit.
- Vlerësimi në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim, individualisht.
- Vlerësimi i ndërsjellë.
- Vlerësimi me listë kontrolli.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 6: Vendosni foljet bëj, kap, fle në të gjitha kohët e mënyrës dëftore në vetën e dytë, në numrin shumës.
Ushtrimi 7: Krijoni fjali me grupet e fjalëve të dhëna, duke i vendosur foljet në kohën e kërkuar.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Morfologji		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/ja dallon ndajfoljet, vendin ku qëndron në fjali, llojet e tyre, dhe kur përdoren në tri shkallët.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur **- Komunikues efektiv**
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
- Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Komunikim verbal dhe joverbal. - Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. - Parafjalë, lidhëz. - Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Ndajfolja

Fjalët kyçe: ndajfolje, klasifikim, kuptim, funksion, shkallët pohore, krahasore, sipërore

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- rikujton njohuritë që ka për ndajfoljen;
- mëson klasifikimin e ndajfoljeve;
- mëson shkallët e ndajfoljeve;
- përdor drejt ndajfoljen në fjali.

Kriteret e suksesit:
Veçoni ndajfoljen në fjali.
Klasifikoni ndajfoljet sipas kuptimit.
Dalloni shkallët e ndajfoljeve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore pune

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Zhvillon komunikimin, Me sportin, me lëndën e biologjisë, Me edukimin qytetar të nxënësit.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Vështrim – Punë në grupe Nxënësit/et vështrojnë fotografinë e dhënë në libër. Një nxënës/e lexon fjalët e shkruara në fotografi, të tjerët tregojnë, pse ato fjalë janë të veçuara me ngjyrë dhe çfarë tregojnë? Nxënësit shprehin mendimet e tyre për fjalët: *u ngjit lart, iku larg, qëndron brenda, zbriti poshtë, rri afër…* Analizoni fjalitë e mëposhtme: - Ajo fliste qartë e shkurt për problemet e klasës. - Kjo situatë të çon shumë larg në mendime. - Është e mbyllur plotësisht shishja e alkoolit. Nxënësit analizojnë fjalitë që janë dhënë në tabelë. Fjalët: *qartë, shkurt, larg, plotësisht,* janë ndajfolje që emërtojnë një tipar, të një veprimi (fjalia 1, 2) a të një gjendjeje (fjalia 3), pra një rrethanor të kryerjes si një veprim të shprehur nga folja. Kështu nxënësit formulojnë përkufizimin për ndajfoljen si pjesë e pandryshueshme e ligjëratës. *Ndajfolja është fjalë e pandryshueshme që shërben për të treguar një tipar të veprimit a të gjendjes së treguar nga folja, nga një emër apo nga një mbiemër që e ka prejardhjen nga folja: mirë, bukur, qartë, sot, nesër, këtu, aty etj.* **Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve** Nxënësit/et njihen me informacionin që jepet në libër për ndajfoljet, ndahen në: • ku e ka vendin në fjali; • sa llojesh janë ato; • në sa shkallë përdoren ndajfoljet. Nxënësit/et punojnë me tabelën për llojet e ndajfoljeve, i përsëritin në dyshe për të mbajtur mend sa më shumë ndajfolje dhe pyesin njëri-tjetrin. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që me ndajfoljet e tabelës të formojnë fjali, duke i përdorur ato në të tria shkallët. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit** Vazhdohet me pjesën e ushtrimeve, **ushtrimi numër 1, 2, 3, 4, 5**, punohen në grupe, sipas kërkesës së dhënë në libër. Pastaj këmbejnë punën e tyre dhe korrigjojnë gabimet që mund të kenë bërë. Klasa plotëson përgjigjen e tyre. Mësuesi/ja monitoron punën e tyre.
Vlerësimi i nxënësve: - Vlerësimi me gojë në situatën e të nxënit. - Vlerësimi në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim, individualisht. - Vlerësimi i ndërsjellë. - Vlerësimi me listë kontrolli.
Detyrat dhe puna e pavarur
Ushtrimi 6: Nga pjesa "*Pikat e shiut*" , shkruani dhjetë ndajfolje dhe përcaktoni llojin e tyre.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësuesi/ja vlerëson dhe komenton punën e nxënësve për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Morfologji		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/a dallon lidhëzat kur lidh dy fjalë dhe kur lidh dy fjali. Dallon lidhëzat bashkërenditëse shtuese, veçuese, kundërshtuese, përmbyllëse dhe lidhëzat nënrenditëse ftilluese, vendore, kohore, shkakore, qëllimore, krahasore - mënyrore, kushtore, rrjedhimore, lejore, i përdor ato në fjali.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

V. Kompetenca personale
10. Merr pjesë, drejton, punon në grup, raporton për punën e pjesëtarëve, mban qëndrim kritik.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
- Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Komunikim verbal dhe joverbal. - Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. - Parafjalë, lidhëz. - Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Lidhëzat

Fjalët kyçe: lidhëza, bashkërenditëse, veçuese, shtuese... nënrenditëse, ftilluese, vendore, qëllimore…

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- rikujton njohuritë për lidhëzat;
- mëson kuptimin e lidhëzave;
- klasifikon lidhëzat sipas funksionit;
- përdor drejt lidhëzat sipas funksionit.

Kriteret e suksesit:
Veçoni lidhëzat në fjali.
Njihni me klasifikimin e lidhëzave sipas funksionit.
Dalloni lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore pune...

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Zhvillon komunikimin, Me artin, kulturën figurative, Me edukimin qytetar të nxënësit

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Parashikim me njohuri paraprake – Punë në grupe
Nxënësit lexojnë fjalitë dhe dallojnë lidhëzat, (sipas njohurive paraprake).

- Ana bleu në treg fruta dhe zarzavate. (dy fjalë)
- Bleu edhe vezë, kurse djathin e bleu te dyqani i pallatit. (dy fjali)
- I ra rrugës shkurt, sepse ishte me vonesë për punë. (dy fjali)

Nxënësit dallojnë lidhëzat kur lidhin dy fjalë në fjalinë e thjeshtë, dy pjesë në fjalinë e përbërë me bashkërenditje dhe nënrenditje.
Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të formojnë përkufizimin për lidhëzat si pjesë të pandryshueshme të ligjëratës. Fjalëzat që lidhin gjymtyrë fjalie ose pjesë të fjalisë së përbërë, quhen **lidhëza**.
Lidhëzat janë fjalë të pandryshueshme. Lidhëzat nuk kanë kuptim leksikor të pavarur. Ato lidhin dy gjymtyrë të fjalisë ose dy pjesë fjalie.

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve – punë e pavarur
Nxënësit punojnë në grupe dyshe për t'u njohur me lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse. Punojnë në dy tabelat e llojeve të lidhëzave.
Nxënësit përsëritin me njëri-tjetrin llojet e lidhëzave bashkërenditëse dhe nënrenditëse dhe pyesin njëri-tjetrin. Mësuesi/ja organizon lojën gjuhësore: thotë lidhëzën, nxënësi/a gjen ç›lloj lidhëse është. Aktivizon të gjithë nxënësit për të fiksuar llojet e lidhëzave bashkërenditëse shtuese, veçuese, kundërshtuese, përmbyllëse dhe llojet e lidhëzave nënrenditëse ftilluese, vendore, kohore, shkakore, qëllimore, krahasore-mënyrore, kushtore, rrjedhimore, lejore.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Lojë gjuhësore
Mësuesi/ja punon bashkë me nxënësit/et ushtrimin 1 (dallojnë llojet e lidhëzave). Punojnë ushtrimin 3 dhe dallojnë kur lidhëzat lidhin dy fjalë dhe kur lidhin dy fjali.
Ushtrimet 2 dhe 4 nxënësit i punojnë në libër në grupe dyshe, ku korrigjojnë njëri-tjetrit.
Ushtrimet 5 dhe 6 i punojnë dy nxënës/e në dërrasë. Ata përdorin në fjali llojet e lidhëzave që janë dhënë.
Ushtrimin 7 e punojnë individualisht dhe e prezantojnë para klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

- Vlerësimi në situatën e të nxënit.
- Vlerësimi në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim, individualisht.
- Vlerësimi gjatë lojës gjuhësore.
- Vlerësimi me listë kontrolli.

Detyrat dhe puna e pavarur

Prezantim i njohurive për lidhëzat me bashkërenditje dhe me nënrenditje në *Power-Point...*

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesi/ja vlerëson dhe komenton punën e nxënësve për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Morfologji		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/a dallon parafjalët, vendin ku qëndron në fjali para një emri, përemri, numërori, ndajfolje dhe qëndrimin në rasën emërore, gjinore, kallëzore dhe rrjedhore.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur **- Komunikues efektiv**
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
- Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Komunikim verbal dhe joverbal. - Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. - Parafjalë, lidhëz. - Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Parafjala

Fjalët kyçe: parafjalë, kuptim, rasat emërore, kallëzore, rrjedhore, emër, përemër, numëror

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- rikujton njohuritë për parafjalën;
- mëson kuptimin e parafjalës;
- mëson qëndrimin e parafjalës;
- përdor drejt parafjalët sipas rasave.

Kriteret e suksesit:
Veçoni parafjalën në fjali.
Njihni me përdorimin e parafjalëve sipas rasave.
Dalloni parafjalët që qëndrojnë para emrit, përemrit, numërorit, ndajfoljes.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore pune...

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Zhvillon komunikimin, Me artin, kulturën figurative, Me edukimin qytetar të nxënësit.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Vështrim – Punë në grupe
Nxënësit/et vështrojnë fotografin e dhënë në libër. Një nxënës/e lexon fjalët e shkruara në fotografi, të tjerët tregojnë, pse ato fjalë janë të veçuara me ngjyrë dhe çfarë tregojnë? Sipas njohurive që kanë, nxënësit shprehin mendimet e tyre për fjalët: *poshtë ujit, nën ujë, drejt nisjes, nga e djathta, nga e majta, afër mbërritjes, drejt fitores, mbi varkë, me varkë, anash varkës…*
Lexojnë fjalitë dhe dallojnë parafjalët, (sipas njohurive që kanë).

- E njoha nga afër atë vend. (para ndajfoljes)
- Do të shkoj në kinema me motrën. (para emrit)
- Duhet të mësohesh edhe nga ata. (me përemër)
- Me dhjetë euro mund ta blesh lodrën. (me numëror)

Nxënësit/et dallojnë parafjalët, thonë se para cilave fjalë qëndrojnë dhe çfarë marrëdhënieje shprehin.

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve
Nxënësit/et njihen me informacionin e dhënë në libër për parafjalën dhe përgatisin pyetje për çështjet kryesore:

- Cili është kuptimi i parafjalës?
- Para cilave fjalë qëndrojnë parafjalët?
- Cilat rasa mund të marrin parafjalë?
- Cilat janë parafjalët në rasën emërore?
- Cilat janë parafjalët në rasën kallëzore?
- Cilat janë parafjalët në rasën rrjedhore?

Nxënësit/et punojnë në grupe dyshe me pyetjet, provojnë t'u përgjigjen. Pastaj disa nxënës/e lexojnë pyetjet, të tjerët përgjigjen.
Nxënësit/et punojnë me tabelën për ndarjen e parafjalëve në rasa (i dallojnë ato nga njëra-tjetra).
Mësuesi/ja punon me nxënësit/et për të dalluar që e njëjta fjalë në fjali mund të përdoret edhe si parafjalë, edhe si ndajfolje.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit
Ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5 nxënësit i plotësojnë në libër, sipas kërkesës së dhënë. Pastaj këmbejnë punën e tyre. Korrigjojnë gabimet që mund të kenë bërë, kur nuk është përdorur parafjala sipas kontekstit në fjali.
Ushtrimin 6 e punon një nxënës në tabelë, si: plotësoni parafjalën apo ndajfoljen që mungon (*pranë, para, me, drejt, nga, rreth*). Shpjegon kur e njëjta fjalë është ndajfolje apo parafjalë.

Vlerësimi i nxënësve:

- Vlerësimi me gojë në situatën e të nxënit;
- Vlerësimi në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim, individualisht.
- Vlerësimi i ndërsjellë.
- Vlerësimi me listë kontrolli.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 7: Shënoni me P (parafjalë) ose me N (ndajfolje) për fjalët e nënvizuara në grupet e fjalëve më poshtë.
Ushtrimi 8: Emrat klasë, motër, nënë, makinë, mal shoqërojini me parafjalët nga, me, në, afër, nëpër dhe më pas formoni fjali me çdo grup fjalësh.
Ushtrimi 9: Rindërtoni fjalitë duke përdorur një parafjalë tjetër.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesi/ja vlerëson dhe komenton punën e nxënësve për ecurinë e procesit mësimor.

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Morfologji		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/a dallon numërorin që tregon sasi të caktuar, dallon kategoritë gramatikore të numërorit dhe veçon drejtshkrimin e tyre, i përdor drejtë në fjali.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

V. Kompetenca personale
10. Merr pjesë, drejton, punon në grup, raporton për punën e pjesëtarëve, mban qëndrim kritik.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
- Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Komunikim verbal dhe joverbal. - Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. - Parafjalë, lidhëz. - Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Numërorët

Fjalët kyçe: numëror, sasi, frymorë, sende, kategori gramatikore, drejtshkrim…

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- rikujton njohuritë për numërorët;
- njihet me kategoritë gramatikore të numërorit;
- përdor drejt numërorët në drejtshkrim.

Kriteret e suksesit:
Veçoni numërorët në fjali.
Kuptoni kategoritë gramatikore të numërorit.
Dalloni drejtshkrimin e numërorëve në fjali.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore pune....

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Zhvillon komunikimin, Me matematikën, Me edukimin qytetar të nxënësit

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Parashikim me njohuri paraprake – Punë e pavarur Nxënësit/et lexojnë tekstin e mëposhtëm dhe nënvizojnë numërorët. (sipas njohurive paraprake). *Klasa jonë ka tridhjetë e një nxënës, gjashtëmbëdhjetë djem dhe pesëmbëdhjetë vajza. Ne ulemi nga dy veta në bankë dhe bëjmë katër, pesë ose gjashtë orë mësim në ditë. Një ditë e zakonshme kalon pa u ndier.* Nxënësit/et dallojnë numërorët në fjali dhe i thonë para klasës. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të formojnë përkufizimin për numërorët si pjesë e ndryshueshme e ligjëratës. Numërori tregon sasi të caktuar frymorësh ose sendesh, apo pjesë të sendeve. Ai përdoret: i shoqëruar me emra: *një flutur, tre djem, dymbëdhjetë metra*; i pashoqëruar me emra: 9 + 3 = 12 (në veprimet matematike) **Ndërtimi i njohurive të reja: Mësimdhënie e ndërsjellë** Nxënësit lexojnë pjesën "Mbani mend", pastaj mësuesi/ja në mënyrë të ndërsjellë iu shpjegon për kategoritë gramatikore të numërorit dhe drejtshkrimin e tyre. ➢ Numërorët në përgjithësi nuk e kanë kategorinë e gjinisë. Nga ky rregull bën përjashtim numërori tre, i cili e ka kategorinë e gjinisë: pesë djem – pesë vajza; tre djem – tri vajza, por edhe tridhjetë e tre djem – tridhjetë e tri vajza. Nga rregulli i mësipërm bëjnë përjashtim edhe numërorët me kuptim përmbledhës: Erdhën të dy djemtë. – Erdhën të dyja vajzat. Morën pjesë të tre djemtë. – Morën pjesë të tria vajzat. ➢ Përveç numërorëve që shprehin numra të cilët janë njësi të plota, ka edhe numërorë të tjerë që shprehin numra të cilët nuk janë njësi të plota, por janë pjesë e një ose e disa njësive. Këta numërorë janë ata numra që në matematikë njihen si thyesa… ➢ Numërorët shkruhen edhe me shifra, edhe me fjalë. Shkruhen njësh numërorët: zero, një, dy, tre, katër (deri në dhjetë); njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë... (deri në nëntëmbëdhjetë); tridhjetë, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë etj. Shkruhen ndaras numërorët: në formë shprehjeje, fjalët e të cilëve lidhen me e: dyzet e shtatë, gjashtëdhjetë e tre, njëqind e dyzet, tetëdhjetë e nëntë etj. *Kujdes - Fjalët që tregojnë radhë si: i parë, i dytë, i dhjetë etj., në matematikë quhen numra rendorë, ndërsa në gramatikë kanë funksionin e mbiemrave. Kjo është arsyeja që ata do t'i trajtojmë si mbiemra dhe jo si numërorë.* **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Informata kthyese + Lojë gjuhësore** Mësimdhënësi/a punon bashkë me nxënësit ushtrimin 1: Gjeni numërorët dhe shpjegoni përse janë përdorur ata. Ushtrimi 2: Plotësoni grupet e mëposhtme me numërorin tre/tri. Mbani parasysh gjininë e emrave. Ushtrimi 3: Shkruani me fjalë dhe lakoni thyesat… Ushtrimi 4: Shkruani me fjalë numërorët e mëposhtëm… Nxënësit/et i punojnë ushtrimet në libër, në grupe dyshe, dhe korrigjojnë punën e njëri-tjetrit. Mësuesi/ja organizon lojën gjuhësore ku aktivizohen të gjithë nxënësit. Më pas, ushtrimet i diskutojnë me klasën dhe jepen zgjidhjet e drejta të ushtrimeve.
Vlerësimi i nxënësve: - Vlerësimi në situatën e të nxënit. - Vlerësimi në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim, individualisht. - Vlerësimi gjatë lojës gjuhësore. - Vlerësimi me listë kontrolli.
Detyrat dhe puna e pavarur
Prezantim i njohurive për numërorët në *Power-Point...*
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësuesi/ja vlerëson dhe komenton punën e nxënësve për ecurinë e procesit mësimor.

<table>
<tr><th colspan="4">Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:
Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda:
Gjuhë shqipe</td><td>Shkalla e kurrikulës: III</td><td>Klasa: VI</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Sintaksë</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:
Nxënësi/ja dallon fjalinë dëftore nga ajo pyetëse. Formulon përkufizimin për fjalinë dëftore dhe pyetëse, jep shembuj me fjali. I përdor ato në fjali.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – Komunikues efektiv
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë – Nxënës i suksesshëm
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
V. Kompetenca personale
10. Merr pjesë, drejton, punon në grup, raporton për punën e pjesëtarëve, mban qëndrim kritik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit

Të shkruarit
Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.

II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon. - Kërkon dhe jep ndihmë. - Respekton mendimin e të tjerëve. - Kushton vëmendje. - Motivohet për zhvillimin e shkathtësive.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen t nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit. - Të kuptuarit.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. - Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. - Shenjat e pikësimit.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Aspektet specifike të planit të orës mësimore</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Fjalia dëftore dhe fjalia pyetëse</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: fjalia dëftore, pyetëse, kumtimi, pikë, pikëpyetje…</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- rikujton njohuritë për fjalitë dëftore dhe pyetëse;
- mëson fjalitë dëftore dhe pyetëse;
- veçon fjalitë dëftore dhe pyetëse.
Kriteret e suksesit:
Njihet me fjalitë dëftore dhe pyetëse.
Kupton fjalitë dëftore dhe pyetëse.
Dallon fjalitë dëftore dhe pyetëse.</td></tr>
</table>

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore pune, Materiale të digjitalizuara, Fletorja për verifikimin e kompetencave.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Zhvillon komunikimin, Teknologji informative, Me edukimin qytetar të nxënësit.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh
Mësuesi/ja diskuton me nxënësit për fjalinë dëftore dhe pyetëse; vë në pah njohuritë e tyre. Nxënësit me ndihmën e mësuesit/es analizojnë fjalitë, gjejnë fjalinë dëftore dhe pyetëse. Duke analizuar fjalitë, nxënësit thonë përkufizimin për fjalitë pyetëse dhe dëftore: *Fjalitë dëftore janë fjalitë që përdoren më shpesh në ligjërimin e përditshëm. Me anë të tyre shprehim informacione, mendime, arsyetime apo përshkrime. Fjalitë pyetëse përdoren nga folësi kur kërkon të mësojë nga bashkëbiseduesi diçka që nuk e di.*
Nxënësit shprehin mendimet e tyre për fjalinë dëftore dhe pyetëse me shembuj.

Ndërtimi i njohurive të reja: Diagrami i Venit
Nxënësit lexojnë 5' informacionin që jepet në libër për fjalinë dëftore dhe pyetëse. Njohuritë që jepen, nxënësit i shprehin me pyetje (në grupe dyshe).

- Ç'është fjalia?
- Si i ndajmë fjalitë sipas kumtimit?
- Si e dallojmë fjalinë dëftore dhe pyetëse?
- Kur është fjalia dëftore dhe pyetëse?
- Cilat janë llojet e fjalisë pyetëse?

Nxënësit lexojnë pyetjet që kanë formuluar dhe përgjigjen duke dhënë shembujt nga libri.
Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të vështrojnë fotografinë në libër dhe të shkruajnë përgjigjen për secilën nga pyetjet poshtë tyre.
Pastaj udhëzohen që njohuritë që kanë për fjalitë dëftore dhe pyetëse, t'i paraqesin në diagramin e Venit.



Të përbashkëtat...
Fjalitë dëftore, pyetëse, dëshirore dhe nxitëse, kur shprehin habi, kënaqësi, keqardhje dhe zemërim mbarojnë me pikëçuditje (!).
Për shkak të intonacionit ngjitës që përdoret në këto raste, ato quhen fjali thirrmore.

Mësuesi/ja kontrollon punën e nxënësve, jep sqarime dhe plotëson duke dhënë formën e drejtë të përdorimit.
Puna e bërë prezantohet para klasës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit
Ushtrimi 1 punohet me gojë: *Nënvizo me ngjyrë blu fjalitë dëftore dhe me ngjyrë të kuqe fjalitë pyetëse.*
Ushtrimi 2: *Fjalitë e mëposhtme kanë të njëjtat fjalë. Ku ndryshojnë ato? Lexojini, duke përdorur intonacionin e duhur.., Shkruani tri fjali dëftore dhe më pas kthejini në pyetëse.*
Nxënësit, të ndarë në grupe dyshe, i punojnë në libër, këmbejnë librat dhe korrigjojnë gabimet e njëri-tjetrit.
Edhe mësuesi/ja kontrollon punën e tyre.
Ushtrimet 3, 4 dhe 5 i punon e gjithë klasa.

Vlerësimi i nxënësve: - Vlerësimi në të nxënit. - Vlerësimi në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim. - Vlerësimi i ndërsjellë. - Vlerësimi me listë kontrolli. - Vlerësimi në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë.
Detyrat dhe puna e pavarur
Ushtrimi 6: Formoni fjali pyetëse që fillojnë me fjalët: cili, ku, si, çfarë, kur. Shkruani përgjigjet për pyetjet e formuara. **Ushtrimi 7**: Shkruani tri pyetje për figurën e mëposhtme dhe nga një përgjigje për secilën prej tyre.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësuesi/ja vlerëson të shkruarit, të folurit dhe të shprehurit e nxënësve...

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Sintaksë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/ja dallon fjalinë dëshirore nga ajo nxitëse. Formulon përkufizimin për fjalinë dëshirore dhe nxitëse, jep shembuj me fjali. I përdor ato në fjali.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**

1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.

III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**

3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

V. Kompetenca personale

10. Merr pjesë, drejton, punon në grup, raporton për punën e pjesëtarëve, mban qëndrim kritik.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të shkruarit
Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon. - Kërkon dhe jep ndihmë. - Respekton mendimin e të tjerëve. - Kushton vëmendje. - Motivohet për zhvillimin e shkathtësive.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen t nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit. - Të kuptuarit.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. - Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. - Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Fjalia dëshirore dhe fjalia nxitëse

Fjalët kyçe: fjalia dëshirore, nxitëse, kumtimi, pikë, pikëpyetje…

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- rikujton njohuritë për fjalitë dëshirore dhe nxitëse;
- mëson fjalitë dëshirore dhe nxitëse;
- veçon fjalitë dëshirore dhe nxitëse.

Kriteret e suksesit:
Njihet me fjalitë dëshirore dhe nxitëse.
Kupton fjalitë dëshirore dhe nxitëse.
Dallon fjalitë dëshirore dhe nxitëse.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore pune, Materiale të digjitalizuara, Fletorja për verifikimin e kompetencave.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Zhvillon komunikimin, Teknologji informative, Me edukimin qytetar të nxënësit

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh
Mësuesi/ja diskuton me nxënësit për fjalinë dëshirore dhe nxitëse; vë në pah njohuritë e tyre. Nxënësit me ndihmën e mësuesit/es analizojnë fjalitë, gjejnë fjalinë dëshirore dhe nxitëse. Duke analizuar fjalitë, nxënësit thonë përkufizimin për fjalitë dëshirore dhe nxitëse: Fjalitë nëpërmjet të cilave folësi shpreh një dëshirë, një urim a një mallkim, janë fjali dëshirore. Ato fillojnë me shkronjë të madhe dhe mbarojnë me pikëçuditje (!). Fjalitë nëpërmjet të cilave folësi shpreh një këshillë, një lutje, një ftesë, një propozim, janë fjali nxitëse. Ato fillojnë me shkronjë të madhe dhe mbarojnë me pikë (.).
Nxënësit shprehin mendimet e tyre për fjalinë dëshirore dhe nxitëse me shembuj.

Ndërtimi i njohurive të reja: Diagrami i Venit
Nxënësit lexojnë 5' informacionin që jepet në libër për fjalinë dëshirore dhe nxitëse. Njohuritë që jepen, nxënësit i shprehin me pyetje (në grupe dyshe).
- Ç'është fjalia?
- Si i ndajmë fjalitë sipas kumtimit?
- Si e dallojmë fjalinë dëshirore dhe nxitëse?
- Kur është fjalia dëshirore dhe nxitëse?
- Çka shprehin fjalitë dëftore, pyetëse, dëshirore dhe nxitëse?

Nxënësit lexojnë pyetjet që kanë formuluar dhe u përgjigjen atyre duke dhënë shembujt nga libri.
Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të vështrojnë fotografinë në libër dhe të analizojnë secilin shembull, duke dalluar fjalinë dëshirore dhe nxitëse.
Pastaj udhëzohen që njohuritë që kanë për fjalitë dëshirore dhe nxitëse, t'i paraqesin në diagramin e Venit.



Të përbashkëtat...
Fjalitë dëftore, pyetëse, dëshirore dhe nxitëse, kur shprehin habi, kënaqësi, keqardhje dhe zemërim mbarojnë me pikëçuditje (!).
Për shkak të intonacionit ngjitës që përdoret në këto raste, ato quhen fjali thirrmore.

Mësuesi/ja kontrollon punën e nxënësve, jep sqarime dhe plotëson duke dhënë formën e drejtë të përdorimit. Puna e bërë prezantohet para klasës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Informacioni kthyes
Ushtrimet 1 dhe 2 Plotësoni urimet: ….. Plotësoni kështillat: ….. punohet me gojë. Nxënësit, të ndarë në grupe dyshe, i punojnë në libër, këmbejnë librat dhe korrigjojnë gabimet e njëri-tjetrit. Edhe mësuesi/ja kontrollon punën e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:
- Vlerësimi në të nxënit.
- Vlerësimi në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim.
- Vlerësimi i ndërsjellë.
- Vlerësimi me listë kontrolli.
- Vlerësimi në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 3: Shkruani një tekst të shkurtër në të cilin të përdorni fjali dëshirore për të shprehur dëshirat apo urimet tuaja.
Ushtrimi 4: Shkruani një tekst të shkurtër në të cilin të përdorni fjali nxitëse për të shprehur kështillat apo propozimet tuaja.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesi/ja vlerëson të shkruarit, të folurit dhe të shprehurit e nxënësve...

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Sintaksë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/ja dallon format pohore dhe mohore të fjalive. Formulon përkufizimin për fjalinë pohore dhe mohore, jep shembuj me fjali. I përdor ato në fjali.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I. Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv**
1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm**
3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
V. Kompetenca personale
10. Merr pjesë, drejton, punon në grup, raporton për punën e pjesëtarëve, mban qëndrim kritik.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
Të shkruarit
Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. - Merr pjesë në diskutim. - Bashkëpunon. - Kërkon dhe jep ndihmë. - Respekton mendimin e të tjerëve. - Kushton vëmendje. - Motivohet për zhvillimin e shkathtësive.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen t nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit. - Të kuptuarit.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. - Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. - Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Format pohore dhe mohore të fjalive

Fjalët kyçe: format pohore, mohore, fjali, tregim…

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- rikujton njohuritë për formën pohore dhe mohore të fjalive;
- mëson formën pohore dhe mohore të fjalive;
- veçon formën pohore dhe mohore të fjalive.

Kriteret e suksesit:
Njihet me formën pohore dhe mohore të fjalive.
Kupton formën pohore dhe mohore të fjalive.
Dallon formën pohore dhe mohore të fjalive.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore pune, Materiale të digjitalizuara, Fletorja për verifikimin e kompetencave.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin, Teknologji informative, Me edukimin qytetar të nxënësit.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja diskuton me nxënësit për formën pohore dhe mohore të fjalive; vë në pah njohuritë e tyre. Nxënësit me ndihmën e mësuesit/es analizojnë fjalitë, gjejnë formën pohore dhe mohore të fjalive. Duke analizuar fjalitë, nxënësit thonë përkufizimin për formën pohore dhe mohore: *Fjalia në të cilën pohohet diçka, ka formë pohore. Në të pohohet një realitet ose tregohet prania e diçkaje. Fjalia në të cilën mohohet diçka, ka formë mohore. Në të mohohet një realitet ose tregohet mungesa e diçkaje. Sa herë që fjalia përdoret në formën mohore vihet re përdorimi i fjalëve me kuptim mohor: nuk, s', mos, as, pa, jo etj.*

Nxënësit shprehin mendimet e tyre për formën pohore dhe mohore të fjalive me shembuj.

Ndërtimi i njohurive të reja: Diagrami i Venit

Nxënësit lexojnë 5' informacionin që jepet në libër për formën pohore dhe mohore të fjalive. Njohuritë që jepen, nxënësit i shprehin me pyetje (në grupe dyshe).

- Ç'është forma e fjalive?
- Si i ndajmë format e fjalive?
- Si e dallojmë formën pohore dhe mohore të fjalisë?
- Kur është fjalia në formën pohore dhe mohore?

Nxënësit lexojnë pyetjet që kanë formuluar dhe përgjigjen duke dhënë shembujt nga libri.

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të vështrojnë fotografinë në libër dhe të shkruajnë përgjigjen për secilin shembull, duke dalluar formën pohore dhe mohore të fjalisë.

Pastaj udhëzohen që njohuritë që kanë për formën pohore dhe mohore të fjalisë, t'i paraqesin në diagramin e Venit.

Forma pohore e fjalive dallohet për praninë e fjalëve: gjithandej, të gjithë, gjithkund etj., ndërsa forma mohore e fjalive ka në përbërjen e saj fjalë, si: askush, asnjeri, askund etj.



Mësuesi/ja kontrollon punën e nxënësve, jep sqarime dhe plotëson duke dhënë formën e drejtë të përdorimit. Puna e bërë prezantohet para klasës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Informacioni kthyes

Ushtrimi 1 dhe 2: Nënvizoni me një vijë fjalitë në formën pohore dhe me dy vija fjalitë në formën mohore. Shndërroni fjalitë pohore në mohore dhe anasjellas. Nxënësit, të ndarë në grupe dyshe, i punojnë në libër, këmbejnë librat dhe korrigjojnë gabimet e njëri-tjetrit. Edhe mësuesi/ja kontrollon punën e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Informacioni kthyes **Ushtrimi 1 dhe 2:** Nënvizoni me një vijë fjalitë në formën pohore dhe me dy vija fjalitë në formën mohore. Shndërroni fjalitë pohore në mohore dhe anasjellas. Nxënësit, të ndarë në grupe dyshe, i punojnë në libër, këmbejnë librat dhe korrigjojnë gabimet e njëri-tjetrit. Edhe mësuesi/ja kontrollon punën e tyre. **Vlerësimi i nxënësve:** - Vlerësimi në të nxënit. - Vlerësimi në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim. - Vlerësimi i ndërsjellë. - Vlerësimi me listë kontrolli. - Vlerësimi në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë.
Detyrat dhe puna e pavarur
Ushtrimi 3: Krijoni pesë fjali pohore dhe shndërroji ato në fjali mohore.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësuesi/ja vlerëson të shkruarit, të folurit dhe të shprehurit e nxënësve...

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë shqipe	**Shkalla e kurrikulës:** III	**Klasa:** VI
Tema: Sintaksë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësi/ja dallon rrethanorët e vendit, kohës me pyetjet *ku?, kur?*. Tregon me se shprehen, ku qëndrojnë në fjali, krahason të përbashkëtat me të veçantat dhe i përdor ato me fjali.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** Kompetenca komunikim dhe të shprehur – **Komunikues efektiv** 1. Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. 2. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve. 4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit. **III.** Kompetenca të mësuarit për të nxënë – **Nxënës i suksesshëm** 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. 5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike. 6. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes. **V. Kompetenca personale** 10. Merr pjesë, drejton, punon në grup, raporton për punën e pjesëtarëve, mban qëndrim kritik.			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. Shkathtësitë e komunikimit
- Debaton dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, paragrafë, ese, tregim, përrallë etj.
II. Vlerat dhe qëndrimet
- Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin.
III. Aftësitë dhe shkathtësitë që zhvillohen te nxënësi/ja:
- Të komunikuarit. - Të dëgjuarit. - Të folurit. - Të shkruarit. - Të lexuarit. - Të kuptuarit. - Të menduarit krijues.
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës
- Komunikim verbal dhe joverbal. - Llojet e fjalive sipas intonacionit. - Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. - Shenjat e pikësimit.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Rrethanorët

Fjalët kyçe: rrethanorët, rrethanor vendi, kohe, gjymtyrë e dytë jo e domosdoshme, plotësuese...

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- rikujton njohuritë e marra për rrethanorët;
- mëson gjymtyrën e dytë të fjalisë;
- njihet me llojet e rrethanorëve;
- veçon rrethanorët që shprehen me parafjalë, emër, grup emëror, me paskajore.

Kriteret e suksesit:
Njihen me rrethanorët si gjymtyrë të dyta.
Kuptojnë përdorimin e drejt të rrethanorëve.
Dallojnë rrethanorët që shprehen me parafjalë, emër, grup emëror, me paskajore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VI, tabela, fletore pune, materiale të digjitalizuara, fletorja për verifikimin e kompetencave.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: zhvillon komunikimin, teknologji informative, me edukimin qytetar të nxënësit.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë në grupe - Formulimi i pyetjeve
Punë me tekstin: Nxënësit kanë njohuri për llojet e rrethanorëve të vendit, kohës, mënyrës, sasisë.
Nxënësit në heshtje lexojnë informacionin në faqen 98 (tabelën për gjithë llojet e rrethanorëve).
Nxënësit në grupe dyshe punojnë për të formuluar pyetje për rrethanorët:
- Ç'gjymtyrë fjalie janë rrethanorët?
- Sa llojesh janë ata?
- Me ç'pyetje gjenden ato në fjali?
- Me se shprehen rrethanorët?

Nxënësit japin përgjigje dhe mësuesi/ja plotëson përgjigjet e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: Diagrami i Venit
Një nxënës/e lexon me zë informacionin që jepet për rrethanorët e vendit dhe kohës.
Në grupe dyshe, nxënësit punojnë në diagramin e Venit për dy llojet e rrethanorëve.



- Janë gjymtyrë të dyta.
- Formojnë GE me kallëzuesin.
- Shprehen me ndajfolje.

Kur nxënësit mbarojnë, komentojnë punën e bërë dhe mësuesi/ja plotëson diagramin duke e shkruar në tabelë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtim i përbashkët - Puna e pavarur

Ushtrimet 1, 3, 4, 5, dhe 6, nxënësit i punojnë në dyshe. Këmbejnë librat me njëri-tjetrin, dhe identifikojnë gabimet. Jepni formën e drejtë sipas kërkesës në libër.

Ushtrimin 2 e punon një nxënës në tabelë, sipas kërkesës së dhënë në libër.

Vlerësimi i nxënësve:

- Vlerësimi në të nxënit.
- Vlerësimi në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim.
- Vlerësimi i ndërsjellë.
- Vlerësimi me listë kontrolli.
- Vlerësimi në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë.

Detyrat dhe puna e pavarur

Prezanton në *PowerPoint* njohuritë për rrethanorët.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësuesi/ja vlerëson ecurinë e procesit mësimor gjatë orës...

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37.016:811.18(072)(075.2)

Kursoni, Meleqe
Libër për mësuesin : gjuhë shqipe 6 / Meleqe Kursoni, Melihate Zeqiri, Dafina Roka. - Prishtinë : Botime Pegi, 2019. - 214 f. : ilustr. ; 20.7 x 28 cm.

1.Zeqiri, Melihate 2. Roka, Dafina

ISBN 978-9951-786-17-1

Lejohet për botim me vendimin e Ministrisë
së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë,
nr. 431/01-B, të datës 23.08.2019.